RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI PËRPUTHSHMËRINË
NË

MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI "PËRMIRËSIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR"

DHJETOR 2021

PËRMBAJTJA **FAQE**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 11
II. HYRJA 14
1. Objekti i auditimit 14
2. Qëllimi i auditimit 15
3. Identifikimi i çështjes: 15
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: 15
5. Përgjegjësitë e audituesve: 16
6. Kriteret e vlerësimit 16
7. Standardet e auditimit 17
8. Metodat e auditimit 17
9. Dokumentimi i auditimit 18
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 19
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim 19
1. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT 22
2.1Mbi auditimin e marrëveshjeve të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argume
2.2Mbi auditimin e menaxhimit financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve
2.3Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projekteve në krahasim me ato të përcaktuar
2.4Mbi prokurimin e fondeve të kredisë si dhe ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit. 44
2.5Mbi zbatimin e kontratave të lidhura për mallra, shërbime dhe punime përfshirë verifikimin dhe inspektimin
2.5.1 Mbi zbatimin e kontratës *"Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin pedriatik ekzistues"* 82
2.5.2 Mbi zbatimin e kontratës *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* 87
2.5.3 Mbi zbatimin e kontratës *"Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"* 95
2.5.4. Zbatimi i kontratës *"F.V. Rezonanca magnetike (MRI) për spitalin e Elbasanit"* 97
2.5.5. Mbi zbatimi i kontratës *"Furnizimi dhe instalimi i softit të sistemit të menaxhimit financiar në 420 qendra të kujdesit parësor"* 98
2.5.6. Zbatimi i kontratës *"Mbështetje e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë së re për menaxhimin e QSUT"* 106
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET 117
V. ANEKSE 136

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH në periudhën nga data 04.06.2020 deri me datë 10.08.2021 kreu auditimin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Zyrës së Koordinimit të Projektit të ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për Projektin *'Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor'* për aktivitetin e periudhës nga fillimi i Projektit (2015) deri më 31.05.2021, duke u përqendruar në auditimin e marrëveshjeve të financimit të Projektit me huadhënësin, ndryshimet e tyre, shkaqet dhe argumentimin e ndryshimeve, menaxhimin financiar të Projektit, shkallën e realizimit të objektivave dhe komponentëve të Projektit në krahasim me ato të parashikuara në Marrëveshjet e Financimit, prokurimin e fondeve të kredisë dhe ndjekjen e procedurave të vlerësimit dhe kontraktimit si dhe zbatimin e kontratave të lidhura për mallra/shërbime/punime civile. Gjithashtu, me qëllim përmbushjen e objektivave të Projektit të Auditimit, Grupi i Auditimit, në bazë të autorizimeve me nr. 579/3 prot., datë 09.08.2021 dhe nr. 579/31 prot., datë 15.09.2021 kreu dy verifikime, përkatësisht në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm dhe Kujdesit Shëndetësor dhe Qendrën Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, të shpërblimeve të dëmit dhe të mungesës së përdorimit me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të kryer mbi Projektin *'Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor'* për periudhën nga fillimi i Projektit (2015) deri më datë 31.05.2021, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të kualifikuar të përputhshmërisë veprimtarisë ekonomike dhe financiare.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 22 akte, nga të cilat 19 akte konstatimi dhe 3 akte verifikimi të cilat tyre janë dorëzuar në protokollin e MSHMS dhe QSUT brenda afateve. Me shkresat e protokolluara në KLSH me nr. 873/3, datë 26.11.2020, nr. 873/4 prot., datë 27.11.2020 dhe ato të dërguara në rrugë elektronike me datë 18.11.2020 dhe 19.11.2020 nga subjekti janë paraqitur observacionet për aktet e mbajtura. Me shkesën nr. 579/32 datë 11.10.2021 është dërguar Projektraporti i Auditimit dhe me shkresat e administruara në KLSH me nr. 579/33 prot., datë 12.11.2021, nr. 579/34 prot., datë 15.11.2021, nr. 579/35 prot., datë 16.11.2021 dhe nr. 579/36 prot., datë 16.11.2021 subjekti i auditimit ka paraqitur observacione për Projektraportin të cilat pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u reflektuan me argumentet e duhur ligjor dhe gjejnë pasqyrim në këtë Raport

Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për marrjen e masave në përmirësimin e punës. Për sa i takon takimit përmbyllës midis niveleve drejtuese të KLSH-së, grupit të auditimit dhe subjektit të audituar ky takim u zhvillua me datë 22.11.2021.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	1. Programi A... P... i dorëzuar nga kompania I.., është në versionin demo dhe CD-ja e dorëzuar mban emërtimin ñCD demo Alpha Businessò. Programi që gjendet brenda kësaj CD-ROM nuk mund të instalohet në PC nga specialistja e financës së projektit. Fotoja e CD-ROM, të dorëzuar nga kompania I..., paraqitet tek aneksi nr. 2 figura nr. 1. Mungesa e instalimit të programit A.. P.. nga anëtarët e PCU, është në mospërputhje me parashikimin e aneksit nr. 22 të POM seksioni III. ñPerformance parametersò, citoj: Softueri duhet të paraqitet në një CD së bashku me udhëzimet për instalim dhe përdorim dhe të jetë i mundur që të instalohet nga përdoruesi në kompjuterin e specialistit të financës së projektit. 2. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe raporteve tremujore u konstatua se programi financiar A.. P.., i kontraktuar dhe i blerë nga kompania I..., ka shfaqur problematika në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe gjenerimit të raporteve të ndryshme. Referuar informacionit përmbledhës së datës 07.06.2021, të specialistes së financës së projektit HSIP në lidhje me problematikat e shfaqura të programit A.. P.., ndër të tjera informon se: ñé Në shkurt të 2020, gjatë përpjekjes për gjenerimin e raportit 3 mujor, është konstatuar se sistemi ka pasur një problematik në gjenerimin e një raporti për të cilin vlera nuk dilte e saktë. Që nga ky moment sistemi A.. P.. nuk gjeneron raportime me të dhëna të sakta (të cilat i realizojmë në Excel) ....jemi në kushtet kur çështja e gjenerimit të raporteve mbetet e pazgjidhur dhe raportet po gjenerohen me Excel ndërkohë që sistemi vijon të mos gjeneroj raporte të sakta sipas kërkesës së bankës Botërore.ò 3. Programi për menaxhimin financiar të projektit A.. P.. i prokuruar në shumën 576,000 lekë (me TVSh) nuk kryen funksionet për të cilat është prokuruar, duke e bërë këtë shpenzim jo efektiv dhe njëkohësisht ka rritur artificialisht kostot e projektit, duke bërë që të gjitha transaksionet financiare dhe raportet e ndryshme të realizohen me programin Excel. 4. Megjithëse programi nuk ka funksionuar, fakt i konfirmuar nga mungesa e gjenerimit të raporteve dhe problematikave të tjera të evidentuara nga specialistja e financës së projektit HSIP, grupi i auditimit u ballafaqua edhe me një fakt kontradiktor në lidhje me këtë çështje, pasi në progres raportin e parë për vitin 2021, për periudhën janar ï mars 2021 përcjell MSHMS, MEF dhe L. K.-TTL, Banka Botërore nëpërmjet shkresës nr. 30 prot., datë 11.05.2021. Në këtë raport nuk evidentohet problematikat e shfaqura të programit A.. P.., por përkundrazi në fund të përshkrimit për procedurën e blerjes se programit A.. P.., raportohet se kontrata është duke u implementuar. Pra çka nënkupton që sipas PCU deri në muajin mars 2021, periudhë që përfshin raportimin për IRBD, programi A.. P.. ka funksionuar, ndërkohë që	25 ï 36	E lartë	MSHMS të marrë masa, që programi financiar A.. P.. të vihet në funksion të plotë, sipas kërkesave të prokuruara dhe të ofertuara. Në rast se kompania I... nuk e vendos në funksion programin A.. P.., vlera prej 460,800 lekë do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

	specialistja e financës së PCU, deklaron që programi nuk ka funksionuar prej muajit shkurt 2020. 5. Në pikën 10 të kontratës HSIP/G/SH/02-2015 me nr. 578/4 Prot., datë 23.02.2016, është parashikuar garanci dhe mirëmbajtjeje për 12 muaj, periudhë e cila do të fillonte nga data e pranimit dhe marrjes në dorëzim të Softit nga HSIP. Programi informatik A.. P.. është marrë në dorëzim më datë 07.06.2016 (shkresa nr. 28 prot., datë 07.06.2016) nga anëtarët e Zyrës së Koordinimit të Projektit HSIP (B. D., D. Gj. dhe E. D.) të cilët kanë konfirmuar që programi A.. P.. funksionon sipas kërkesave të kontratës dhe sistemi A.. P.. gjeneron raportet e kërkuara konform kërkesave të POM-it. Gjithashtu vërehet se në komisionin e marrjes në dorëzim të këtij produkti informatik, nuk ka pasur në përbërje anëtarë specialist të IT. Në kontratë është parashikuar afati kohor prej 12 muajsh për garancinë dhe mirëmbajtjen. Kjo periudhë ka përfunduar më datë 07.06.2017 6. Me urdhrin e shpenzimit nr. 49 datë 21.07.2016, zyra e financës së PCU-së. në zbatim të pikës 9 të kontratës, ka kryer pagesën për I... në shumën 460,800 lekë, ose 80% të vlerës së kontratës, 7. Shuma e mbetur prej 20% duhej të paguhej, në përfundim të periudhës së mirëmbajtjes dhe garancisë, pra pas datës 07.06.2016. Nga auditimi i dokumentacionit të bankës pranë PCU rezulton se, shuma e mbetur prej 115,200 lekë e cila përfaqëson 20% të vlerës totale të kontratës nuk është ekzekutuar në llogarinë bankare të I... Konkluzion: Për sa më lart, aktiviteti ekonomiko financiar i projektit HSIP, mbahet dhe përpunohet me programin Excel dhe jo me programin financiar për menaxhim projektesh A.. P.., prandaj shuma 576,000 lekë do të konsiderohet si një shpenzim jo efektiv që ka rritur kostot e shpenzimeve të projektit. Mungesa e përdorimit të këtij programi financiar nga ana e Zyrës së Koordinimit të Projektit është në mospërputhje me përcaktimet: POM-Annex 22- Accounting Software Technical Specification TECHNICAL SPECIFICATION - Project Accounting Software Application, ku është përcaktuar që aktiviteti financiar i projektit dhe gjenerimi i raporteve financiare do të bëhet me Programe software-ike për menaxhimin e projekteve duke përcaktuar programin A.. P...			
2	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se emërimi i Drejtores së Kabinetit znj. E. H., me Urdhër nr. 96, datë 11.03.2016 të Ministrit të MSHMS në pozicionin e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit është kryer në kundërshtim me kërkesat e parashtruara nga Manuali Operacional i Projektit të vitit 2015 si dhe atyre të Manualit Operacional të ndryshuar në vitin 2019, sipas të cilit është shprehur se në këtë pozicion duhet të emërohet Zv. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Njëkohësish duhet theksuar fakti se ky emërim është kryer në kundërshtim edhe me Rregulloren e Brendshme të MSHMS, pasi funksionaret e Kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.	34 ï 35	E lartë	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për zëvendësimin e Koordinatorit të Përgjithshëm aktual të Projektit dhe emërimin në këtë pozicion të funksionarëve sipas kërkesave të parashtruara nga Manuali Operacional i Projektit.
3	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat rezultoi se në MSHMS janë dorëzuar të gjitha materialet sipas kontratës por nuk ka dokument të plotë të realizuar, dhe me shtyrjen e vazhduar në fund mund të mos mbetet kohë edhe për periudhën e nevojshme të implementimit të tij. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit HSIP fillestar (viti 2015) dhe Manuali Operacional i Projektit HSIP i rishikuar (viti 2019)	36 ï 44	E lartë	MSHMS të botojë versionin final të Master Planit të përbërë nga materialet e hartuara si dhe të ngrejë ekipin që do të vërë në jetë implementimin e tij duke përfshirë dhe kryerjen e trajnimeve për stafet e spitaleve.

4	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat rezultoi se këto të fundit janë ndryshuar vazhdimisht dhe nuk janë realizuar plotësisht. Projekti për përmirësimin e sistemit shëndetësor ka pasur që nga fillimi shumë vonesa në realizimin e objektivave duke ndryshuar vazhdimisht objektivat dhe afatet e duke vënë kësisoj në pikëpyetje realizimin e tyre.	36 ï 44	E lartë	Nga ana e Zyrës së Koordinimit të Projektit në bashkëpunim me Grupet Teknike për secilin komponent dhe me dakordësinë e Bankës Botërore, të bëhet një analizë e plotë në lidhje me arsyet dhe përgjegjësitë konkrete të mosrealizimit të objektivave që kanë mbetur të parealizuara që nga fillimi i projektit dhe të hartohet një plan me objektiva konkrete e të matshme, me afate reale dhe të arritshme si dhe me persona përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tyre.
5	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'* rezultoi se nga ana e Grupit Teknik të Punës të ngritur për përcaktimin e specifikimeve teknike, janë vendosur si kritere për aplikantët dhe ofertuesit mbi ato të nevojshme për kryerjen e këtij investimi. Konkretisht nga auditimi rezultoi se: **A**. Kategoritë e licencave të kërkuara nuk janë në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së aplikantëve ne këtë fazë. Konkretisht: - *Licenca D për Punime gërmimi* është më tepër se 10 herë më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; - *Licenca* G për *Ndërtime civile dhe industriale* është më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; - *Licenca* B për *Punime për prishjen e ndërtimeve* është më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; **B**. Në lidhje me xhiron minimale vjetore është kërkuar shuma *2,038,000,000 lekë e llogaritur si total i pagesave të certifikuara të marra për kontrata në progres dhe/apo të kryera brenda 5 viteve të fundit, pjesëtuar për 5* kur në fakt, duke bërë diferencën sipas udhëzimeve të *Manualit të Parakualifikimit për Prokurimin e Punimeve dhe Guidës së Përdoruesve*, Seksioni III Kërkesat dhe Kriteret e Kualifikimit, faqe 27, pas pikës 3.2 Xhiroja Mesatare vjetore në ndërtim, paragrafit shpjegues ku citohet se: *"Shuma e cituar, normalisht nuk duhet të jetë më pak se dyfishi i xhiros vjetore të vlerësuar në kontratën e propozuar të Punëve (bazuar në një parashikim linear të kostos së vlerësuar nga Punëdhënësi, duke përfshirë edhe shumat e paalokuara (fondin rezervë), gjatë kohëzgjatjes së kontratës). Shumëzuesi prej 2 mund të zvogëlohet për kontrata shumë të mëdha (p.sh, më të mëdha se 200 mln dollarë ekuivalent) por nuk duhet të jetë më pak se 1.5. Periudha kohore është zakonisht pesë vjet ose më shumë, por mund të reduktohet në jo më pak se tre vjet (në marrëveshje me Bankën) në rrethana të veçanta të vendit, në mënyrë të tillë që të sigurohet mundësi për një industri ndërtimi të sapo krijuar me vetëm një përvojë të shkurtër kohore, etj."* rezulton se kërkesa për xhiro mesatare vjetore është bërë **1,010,521,744 lekë më tepër** *(2,038,000,000 lekë – 1,027,478,256 lekë)* se ai i përcaktuar sipas rregullave të parashikuara nga Banka Botërore, ose sa dyfishi i asaj të kërkuar.	44 ï 82	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.
6	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se në raportin e	44 ï 82	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët

	vlerësimit nga ana e Komisionit përkatës është cituar se: *'... çmimet janë plotësisht në përputhje me Manualin e Ndërtimit (sipas ligjit shqiptar) dhe në përputhje me BoQ të Projektit në lekë...'*. Gjithashtu, në faqen 13 të këtij materiali, paragrafi *Analizat e Çmimeve,* është cituar se *"Komisioni i Vlerësimit ka rishikuar me kujdes analizat e çmimeve nga të dy ofertuesit dhe arriti dhe gjithashtu bëri një krahasim me çmimet e përgatitura nga ana e shoqërisë e cila përgatiti hartimin e projektit'*. Në fakt, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e BOE të shpallur fitues S. T. L. S. & .... ShPK nuk disponohen në dosje të gjitha analizat e çmimeve të preventivit pasi janë paraqitur të tilla vetëm një material me 108 faqe e cila përmban 496 analiza çmimesh <u>në të cilat nuk përfshihen</u>: Godina Ekzistuese: - Analizat e çmimeve për 40 zëra tek Kategoria Punime Elektrike, nën kategoria *Punime për pajisjet elektrike* me vlerë të ofertuar <u>8,855,250 lekë pa TVSH</u>; - Analizat e çmimeve për 182 zëra tek Kategoria Punime Mekanike, me vlerë të ofertuar <u>52,178,824 lekë pa TVSH</u>; Shtesa Anësore: - Analizat e çmimeve për 65 zëra tek Kategoria Punime Elektrike, me vlerë të ofertuar <u>2,345,200 lekë pa TVSH</u>; - Analizat e çmimeve për 56 zëra tek Kategoria Punime Elektrike, nën kategoria *Punime për pajisjet elektrike* me vlerë të ofertuar <u>41,767,250 lekë pa TVSH</u>; - Analizat e çmimeve për 433 zëra tek Kategoria Punime Mekanike, me vlerë të ofertuar <u>97,842,850 lekë pa TVSH</u>; - Analizat e çmimeve për 97 zëra tek Kategoria Punime Mekanike, nën kategoria *Punime për pajisjet mekanike* me vlerë të ofertuar <u>91,088,000 lekë pa TVSH</u>; Pra në total rezulton se nga ana e BOE të shpallur fitues <u>nuk janë paraqitur</u> në total analizat e çmimeve për gati <u>1369 zëra pune</u>, ose gati <u>70 %</u> e totalit të tyre në numër dhe <u>294,077,374 lekë pa TVSH</u>, ose mbi <u>33 %</u> në vlerë.			përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura duke patur si qëllim kryesor mirë përdorimin e fondeve të Projektit.
7	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit'*, rezultoi se në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës janë paraqitur për ofertuesit e mundshëm disa kërkesa si më poshtë: **A**. <u>Kategoritë e licencave</u> të kërkuara nuk janë në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së aplikantëve ne këtë fazë. Konkretisht: - *Licenca B për Punime gërmimi* është më tepër se 10 herë më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; - *Licenca* F për *Punime për prishjen e ndërtimeve* është më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; - *Licenca* B për *Punime për Rruge, Trotuare dhe Gjelbërim* është më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; - *Licenca* D për *Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri* është më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; - *Licenca* E për *Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit* është më e lartë nga ajo e nevojshme për	44 ï 82	E lartë	Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

	tu vendosur si kriter; - *Licenca* C për *Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni* është më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; - *Licenca* C për *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni* është më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter; **B.** Në lidhje me Eksperiencën e Mëparshme, në paragrafin 4 Eksperienca, pika 4.2 (b), është kërkuar që Aplikantët duhet të paraqesin si kontratë të ngjashme *"1 kontratë me volume gërmimi prej 15,000 dhe punime betoni me një sasi prej minimumi 7,000 m^3"*. Në fakt nga analiza e Preventivit të punimeve rezulton se në total punimet e gërmimit janë në sasinë prej 3,565 m^3, ose gati 4 herë më pak. Gjithashtu, për sa i përket punimeve të betonit rezulton se volumi total i punimeve të betonit është në sasinë prej 2340 m^3, ose 3 herë më pak.			
8	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale, Loti 3 Radiologjia'*, rezultoi se në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës të dorëzuara Njësisë së Koordinimit të Projektit konstatohet se këto specifikimet nuk i janë referuar në asnjë rast standardeve të kërkuara për pajisjet objekt prokurimi. Për të gjitha pajisjet dhe pjesët shoqëruese të tyre janë përdorur parametra duke cituar shprehje si: Për Pajisjen X-Ray Fuqia e gjeneratorit *jo më pak se* 50 kW; Voltazhi i X-ray nga 40 në 125 kV; Rangu i lëvizjes horizontale *rreth* 180 cm; Përmasat e tavolinës *afërsisht* 210 x 80 cm; Pesha maksimale ngritëse *min*. 180 kg; Syze X-Ray *afërsisht* 80 cm x 40 cm; Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 kHU; Etj. Për Pajisjen X-Ray e lëvizshme: Gjeneratori X-ray min. 32 kW; Gjeneratori X-ray me frekuencë 40 Hz; Rangu u voltazhit të tubit 40 ï 125 kV me 1 KV shtesë; Rangu i mAs: 0.1 deri në 100 mAs; Fokusi i vogël min. 0.8 mm, fokusi i madh min. 1.3 mm; Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 100 kHU; Rangu i rregullimit të distancës fokus ï film *afërsisht* 40 ï 200 cm; Rezolucioni *minimal* 3.0 lp/mm; Fusha e pikselit *max* 150 ¿m; Rrotullimi i Tubit rreth suportit +/- 180 ^{0}; Panel i sheshtë detektimi me fushë aktive të shikimit *min*. 35 x 43 cm; Etj.; Për Pajisjen Radiografi dhe Fluoroskopi: Fuqia e gjeneratorit *jo më pak se* 50 kW; Radiografia mA, *deri në të paktën* 550 mA; Fluoroskopi 50 kVp ï 125 Vp; Fuqia e llambës *jo më pak se* 50 kW; Fokus i dyfishtë: fokusi i vogël 0.8 mm ose më pak, fokusi i gjerë 1.3 *afërsisht*; Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 kHU; Tavolina më përmasa *afërsisht* 220 x 65 cm; Lartësia e tavolinës *afërsisht* 110 cm; Diametri i intensifikuesit të imazhit *jo më pak se* 23 cm; Fuqia e monitorit 50/60 Hz, 220/230 V; Paneli vertikal me një rang të dimensioneve të kasetës nga 18 x 24 cm në 35 x 43 cm; Lëvizja vertikale e kasetës *afërsisht* 40 ï 190 cm nga qendra; Etj.; Për Pajisjen Mamografi: Rangu i voltazhit 22 ï 35 KV; Anoda e rrotullueshme *e preferueshme* me një anode Tungstani për të reduktuar dozën me fokus *afërsisht* 0.1 ï 0.3 mm; Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 kHU; Rrotullimi i boshtit *afërsisht* 0 -+ 90 gradë; 0 ï 150 gradë i motorizuar; Rregullim i lartësisë i motorizuar deri në 75 cm me frena elektromagnetike; Dimensione të detektorit të aktivizimit *jo më pak se* 24 x 30 cm;	44 ï 82	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

	Maksimumi i dimensionit të pikselit 100 ζm; Etj.; Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se specifikimet teknike të vendosura nga ana e grupit teknik të punës nuk janë konform kërkesave të Manualit Operacional të Projektit pasi nuk përmbushin në mënyrën e duhur detyrimet e pikës 3.5.4 *Specifikime Teknike*. Me përjashtim të një rasti të vetëm ku është përmendura standardi EN 60601 ï 1 ï 1 ï 3, në asnjë rast tjetër, këto specifikime nuk i janë referuar standardeve dhe nuk janë japin një deklaratë të qartë pasi në të gjitha rastet janë vendosur kufij minimal, maksimal apo kërkesa për parametra brenda një diapazoni të caktuar. Nga ana e Grupit Teknik nuk janë marrë masa për përdorimin e Standardeve ndërkombëtare apo shqiptare në hartimin e specifikimeve teknike. Sipas paragrafit 3.5.4 është kërkuar që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të merren në konsideratë: - Konfirmimi me standardet; - Përcaktim i qartë i natyrës së kërkesës; Këto kritere, të cituara në mënyrë të tillë, përveç se nuk përmbushin kërkesat për të qenë të qarta dhe që ti referohen standardeve, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura për paracaktimin e operatorit ekonomik fitues.			
9	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale., Loti 3 Radiologjia'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultuan mangësitë si më poshtë: <u>Nga auditimi konstatohet se:</u> 1. Subjektet S. M. ShPK H. L. ShPK nuk përmbushin kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii). Konkretisht rezulton se sipas pikës 3.1 Kërkesat e paskualifikimit citohet se: *"Dokumentet e mëposhtme duhet të përfshihen në ofertë:* *Evidencë e dokumentuar e kualifikimeve të ofertuesit për të realizuar kontratën nëse oferta e tij është pranuar që:* *i. Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues prodhon (krijon ose prodhon):* - *Ofertuesi është i themeluar në vendin e prodhimit të mallrave;* - *Është i licencuar nga autoriteti rregullues në vendin e prodhimit për të furnizuar mallrave;* - *Ka prodhuar dhe tregtuar produktet specifike pjesë e këtyre dokumenteve për të paktën 2 vjet dhe produkte të ngjashme për të paktën 5 vjet;* *ii. Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues nuk prodhon (krijon ose prodhon):* - *Ofertuesi është autorizuar në mënyrën e duhur nga një prodhues i mallrave i cili përmbush kriteret e pikës (i) së mësipërme për të furnizuar Mallrat në vendin e blerësit"*; Ky bashkim operatorësh nuk rezulton të ketë dorëzuar dokumentet e nevojshme për plotësimin e pikave të paragrafit *ii*; 2. Subjektet S. M. ShPK dhe H. L. ShPK nuk disponojnë në certifikatën e konformitetit sipas Normës ISO 9001:2008, tek *Qëllimi*, Importim të pajisjeve teknologjike duke mos përmbushur kështu kriterin sipas të cilit është përcaktuar se:	44 ï 82	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

	"Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 për import, tregtim, instalim, mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore"; 3. Subjektet S. M. ShPK dhe H. L. ShPK nuk kanë specifikuar datën e saktë të fillimit dhe përfundimit të kontratave kryesore të furnizimi siç përcaktohet në kriterin: *"Një listë të kontratave kryesore të furnizimit të kryera brenda pesë viteve të fundit, duke siguruar informacion të detajuar në lidhje me emrin e klientit, adresat e kontaktit, emrin e pajisjeve të pajisura, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës"*; 4. Subjekti H. L. ShPK nuk përmbush kriterin në lidhje me referencën pasi kontrata për të cilinë ky subjekt ka paraqitur referencën përkatëse ka si objekt *"Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për vitin 2016"*. Kjo kontratë, nuk është kontratë furnizimi në radhë të parë por është kontratë mirëmbajtjeje dhe së dyti nuk cilëson zërat (pajisjet e mirëmbajtura). Edhe referenca për kontratën me objekt *"Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësorë për vitin 2015"* është me të njëjtën problematikë si më sipër. Në kushte të tilla këto dokumente nuk duhet të ishin marrë në konsideratë; Marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur me datë 15.03.2017 midis subjekteve H. L. ShPK dhe S. M. ShPK rezulton se ka parashikuar në Draft përshkrimin e kontratës edhe kontributin mes palëve i cili do të jetë në raportet 85 % subjekti S. M. ShPK dhe 15 % subjekti H. L. ShPK, në fakt referuar preventivit të kontratës dhe autorizimeve për të cilat këta subjekteve kanë marrë miratimin në lidhje me tregtimin e produkteve rezulton se ky raport është në masën 81 % S. M. ShPK dhe 19 % H. L. ShPK.			
10	Për procedurën me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale., Loti 3 Radiologjia'*, në vijim të konkluzionit të arritur në lidhje me specifikimet teknike të cilat rezultuan se nuk janë zbatuar në përputhje me kërkesat e paragrafit 3.5.4 ku është kërkuar që këto specifikime ti referohen Standardeve dhe të jenë të tilla që të përfaqësojnë një deklaratë të qartë, grupi i auditimit krahasoi këto specifikime me ato të pajisjeve të JV S. M. ShPK & H. L. ShPK të shpallur fitues. Nga krahasimi rezulton se këto parametra përveçse nuk janë të tilla që të kenë referencë standardet përkatëse apo të jenë një deklaratë e qartë e asaj çka kërkohet, por njëkohësisht ato janë të tilla që përputhen saktësisht me parametrat e ofruar nga ana e bashkimit të subjekteve të shpallur fitues duke mbështetur kështu konkluzionin e arritur në paragrafin e mësipërm sipas të cilit, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura me qëllim kualifikimin dhe shpalljen fitues të subjekteve S. M. ShPK & H. L. ShPK.	44 ï 82	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.
11	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale,* Loti 1 *"Kujdesi Intensiv"*; Loti 4 *"Oftalmoskopi"*; Loti 6 *"Angiografi"*, rezultoi se specifikimet teknike të përcaktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës të dorëzuara Njësisë së Koordinimit të Projektit, nuk i janë referuar standardeve të kërkuara për pajisjet objekt prokurimi. Për të gjitha pajisjet dhe pjesët shoqëruese të tyre për Lotin 1, Lotin 4 dhe Lotin 6 rezulton se janë kërkuar parametra konkretë dhe/ose diapazone të tyre por në asnjë rast nuk janë cituar standarde referuese. Kjo situatë është konstatuar në të gjitha Lotet për pajisje si: **Loti 1**	44 ï 82	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

	Defibrilator; Inkubator; Transportues inkubatori; Pompë infuzioni; Pompë shiringash; Elktro-kirurgji; Nebulizator; Monitor; Makineri anestezie; Ventilatorë; EEG; **Loti 4** Auto refraktometër; Set lentesh; Kornizë lentesh; Etj; **Loti 6** Krahu ï C; Imazhet digjitale dhe post ï procesimi; Etj; Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se specifikimet teknike të vendosura nga ana e grupit teknik të punës nuk janë konform kërkesave të Manualit Operacional të Projektit pasi nuk përmbushin në mënyrën e duhur detyrimet e pikës 3.5.4 *Specifikime Teknike.* Këto specifikime nuk i janë referuar standardeve dhe nuk janë japin një deklaratë të qartë pasi pothuajse në të gjitha rastet janë vendosur kufij minimal, maksimal apo kërkesa për parametra brenda një diapazoni të caktuar. Nga ana e Grupit Teknik nuk janë marrë masa për përdorimin e Standardeve ndërkombëtare apo shqiptare në hartimin e specifikimeve teknike. Sipas paragrafit 3.5.4 është kërkuar që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të merren në konsideratë: - Konfirmimi me standardet; - Përcaktim i qartë i natyrës së kërkesës; Këto kritere, të cituara në mënyrë të tillë, përveç se nuk përmbushin kërkesat për të qenë të qarta dhe që ti referohen standardeve, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura.			

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Projektit *'Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor'* për periudhën nga fillimi i Projektit (2015) deri më 31.05.2021 nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Krahas parregullsive materiale sasiore, në arritjen e opinionit, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

Në përfundim të auditimit, pasi u morën dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.***

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Zyra e Koordinimit të Projektit *'Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor'*, e cila konsiderohet nga ana jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve

Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 ñStandardet e Auditimit të Përputhshmërisëò, ISSAI 1500 (ISA 500)[1] dhe ISSAI 1530 (ISA 530)[2]; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinioni në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinioni të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

- Si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të zyrtarëve dhe punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të Projektit prej **2,089,995 lekë** në procedurat e zbatimit të kontratave;
- Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve të Projektit dhe menaxhim pa ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet i tyre në vlerën prej **45,600,000 lekë** në drejtim të procedurave të kryera për kontratat e shërbimeve;
- Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve të Projektit dhe menaxhim pa ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet i tyre në vlerën prej **22,901,284 lekë** në drejtim të zbatimit të kontratave të punimeve civile;
- Mangësi në drejtim të hartimit të kritereve dhe specifikimeve teknike gjatë procedurave të prokurimit;
- Etj.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të MSHMS:

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Koordinatori i Përgjithshëm i Projekti, Zyra e Koordinimit të Projektit, Koordinatorët e Projektit si dhe Grupet e Punës të angazhuar me procedurat e Prokurimit, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike. Strukturat drejtuese të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[3], nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson

[1] *Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.*

[2] *Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.*

[3] *ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.*

identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 579/1, datë 04.06.2021 miratuar nga

Kryetari i KLSH, i ndryshuar me shkresën nr. 579/2 prot., datë 30.07.2021 si dhe autorizimeve me nr. 579/3 prot., datë 09.08.2021 dhe nr. 579/31 prot., datë 15.09.2021 nga data 04.06.2020 deri me datë 10.08.2021, në subjektin *"Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Projekti 'Përmirëimi i Sistemit Shëndetësor"*, për periudhën nga fillimi i Projektit (2015) deri më 31.05.2021, u krye *"Auditim mbi Përputhshmërinë"* nga Grupi i Auditimit me përbërje:
J. H., Përgjegjës Grupi,
A. L., Auditues,
K. M,, Audituese.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi nga fillimi i Projektit (2015) deri më datë 31.05.2021 përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit ligjor dhe rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse. Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të kësaj veprimtarie audituese janë:
1. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
2. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
3. Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse;
- Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;
- Veprimtaria e Zyrës së Koordinimit të Projektit është në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
- Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit.

4. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të kuadrit rregullator përkatëse të prokurimit, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore;
6. Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së Zyrës së Koordinimit të Projektit.
Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar. Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:
- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;

- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

3. Identifikimi i çështjes:

Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Zyrës së Koordinimit të Projektit për periudhën nga fillimi i Projektit (2015) - 31.05.2021 ka identifikuar sipas kritereve të specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Auditimin e marrëveshjeve të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit.
- Auditimin e menaxhimit financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve si dhe Raportimin e tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
- Shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projekteve në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.
- Prokurimin e fondeve të kredisë si dhe ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit.
- Zbatimin e kontratave të lidhura për mallra, shërbime dhe punime përfshirë verifikimin dhe inspektimin në lidhje me produktet finale të këtyre kontratave.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

5. Përgjegjësitë e audituesve:
Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti ekonomik dhe financiar përputhet, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje financimi, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen dhe zbatohen etj.;
- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerësimit
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 ñMbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji nr. 57/2015 *"Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Ligji nr. 9355, datë 10/03/2005 ñPër ndihmën dhe shërbimin shoqërorò, të ndryshuar, VKM nr. 452, datë 01.07.1998 ñPër disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huajò, VKM nr. 775, datë 24.09.2010 *"Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë"*, VKM nr. 116, datë 24.02.1997 ñPër kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisëò, VKM nr. 452, datë 01.07.1998 ñPër disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huajò, Rregullore ñMbi Procedurat e auditimit në KLSHò, miratuar me vendimin nr. 63, datë 22.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar, Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH me nr. 66 datë 23.06.2020, ñUdhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-sò, të datës 15 Tetor 2006 dhe të rishikuar në janar të vitit 2011, ñUdhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botëroreò, i muajit janar të vitit 2011 (i rishikuar në korrik 2014), ñUdhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe i shërbimeve jokonsulente në kuadrin e huave të IBRD-së dhe krediteve e granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botëroreò të muajit Janar 2011 (i rishikuar në Korrik 2014), Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Udhëzim i MF nr. 8, datë 17.02.2003 ñPër evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajò, Udhëzimin e MF nr. 20, datë 24.12.2003 ñ*Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësive të menaxhimit, zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të hua*jò si dhe

Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e Njësive të Menaxhimit të Projekteve.

7. Standardet e auditimit

Raporti Përfundimtar i Auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 ï 165);
- Ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
- ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400 - Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 - Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëò;
- ISSAI 1500 (ISA 500) - Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530) - Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò;

8. Metodat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* ï mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e Zyrës së Koordinimit të Projektit dhe stafit të angazhuar të MSHMS kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera, arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacioneve të subjektit, takimeve ballafaquese në subjekt, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Projektit *'Për përmirësimin e sistemit në shëndetësi'*, është lidhur me donatorin IBRD një marrëveshje financimi (Loan Agreement) e cila ka hyrë në fuqi me 24 Mars 2015 dhe në vijim

kjo marrëveshje është ratifikuar me ligjin nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""* dhe botuar në fletoren zyrtare nr. 105, datë 23.06.2015. Kjo marrëveshje ka parashikuar si datë të mbylljes së Projektit 28.02.2021, si dhe financimin sipas tabelës së mëposhtme:

_____Tabela nr. 1

Nr.	Zëri	Shuma e alokuar e huas (Euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (duke përfshirë taksat)
1	Punime	**6,760,000**	**63 %**
2	Mallra, Shërbime jo Konsulente	**18,360,000**	**100 %**
3	Shërbime Konsulence, trajnim dhe kosto	**6,500,000**	**100 %**
4	Komisioni i Administrimit	**80,250**	**Shuma të pagueshme në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07/b të kushteve të përgjithshme**
5	Tavanani i normës së interesit ose primi i normës së interesit brenda një intervali të caktuar	**0**	**Shumë e kërkueshme në përputhje me seksionin 2.08/c të kësaj Marrëveshjeje**
6	Të alokuara	**399,750**	
	TOTAL	**32,100,000**	

Referuar marrëveshjes së ratifikuar si më sipër, disa nga elementët kryesorë janë:

- Njësia e zbatuese e Projektit është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i cili është edhe subjekti që garanton zbatimin e Projektit në përputhje me marrëveshjen (nenin 2);
- Vlera e projektit **32,100,000 Euro** (e ndarës në zëra sipas tabelës së mësipërme);
- Objektivat e projektit janë të kontribuojë në:
  a) përmirësimin e efikasitetit të kujdesit në spitalet e përzgjedhura në territorin e Huamarrësit;
  b) përmirësimin e menaxhimit të informacionit në sistemin shëndetësor;
  c) rritjen e aksesit financiar për shërbime shëndetësore.
- Afati i përfundimit të Projektit është datë 28.02.2021;
- Data e pagesave të huas janë 15 maji dhe 15 nëntor i çdo viti;

Me qëllim hyrjen në fuqi të marrëveshjes, Banka ka miratuar Manualin Operacional të Programit dhe në vijim janë lidhur kontratat e punës për një menaxher Projekti, një specialist të menaxhimit financiar dhe një specialist prokurimesh,

Strukturat dhe angazhimet përkatëse për implementimin e Projektit

Referuar Manualit të Operimit të Projektit (POM) strukturat kryesore të Projektit janë:

I. Zv. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (me Manualin Operacional të Ndryshuar është caktuar Ministri i Shëndetësisë);
II. Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit;
III. Koordinatori për çdo Komponent;
IV. Grupi i Teknik i Punës për çdo Komponent;
V. Njësia e Koordinimit të Projektit;

MSHMS është agjencia lider në implementimin e Projektit e cila ka parashikuar të ketë një përgjegjësi fiduciare përmes Njësisë së Koordinimit të Projektit të ngritur për këtë qëllim. Zv. Ministri i Shëndetësisë/Ministri është caktuar si personi kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen dhe

koordinimin brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve kyçe të përfshira në Projekt të cilat janë:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
3. Fondi i Sigurimit Shëndetësor;
4. Qendra Kombëtare e Informacionit Shëndetësor (hequr nga lista e institucioneve kyçe pas shkrirjes së tij dhe marrjes së kompetencave nga AKSHI);
5. Njësia e Menaxhimit Spitalor;

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për pozicionet Koordinator i Përgjithshëm i Projektit, Koordinator Komponenti dhe Grupet Teknike për Komponent kanë qenë si më poshtë:

Tabela 2

Përshkrimi	Personi i Autorizuar/Caktuar	Dokumentimi
Menaxher i Përgjithshëm i Projektit	1. Znj. M. E., ish- Zv. Ministër; 2. Z. Th. G., ish ï Këshilltar i Ministrit; 3. Znj. E. H., Drejtor Kabineti në MSHMS;	1. Dokumenti i Vlerësimit të Projektit (PAD), emëruar me Urdhër nr. 424, datë 02.10.2015 të Ministrit të MSHMS (deri me datë 11.03.2016); 2. Emëruar me Urdhër nr. 96, datë 11.03.2016 të Ministrit të MSHMS (deri me datë 16.10.2017); 3. Emëruar me Urdhër nr. 96, datë 11.03.2016 të Ministrit të MSHMS (aktualisht);
Koordinator Projekti për **Komponentin 1**	1. z. P. M.; 2. znj. F. B.;	1. Emëruar sipas Urdhrit të zv. Ministrit të datës 12 Tetor 2015; 2. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 728, datë 16.10.2018, me nr. 5955 prot;
Grupi i Teknik i Punës për **Komponentin 1**	1. Znj. S. N.; 2. Znj. L. P.; 3. Znj. A. L. ; 4. Znj. T. C.; 5. Znj. D. K.; Zëvendësuar me: 1. Znj. M. H.; 2. Znj. J. D.; 3. Znj. M. C. ; 4. Z. B. M.; Zëvendësuar me: 1. Znj. M. C.; 2. Znj. J. D.; 3. Znj. M. C. ; 4. Z. B. M.;	1. Emëruar sipas Urdhrit të zv. Ministrit të datës 12 Tetor 2015, 22 Dhjetor 2015 dhe 24 Mars 2016; 2. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 728, datë 16.10.2018, me nr. 5955 prot; 3. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 782, datë 18.12.2019, me nr. 5836 prot;
Koordinator Projekti për **Komponentin 2**	1. z. K. B.; 2. znj. M. P.; 3. z. L. Q.; 4. z. D. L.; 5. znj. O. Dh.;	1. Emëruar sipas Urdhrit të zv. Ministrit të datës 12 Tetor 2015; 2. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit përmes letrës zyrtare të datës 6 Janar 2017; 3. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit përmes letrës zyrtare nr. 3230/5 datë 25.05.2018; 4. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 854 datë 15.12.2018; 5. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 741 datë 31.12.2020;

Grupi i Teknik i Punës për **Komponentin 2**	1. Z. T. Th. 2. Z. A. Q. 3. Znj. M. P. Zëvendësuar me: 1. Z. T. Th. 2. Z. A. Q. 3. Z. P. K. Zëvendësuar me: 1. Z. A. M. 2. Z. A. C. 3. Z. B. M. 4. Z. P. M. Zëvendësuar me: 1. Znj. F. B. 2. Z. B. M. 3. Z. L. Q. Zëvendësuar me: 1. Znj. F. B. 2. Z. B. M. 3. Z. E. L. Zëvendësuar me: 1. Znj. F. B. 2. Z. E. L.	1. Emëruar sipas Urdhrit të zv. Ministrit të datës 12 Tetor 2015; 2. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit përmes letrës zyrtare të datës 6 Janar 2017; 3. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit përmes letrës zyrtare nr. 3230/5 datë 25.05.2018; 4. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 854 datë 15.12.2018; 5. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 216 datë 26.03.2019; 6. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 741 datë 31.12.2020;
Koordinator Projekti për **Komponentin 3**	1. Znj. D. R. Komponenti është fshirë pas ristrukturimit të Projektit 1. Z. I. Th.	1. Emëruar sipas Urdhrit të zv. Ministrit të datës 12 Tetor 2015; 2. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 447, datë 12.06.2018;
Grupi i Teknik i Punës për **Komponentin 3**	Znj. L. H. 1. Z. A. H. 2. Z. Zh. L. Zëvendësuar me: 1. Z. A. V. 2. Z. A. Q. 3. Znj. M. M.	1. Emëruar sipas Urdhrit të zv. Ministrit të datës 12 Tetor 2015; 2. Emëruar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 447, datë 12.06.2018;

Marrëveshja e financimit e ratifikuar ka pësuar 2 ndryshime në total.

1. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Mbi auditimin e marrëveshjeve të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit.

Në zbatim të kësaj pike të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1- *Marrëveshja e huas sipas Ligjit nr. 57/2015 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"";*

2- *Marrëveshja e financimit e lidhur mes Republikës së Shqipërisë (RSH) dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (nga anglishtja IBRD)) e datës 24 Mars 2015 në lidhje me kredinë nr. 8466-AL;*

3- *Korrespodencat mes Zyrës së Koordinimit të Projektit (PMU), Ministrisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si dhe IBRD)*;

Sipas dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se për implementimin e Projektit *'Për përmirësimin e sistemit në shëndetësi'*, është lidhur me donatorin IBRD një marrëveshje financimi *(Loan Agreement)* e cila ka hyrë në fuqi me 24 Mars 2015 dhe në vijim kjo marrëveshje është ratifikuar me ligjin nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""* dhe është botuar në fletoren zyrtare nr. 105, datë 23.06.2015. Kjo marrëveshje ka parashikuar si datë të mbylljes së Projektit 28.02.2021, si dhe financimin sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 3

Nr.	Zëri	Shuma e alokuar e huas (Euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (duke përfshirë taksat)
1	Punime	**6,760,000**	**63 %**
2	Mallra, Shërbime jo Konsulente	**18,360,000**	**100 %**
3	Shërbime Konsulence, trajnim dhe kosto	**6,500,000**	**100 %**
4	Komisioni i Administrimit	**80,250**	**Shuma të pagueshme në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07/b të kushteve të përgjithshme**
5	Tavanani i normës së interesit ose primi i normës së interesit brenda një intervali të caktuar	**0**	**Shumë e kërkueshme në përputhje me seksionin 2.08/c të kësaj Marrëveshjeje**
6	Të alokuara	**399,750**	
	TOTAL	**32,100,000**	

Referuar marrëveshjes së ratifikuar si më sipër, disa nga elementët kryesorë janë:

- Njësia e zbatuese e Projektit është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i cili është edhe subjekti që garanton zbatimin e Projektit në përputhje me marrëveshjen (nenin 2);
- Vlera e projektit **32,100,000 Euro** (e ndarës në zëra sipas tabelës së mësipërme);
- Objektivat e projektit janë të kontribuojë në:
  a) përmirësimin e efikasitetit të kujdesit në spitalet e përzgjedhura në territorin e Huamarrësit;
  b) përmirësimin e menaxhimit të informacionit në sistemin shëndetësor;
  c) rritjen e aksesit financiar për shërbime shëndetësore.
- Afati i përfundimit të Projektit është datë 28.02.2021;
- Data e pagesave të huas janë 15 maji dhe 15 nëntor i çdo viti;

Me qëllim hyrjen në fuqi të marrëveshjes, Banka ka miratuar Manualin Operacional të Programit dhe në vijim janë lidhur kontratat e punës për një menaxher Projekti, një specialist të menaxhimit financiar dhe një specialist prokurimesh, konkretisht:

- Sipas shkresës me nr. reference HSIP/CS/IC/01-2015, me datë 26 gusht 2015 është lidhur kontrata për shërbime konsulence mes Ministrit të MSHMS dhe znj. B. D., në cilësinë e Koordinatorit të Projekti, duke filluar nga data 15 shtator 2015 deri më 28 shkurt 2021;
- Sipas shkresës me nr. reference HSIP/CS/IC/02-2015, me datë 26 gusht 2015 është lidhur kontrata për shërbime konsulence mes Ministrit të MSHMS dhe znj. E. D., në cilësinë e Specialistes së Prokurimeve, duke filluar nga data 15 shtator 2015 deri më 28 shkurt 2021;
- Sipas shkresës me nr. reference HSIP/CS/IC/03-2015, me datë 26 gusht 2015 është lidhur kontrata për shërbime konsulence mes Ministrit të MSHMS dhe znj. D. Gj., në cilësinë e Specialistes së Menaxhimit Financiar, duke filluar nga data 15 shtator 2015 deri më 28 shkurt 2021;

<u>Strukturat dhe angazhimet përkatëse për implementimin e Projektit</u>

Referuar Manualit të Operimit të Projektit (POM) strukturat kryesore të Projektit janë:

I. Zv. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (me Manualin Operacional të Ndryshuar është caktuar Ministri i Shëndetësisë);
II. Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit;
III. Koordinatori për çdo Komponent;
IV. Grupi i Teknik i Punës për çdo Komponent;
V. Njësia e Koordinimit të Projektit;

MSHMS është agjencia lider në implementimin e Projektit e cila ka parashikuar të ketë një përgjegjësi fiduciare përmes Njësisë së Koordinimit të Projektit të ngritur për këtë qëllim. Zv. Ministri i Shëndetësisë/Ministri është caktuar si personi kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve kyçe të përfshira në Projekt të cilat janë:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
3. Fondi i Sigurimit Shëndetësor;
4. Qendra Kombëtare e Informacionit Shëndetësor (hequr nga lista e institucioneve kyçe pas shkrirjes së tij dhe marrjes së kompetencave nga AKSHI);
5. Njësia e Menaxhimit Spitalor;

Sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion rezulton se në total marrëveshja e financimit e ratifikuar me ligjin nr. 75/015 ka pësuar dy ndryshime të cilat paraqiten si më poshtë:

I. Me VKM nr. 339 datë 22.05.2019 *"Për miratimin në parim të letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Projektin 'Për përmirësimin e sistemit të Shëndetësisë', të ratifikuar me ligjin nr. 57/2015"*;

Sipas kësaj VKM janë bërë këto ndryshime:

- MSH është zëvendësuar me MSHMS;
- Është fshirë Pjesa 1 ku citohet se: *'Objektivi i Projektit është të kontribuojë në modernizimin e shërbimeve të përzgjedhura të spitaleve publike'* duke u zëvendësuar në tërësinë e tij nga Shtojca A e letrës së Amendimit;
- Tek Pjesa 2, Ekzekutimi i Projektit, në seksionin I.A, në paragrafi1 (b) është ndryshuar dhe nën paragrafi 2 është fshirë. Si rrjedhojë, seksioni I.A është ndryshuar dhe zëvendësuar në tërësinë e tij;

II. Me VKM nr. 829 datë 21.10.2020 *"Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare*

për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin "Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë", të ratifikuar me ligjin nr. 57/2015";

Sipas kësaj VKM janë bërë këto ndryshime:

- Është vendosur data 31 dhjetor 2022 si datë të mëvonshme për qëllimet e seksionit IV.B.2 të shtojcës 2 të Marrëveshjes së Huas;
- Është ndryshuar përqindja e disbursimit të kategorisë 1 në 100% (përfshirë taksat);
- Janë rialokuar të ardhurat e Huas, siç përcaktohet në tabelën në seksionin IV.A.2 të shtojcës 2 të Marrëveshjes, siç tregohet në shtojcën bashkëlidhur letrës së shkëmbyer me Bankën Ndërkombëtare;

2.2 Mbi auditimin e menaxhimit financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve si dhe Raportimin e tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Auditimi u bazua në dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ligji nr. 57/2015, datë 28.5.2015 ñPër ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin ñPër përmirësimin e sistemit te shëndetësisëò;
- Raportimet periodike të PCU në Bankën Botërore;

- Raportimet periodike të PCU në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë;
- Raporti i audituesit ligjor për pasqyrat financiare te viteve 2015,16,17,18,2019, si dhe pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2020 të përcjella pranë MFE.

2.2.1. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për Projektin "Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë"

Buxheti ñPër përmirësimin e sistemit të shëndetësisëò është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përkatësisht, për vitin 2015 me shkresën nr. 241/1 datë 20.01.2015 ñÇelja e Buxhetit 2015ò, vitin 2016 me shkresat nr. 668 datë 02.02.2016 ñÇelja e Buxhetit 2016" dhe shkresa me nr. 6251/5 datë 09.01.2017 ñMbi zbatimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 16.12.2016ò, vitin 2017 me shkresat nr. 79/2 datë 30.01.2017 ñÇelja e Buxhetit 2017-2019ò dhe shkresa me nr. 3659/1 datë 29.08.2017 ñMbi zbatimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 16.08.2017ò, vitin 2018 me shkresat nr. 201/3 datë 15.02.2018 me objekt ñÇelja e Buxhetit 2018-2020, shkresa nr. 4773/8 datë 21.09.2018 ñMbi detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018ò dhe shkresa nr. 6928/1 datë 21.12.2018 ñMbi detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 19.12.2018ò, vitin 2019 shkresa nr. 417/2 datë 04.02.2019 ñÇelja e Buxhetit 2019-2021ò dhe shkresa nr. 4876/5, datë 31.10.2019 "Mbi detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 02.10.2019", vitin 2020 me shkresat respektive nr. 307/3, datë 28.02.2020 ñÇelja e Buxhetit 2020-2022ò, shkresa nr. 23412/12 datë 21.12.2020 "Mbi detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 34, datë 16.12.2020" dhe për vitin 2021 me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 142/3 datë 02.02.2021 me objekt ñÇelja e Buxhetit 2021-2023ò. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për këtë projekt, pasqyrohet në Aneksit nr. 2, tabela nr. 2.1.

2.2.2. Financimi i Projektit "Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë" sipas kategorive përkatese.

Marrëveshja Nr. 8466 për Projektin e ñPërmirësimi i Sistemit Shëndetësorò, midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore është nënshkruar më datë 24.03.2015 dhe është ratifikuar në Parlamentin Shqiptar nëpërmjet Ligjit nr. 57/2015, datë 28.5.2015 ñPër ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin ñPër përmirësimin e sistemit te shëndetësisëò. Marrëveshja është botuar në fletoren zyrtare të vitit 2015 me nr. 105. Marrëveshja është bërë efektive më datë 28.08.2015. Vlera e financimit nga IRBD për këtë marrëveshje është 32,100,000 euro duke përfshirë TVSH dhe taksat lokale. Afati i zbatimit të kësaj marrëveshje është deri me datë 31.12.2022. Ndërkohë që afati i shlyerjes së kredisë është deri më datën 15.05.2037 duke filluar nga data 15.05.2022.

Financimi i projektit sipas kategorive përkatëse paraqitet në tabelën nr. 2.3 të Aneksit 2.

Në referim të Marrëveshjes së Huas, të datës 24.03.2015, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (ñHuamarrësiò) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (ñBankaò) (Marrëveshja e Huas) për Projektin ñPër përmirësimin e Sistemit Shëndetësorò dhe shkresës së MFE së datës 15.09.2020, në të cilën i kërkohet IBDR:

a) zgjatja e datës së mbylljes së projektit;

b) rialokimi i të ardhurave të huas midis kategorive ekzistuese të disbursimeve;

c) ndryshimi i përqindjes së disbursimit të kategorisë 1 (Punimet) deri në 100% (përfshirë taksat).
IBDR ka rënë dakord me kërkesën MFE dhe për këtë arsye:
a) vendosi datën 31 dhjetor 2022 si datë të mëvonshme për qëllimet e seksionit IV.B.2 të shtojcës 2 të Marrëveshjes së Huas;
b) ndryshoi përqindjen e disbursimit të kategorisë 1 në 100% (përfshirë taksat);
dhe c) rialokoi të ardhurat e Huas, siç përcaktohet në tabelën në seksionin IV.A.2 të shtojcës 2 të Marrëveshjes, siç tregohet në tabelën nr. 2.4 tek Aneksi nr. 2.
Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes së Huas do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.
Korrespodenca midis MEF dhe IBRD është botuar në FZ nr. 190 viti 2020.

2.2.3. Niveli i disbursimit të projektit "Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë"
Nga auditimi konstatohet se deri, më datë 31.05.2021, janë disbursuar nga donatori 12,264,482.72 euro, sipas aplikimeve të pasqyruar në tabelën nr. 5, aneksi nr. 2. Niveli i disbursimeve deri më datë 31.05.2021 është në masën 38.21 % të vlerës totale të kredisë, ndërsa përdorimi i kredisë dhe shkalla e realizimit deri më 31.05.2021 është:
1. Për kategorinë ñPunimeò janë parashikuar 13,837,382 euro dhe janë realizuar 3,724,529.71 euro ose 26.92% të fondit të parashikuar për këtë kategori.
2. Për kategorinë ñMallra, shërbime jokonsulenteò janë parashikuar 12,463,794 euro dhe janë realizuar 4,461,151.84 ose 35.79% të fondit të parashikuar për këtë kategori
3. Për kategorinë ñShërbime konsulence, trajnim dhe kosto operativeò janë parashikuar 5,718,574 euro dhe janë realizuar 2,858,820.29 euro ose 49.99 % të fondit të parashikuar për këtë kategori.
4. Për ñKomision për administriminò janë parashikuar 80,250 euro dhe janë realizuar 80,250 euro të fondit të parashikuar për këtë kategori.
Pra në total **janë realizuar 11,124,751.84** euro kundrejt shumës së kredisë prej 32,100,000 euro **ose 34.66%** të totalit të shumës së kredisë për këtë projekt.
Në mënyrë analitike të dhënat mbi shkallën e realizimit të projektit sipas kategorive përkatëse janë pasqyruar në tabelën nr. 2.6, aneksit nr. 2.

2.2.4. Zbatimi i kontratave sipas kategorive.
Për kategorinë ñPunime Civileò janë në zbatim 3 kontrata, në vlerën 1,578,184,322. Për kategorinë ñMallra dhe shërbime jokonsulenteò janë zbatuar 12 kontrata, nga të cilat 5 (pese) në vlerën totale 50,372,077 lekë dhe 7(shtatë) në vlerën totale 8,473,239 euro. Për kategorinë ñShërbimet e konsulencës" janë në zbatim 30 kontrata, nga ku 13 të tilla janë në vlerën 2,966,314 euro, 10 (dhjetë) në vlerën 72,132,615 lekë dhe 7 (shtatë) në vlerën 228,101 USD. Në mënyrë të detajuar mbi zbatimin dhe pagesën e kontratave sipas kategorive, paraqiten në tabelat nr. 7,8,9,10,11,12, të aneksit nr. 2. Shpenzimet për kategorinë ñKosto operative dhe trajnimò për vitin 2015ï 31.05.2021 janë në shumën 87,793 euro ose 0,79 % të totalit të shpenzimeve. Shpenzimet për dërgesa me postë të shpejtë, paga, kancelari, energji elektrike, telefon, mirëmbajtje godine, mirëmbajtje për pajisje zyre, sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë në masën 16.7 % etj.

2.2.5. Raportimi në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë
Në zbatim të VKM nr. 116, datë 24.02.1997 ñPër kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisëò, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 8, datë

17.02.2003 ñPër evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huajò, ndryshuar me Udhëzimin nr. 35, datë 21.09.2020 ñPër kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve ndërkombëtareò, HSIP ka raportuar rregullisht çdo datë 5 të muajit pasardhës në MFE lidhur me disbursimet dhe përdorimin e fondeve për çdo program.

Raportimet në Bankën Botërore

Në zbatim të Marrëveshjes së kredisë, Seksioni II, HSIP, çdo 3 mujor ka raportuar në Bankën Botërore Interim Financial Report (IFR) lidhur me disbursimet dhe përdorimin e fondeve, raportim i përgatitur sipas formatit të miratuar nga Banka Botërore dhe i dërguar në mënyrë elektronike.

Auditimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare të projektit janë subjekt i auditimit të jashtëm. Ky proces për vitin ushtrimor 2015-2016,2017,2018,2019, është kryer nga kompania ñG. Th.ò e përzgjedhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Raporti i Auditimit është publikuar në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, HSIP ka përgatitur dhe dorëzuar pranë MFE Pasqyrat Financiare të institucionit për vitin ushtrimor 2020 me shkresën nr. 22 datë 30.03.2021.

2.2.6. Programi A.. P..

Në kuadër të projektit ñPër përmirësimin e sistemit të shëndetësisëò është nënshkruar kontrata HSIP/G/SH/02-2015, nr. 578/4 prot., datë 23.02.2016 me operatorin ekonomik ñI...ò, për blerjen dhe instalimin e programit financiar ñA.. P..ò për njësinë e koordinimit të projektit (PCU) në shumën 576,000 lekë (me TVSh) ose 4,608 euro. Fondi i parashikuar për këtë program të menaxhimit financiar të projektit është 5,000 euro.

1.Titulli i gjetjes:	Aktiviteti ekonomiko financiar i projektit HSIP, nuk mbahet me programin A.. P...
Situata:	1. Programi A.. P.. i dorëzuar nga kompania I..., është në versionin demo dhe CD-ja e dorëzuar mbanë emërtimin ñCD demo A... B...ò. Programi që gjendet brenda kësaj CD-ROM nuk mund të instalohet në PC nga specialistja e financës së projektit. Fotoja e CD-ROM, të dorëzuar nga kompania I..., paraqitet tek aneksi nr. 2 figura nr. 1. Mungesa e instalimit të programit A.. P.. nga anëtarët e PCU, është në mospërputhje me parashikimin e aneksit nr. 22 të POM seksioni III. ñPerformance parametersò, citoj: *Softueri duhet të paraqitet në një CD së bashku me udhëzimet për instalim dhe përdorim dhe të jetë i mundur që të instalohet nga përdoruesi në kompjuterin e specialistit të financës së projekti*t. 2**.** Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe raporteve tremujore u konstatua se programi financiar A.. P.., i kontraktuar dhe i blerë nga kompania I..., ka shfaqur problematika në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe gjenerimit të raporteve të ndryshme. Referuar informacionit përmbledhës së datës 07.06.2021, të specialistes së financës së projektit HSIP në lidhje me problematikat e shfaqura të programit A.. P.., ndër të tjera informon se:

ñé *Në shkurt të 2020, gjatë përpjekjes për gjenerimin e raportit 3 mujor, është konstatuar se sistemi ka pasur një problematik në gjenerimin e një raporti për të cilin vlera nuk dilte e saktë. Që nga ky moment sistemi A.. P.. nuk gjeneron raportime me të dhëna të sakta (të cilat i realizojmë në Excel) ....jemi në kushtet kur çështja e gjenerimit të raporteve mbetet e pazgjidhur dhe raportet po gjenerohen me Excel ndërkohë që sistemi vijon të mos gjeneroj raporte të sakta sipas kërkesës së bankës Botërore.*ò

3. Programi për menaxhimin financiar të projektit A.. P.. i prokuruar në shumën **576,000 lekë (me TVSh)** nuk kryen funksionet për të cilat është prokuruar, duke e bërë këtë shpenzim jo efektiv dhe njëkohësisht ka rritur artificialisht kostot e projektit, duke bërë që të gjitha transaksionet financiare dhe raportet e ndryshme të realizohen me programin Excel.

4. Megjithëse programi nuk ka funksionuar, fakt i konfirmuar nga mungesa e gjenerimit të raporteve dhe problematikave të tjera të evidentuara nga specialistja e financës së projektit HSIP, grupi i auditimit u ballafaqua edhe me një fakt kontradiktor në lidhje me këtë çështje, pasi në progres raportin e parë për vitin 2021, për periudhën janar ï mars 2021 përcjell MSHMS, MEF dhe L. K.-TTL, Banka Botërore nëpërmjet shkresës nr. 30 prot., datë 11.05.2021. Në këtë raport nuk evidentohet problematikat e shfaqura të programit A.. P.., por përkundrazi në fund të përshkrimit për procedurën e blerjes se programit A.. P.., raportohet se kontrata është duke u implementuar. Pra çka nënkupton që sipas PCU deri në muajin mars 2021, periudhë që përfshin raportimin për IRBD, programi A.. P.. ka funksionuar, ndërkohë që specialistja e financës së PCU, deklaron që programi nuk ka funksionuar prej muajit shkurt 2020.

5. Në pikën 10 të kontratës HSIP/G/SH/02-2015 me nr. 578/4 Prot., datë 23.02.2016, është parashikuar garanci dhe mirëmbajtjeje për 12 muaj, periudhë e cila do të fillonte nga data e pranimit dhe marrjes në dorëzim të Softit nga HSIP. Programi informatik A.. P.. është marrë në dorëzim më datë 07.06.2016 (shkresa nr. 28 prot., datë 07.06.2016) nga anëtarët e Zyrës së Koordinimit të Projektit HSIP (B. D., D. Gj. dhe E. D.) të cilët kanë konfirmuar që programi A.. P.. funksionon sipas kërkesave të kontratës dhe sistemi A.. P.. gjeneron raportet e kërkuara konform kërkesave të POM-it. *Gjithashtu vërehet se në komisionin e marrjes në dorëzim të këtij produkti informatik, nuk ka pasur në përbërje anëtarë specialist të IT.* Në kontratë është parashikuar afati kohor prej 12 muajsh për garancinë dhe mirëmbajtjen. Kjo periudhë ka përfunduar më datë 07.06.2017

6. Me urdhrin e shpenzimit nr. 49 datë 21.07.2016, zyra e financës së PCU-së. në zbatim të pikës 9 të kontratës, ka kryer pagesën për I... në shumën 460,800 lekë, ose 80% të vlerës së kontratës,

7. Shuma e mbetur prej 20 % duhej të paguhej në përfundim të periudhës së mirëmbajtjes dhe garancisë, pra pas datës 07.06.2016. Nga auditimi i dokumentacionit të bankës pranë PCU rezulton se, shuma e mbetur prej 115,200 lekë e cila përfaqëson 20 % të vlerës totale të kontratës nuk është ekzekutuar në llogarinë bankare të I...

Konkluzion:

	Për sa më lart, aktiviteti ekonomiko financiar i projektit HSIP, mbahet dhe përpunohet me programin Excel dhe jo me programin financiar për menaxhim projektesh A.. P.., prandaj shuma 576,000 lekë konsiderohet si një shpenzim jo efektiv që ka rritur kostot e shpenzimeve të projektit. Mungesa e përdorimit të këtij programi financiar nga ana e Zyrës së Koordinimit të Projektit është në mospërputhje me përcaktimet: POM-Annex 22- Accounting Software Technical Specification TECHNICAL SPECIFICATION - Project Accounting Software Application, ku është përcaktuar që aktiviteti financiar i projektit dhe gjenerimi i raporteve financiare do të bëhet me Programe software-ike për menaxhimin e projekteve duke përcaktuar programin A.. P... ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi*:** **1**. B. D. në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe D. Gj. në cilësinë e nëpunësit zbatues **2.** Z.S. E. në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të kompanisë I... për dorëzimin e një malli, i cili jo për shkak të përfundimit të afatit të mirëmbajtjes, nuk realizon dhe nuk gjeneron raporte sipas kërkesave të prokuruara dhe të parashikuara në ToRs, duke ofertuar dhe furnizuar një program që nuk garanton vazhdimësinë e funksionalitetit.
Kriteri:	Kontrata HSIP/G/SH/02-2015 me nr. 578/4 prot., datë 23.02.2016, Aneks nr. 22 të POM seksioni III. ñPerformance parametersò.
Ndikimi:	Aktiviteti ekonomiko financiar i projektit ñpër përmirësimin e sistemit të shëndetësisëò nuk mbahet me programin A.. P.. , por me paketën Office, duke mos evidentuar qartë gjurmën e auditit dhe mos gjenerimin e raporteve financiare sipas kërkesave të BB.
Shkaku	Mungesa e gjenerimit të raporteve me të dhëna të sakta dhe gjurmës së auditit.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	MSHMS të analizojë problematikën në lidhje me programin financiar A.. P.. për projektin ñPër përmirësimin e sistemit shëndetësorò, pasi mosfunksionimi i tij, e ka bërë jo efektiv shpenzimin prej 576,000 lekë, duke rritur artificialisht kostot e shpenzimeve të këtij projekti.
1.2 Rekomandimi:	MSHMS të marrë masa, që programi financiar A.. P.. të vihet në funksion të plotë, sipas kërkesave të prokuruara dhe të ofertuara. Në rast se kompania I... nuk e vendos në funksion programin A.. P.., vlera prej 460,800 lekë do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 63/5 prot., datë 12.11.2021, nga ana e Subjektit znj. D. Gj., në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe njëkohësisht specialiste e financës së projektit HSIP, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit të audituar: Specialistja e financës së njësisë së koordinimit të projektit (PCU) ka paraqitur të njëjtat argumente që ka parashtruar edhe në observacionin e projekt raportit me shkresë nr. 63 prot., datë 16.08.2021, duke mos sjell asnjë fakt apo argument të ri në lidhje me gjetjet e grupit të

auditimit. Në faqen nr.9 paragrafi 5 i observacionit, specialistja e financës së projektit duke mos pranuar pretendimet e Kompanisë I..., ka rikonfirmuar që programi nuk funksionon, e citoj:
ñ... *pra është e qartë se për sa kohe që specialistja ka hedhur vetëm 1 herë të dhënat në sistem dhe sistemi me këto të dhëna gjeneron një raport të sakt dhe një të gabuar, është e qartë që nuk është problem i hedhjes së të dhënave por problem i vetë sistemit".*
Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:
Për sa më lart, komentet nuk do të merren në konsideratë, dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e grupit të KLSH, nëpërmjet MSHMS është informuar edhe kompania I..., e cila ka paraqitur observacion nëpërmjet shkresës nr. 579/34 datë 15.11.2021. Observacioni në lidhje me problematikat e konstatuara për programin A.. P.., në mënyrë të përmbledhur janë orientuar në këto drejtime.
Së pari mbi konstatimin e grupit të auditimit të KLSH, se CD-ja e dorëzuar e programit A.. P.. e quan lapsus shkrimin në emërtim apo skedar të këtij programi.
Së dyti në lidhje me saktësinë e të dhënave të gjeneruara të raporteve, sqaron se ato mund të lidhen me lapsuse në përdorimin e programit nga stafi. (Shënim: ky pretendim nuk është pranuar nga specialistja e financës së projektit, për sa më poshtë gjendet citimi për këtë çështje). *Së treti*, kompania I... ofron gatishmërinë për të rikthyer funksionalitetin e sistemit.
Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:
Grupi i KLSH e vlerëson seriozitetin dhe komunikimin me KLSH, për marrjen e angazhimeve për zgjidhjen e problematikave të shfaqura nga programi financiar i menaxhimit të projektit A.. P... Grupi i auditimit të KLSH sqaron se në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna, bashkëpunimi dhe realizimi i tyre nga I... duhet realizohet me MSHMS. Prandaj komentet tuaja nuk do të merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit

2.2.7. Procedura e ndjekur për marrjen me qera të ambientit për zyra të PCU-së
Në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 377 datë 08.09.2015 është përcaktuar që adresa e Zyrës së Koordinimit të Projektit HSIP të jetë Ministria e Shëndetësisë: Bulevardi ñBarjam Curiò nr. 1. Ndërkohë njësia e koordinimit te projektit (PCU) ushtron aktivitetin në një apartament të marrë me qira me adresë: Rruga ñShyqyri Bërxolliò Ap. 24 A, Tiranë. MSHMS me pretendimin e mungesës së ambienteve për njësinë e koordinimit të projektit HSIP, fillimisht e ka akomoduar në godinën e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (akomoduar përkohësisht) dhe më pas nëpërmjet Koordinatores së Përgjithshme të Projektit HSIP, znj. E. H. drejtuar Zyrës së Koordinimit të Projektit HSIP, me shkresën nr. 2553 prot., datë 29.05.2020 ñMbi nevojën e përdorimit nga zëri i kostove operative të projektit HSIPò, ka propozuar përdorimin e zërit të kostove operative të projektit të një shume, për kosto qiraje për zyra dhe kosto të tjera operative të lidhura me to (si shpenzime energji elektrike, uji, internet, transportim materialesh dhe dokumentacioni etj.) me qellim garantimin e vijimësisë së punës së PCU-së. Koordinatorja e Përgjithshme e Projektit HSIP, ka autorizuar njësinë e koordinimit të projektit që të ndjek procedurat e miratimit pranë Bankës Botërore, për përdorimin e këtij zëri për kostot operative

2.Titulli i gjetjes:	Marrja me qira e ambientit ñApartamentò për zyra të PCU.
Situata:	Më datë 04.06.2020 njësia e koordinimit të projektit HSIP, ka marrë ofertë për ambiente zyre me qira vetëm nga operatori ñE. R. E.ò, i cili ka ofruar

tre ambiente respektivisht:
a. ambientin apartament me sip. 110 m^2 me qira mujore 600 euro;
b. me sip 120 m^2 me qira 700 euro (i diskutueshëm)
dhe c. sip 160 m^2 me qira mujore 1500 euro.
Nga evidenca dokumentare e disponuar, rezulton se:
Ofertat nuk kanë të dhëna të tjera, por vetëm foto të një ambienti të brendshëm. Në zbatim të shkresës nr. 2553 prot. datë 29.05.2020, nga ana e menaxheres së projektit dhe në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe në zbatim të nenit 9 e 16 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, nuk është nxjerre urdhër i brendshëm që të përcaktonte gjithë procedurën e marrjes me qira të ambientit për zyra për njësinë e koordinimit të projektit, me qëllim përdorimin eficent, efektiv dhe ekonominicitet të burimeve financiare publike. Njësia e koordinimit të projektit HSIP për procedurën e marrjes së apartamentit me funksion zyrë nuk i është referuar bazës ligjore në fuqi për këtë rast, pikërisht VKM 469 datë 03.06.2015 ñPër përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimoreò, ku është përcaktuar në pikën 3/c: *Për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytetin e Tiranës, vlera minimale e qirasë mujore, për 1 m^2 sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet, si më poshtë vijon: Për 1m^2 sipërfaqe për zyrë dhe magazinë, vlera minimale e qirasë mujore është e barabartë me vlerën minimale të qirasë mujore për 1 m^2 sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës;*
Nga administrimi i dokumentacionit, rezulton se:
-Apartamenti i marrë me qira me nr. kadastral ZK8380 bënë pjesë në zonën 10/2 ku çmimi minimal për sipërfaqe të shfrytëzuar është 139,500 lekë/m^2.
Pra vlera minimale e qirasë mujore, për çdo metër katror, në këtë rast, është:
139,500 x 0.3 % = 418.5 lekë për metër katror.
Po ti referohemi të dhënave të kontratës së lidhur për ambientin ku ushtron aktivitetin njësia e koordinimit të projektit HSIP, vlera minimale e qirasë mujore, sipas përcaktimeve të VKM së mësipërme, është:
90.95 m^2 x 418.5 lekë për metër katror = 38,686 lekë.
Nëse marrim si vlerë mesatare të konvertimit 1 euro me 123 lekë. Çmimi për metër katror i ambientit të marrë me qira nga PCU rezulton të jetë 811 lekë [(600*123)/90.95].
-Njësia e koordinimit të projektit ka marrë dhe pranuar ofertën minimale me gati dyfishin e çmimit minimal të përcaktuar ne VKM 469 datë 03.06.2015 ñPër përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimoreò
-Njësia e koordinimit të projektit ushtron aktivitetin në Ap 21A me sipërfaqe 90.95 m^2 dhe ka lidhur kontratë qiraje mujore për shumen 600 euro. Njësia e Koordinimit të Projektit HSIP, ka marrë ofertë vetëm tek një operator ñE. R. E.ò, të cilat nuk pasqyrojnë ambientin dhe sipërfaqen ku ushtron aktivitetin njësia e koordinimit të projektit PCU.
Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se: Kontrata e

lidhur e qiramarrjes nuk i referohet çmimit, sipërfaqes, të ofertave të marra. Kontrata është lidhur në mungese të ofertës për ambientin ku realisht është akomoduar Njësia e Koordinimit te Projektit (PCU).

Pjesë përbërëse e kontratës:

Kontrata me nr. 3242 rep., datë 15.06.2020 ka bashkëlidhur:

a. Certifikatën nr. 1907470 vërtetim pronësie, b. kartelën e pasurisë së paluajtshme, c. hartën treguese të regjistrimit.

Në dokumentacionin shoqërues të kontratës mungon planimetria e apartamentit të marrë me qira.

Miratimi i marrjes së objektit me qira për ambient zyre.

-Në vijim të komunikimit me e-mail të datës 08.06.2020 të menaxheres së projektit HSIP me Bankën Botërore, përfaqësuesja e saj ka dhënë dakortësinë për përdorimin e një shume për kosto qiraje për zyra dhe kosto të tjera operative të lidhura me to. (shpenzime energji elektrike, uji, internet, transportim materialesh dhe dokumentacioni etj.).

-Me shkresën nr. 2553/1prot., datë 12.06.2020 koordinatorja e përgjithshme e projektit HSIP, mbi bazën e studimit të tregut nga PCU, të cilët kanë marrë 3 opsione zyrash (të ofruara vetëm nga agjencia R. E. E.), bazuar në çmimin më të ulët dhe distancës më të afërt me MSHMS, ka miratuar lëvizjen e stafit në apartamentin në zonën kadastrale ZK8380 me nr. Pasurie 6/472+6-2, volumi 43 faqe 182 me adresë rruga ñShyqyri Bërxolliò Ap. 24A, Tiranë.

Lidhja e kontratës

Nëpërmjet shkresës nr. 2553/2 prot., datë 12.06.2020, të Ministrit përgjegjës të shëndetësisë është autorizuar Sekretarja e Përgjithshme znj. G. P. të nënshkruajë kontratën e qirasë për zyra të Njësisë së Koordinimit të Projektit HSIP, me pagesë mujore 600 euro/muaj (duke përfshirë taksat).

Në nenin 3 të Kontratës nr. rep. 3242 datë 15.06.2020 është përcaktuar afati i vlefshmërisë prej 6.5 muaj, duke filluar nga data 15.06.2020 deri me 30.12.2020 dhe sipërfaqja e ñApartamentitò është 90.95 m^2.

Në nenin 4 është përcaktuar që vlefta e kontratës është 600 euro (përfshirë dhe tatimin në burim).

Pagesa ndaj qiradhënësit

-Me U.SH nr. 39 datë 29.06.2020 është bërë pagesa në shumën prej 3,315 euro për qiradhënësin si pagese për periudhën 6.5 muaj në zbatim të nenit 5 të kontratës.

-Me USH nr. 49 datë 13.07.2020 në shumën 72,739 lekë është bërë pagesa për tatimin në burim.

-Me USH nr. 41 datë 30.06.2020 është depozituar në llogarinë e qiradhënësit garancia bankare në shumën 1800 euro, në zbatim të nenit 4 të kontratës.

Për vitin 2021, është bërë rinovim i kontratës së qerase me të njëjtat kushte nëpërmjet kontratës nr. 8758 datë 31.12.2020 me afat deri më datë 31.12.2021. Në nenin 5 të saj është përcaktuar që pagesa mujore do të bëhet brenda datës 20 të çdo muaji.

Nga dokumentacioni i vendosur ne dispozicion konstatohet se:

	1.Për muajin janar 2021, pagesa është bërë me USH nr. 4 datë 29.01.2021 në shumën 510 euro dhe me USH nr. 8 datë 11.02.2021 është bërë pagesa në shumën 11,125 lekë për tatimin në burim. 2.Për muajin shkurt 2021 pagesa është bërë me USH nr. 9 datë 11.02.2021 në shumën 510 euro dhe me USH nr. 12 datë 18.03.2021 në shumën 11,130 lekë është derdhur tatimi në burim për buxhetin e shtetit. 3. Për muajt mars-dhjetor 2021 nëpunësja zbatuese e PCU, nëpërmjet USH nr. 16 datë 30.03.2021 ka bërë pagesën në shumën 5,100 euro. *Veprime të nëpunësit zbatues dhe atij autorizues në kundërshtim me nenin 5 të kontratës ku parashikohet se:* Pagesa e qirasë mujore do të behet brenda datës 20 të çdo muaji kalendarik. 4. Me USH nr. 20 datë 12.04.2021 në shumën 110,907 lekë është derdhur tatimi në burim për buxhetin e shtetit. Për sa më lart, referuar pagesave të sipërcituar, në total për të dyja kontratat e qirasë nga PCU është shpenzuar shuma 1,355,281 lekë. Referuar VKM 469 datë 03.06.2015 ñPër përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimoreò, çmimi minimal për m^2 është 418.5 lekë. Ndërkohë që PCU ka lidhur kontrate qiraje me 811 lekë/m^2. <u>Vlera 672,993 lekë</u> [(1,390,567-(1,390,567*0.51603)] e përllogaritur si diferencë e shumës totale të shpenzuar të realizuar nga njësia e koordinimit të projektit HSIP dhe shumës potenciale të shpenzimeve që duhet të bëhej nga Zyra e Koordinimit të Projektit HSIP për shpenzimet e qeras se ambientit në përputhje me parashikimet e VKM 469 datë 03.06.2015 ñPër përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimoreò <u>konsiderohet si shpenzim jo efektiv</u>, i cili ka rritur artificialisht kostot e shpenzimeve te projektit. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:* znj. B. D. në cilësinë e menaxheres së projektit HSIP dhe njëkohësisht të nëpunësit autorizues të njësisë së koordinimit të projektit HSIP, znj. D. Gj. në cilësinë e specialistes së financës së projektit HSIP dhe njëkohësisht të nëpunësit zbatues të Njësisë së Koordinimit të Projektit HSIP dhe znj. J. S. në cilësinë e specialistes së prokurimeve të projektit HSIP, gjithashtu dhe në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes së ofertave të qirasë për ambientin e punës së Zyrës së Koordinimit të Projektit HSIP.
Kriteri:	Kontrata me nr. 3242 rep., datë 15.06.2020, Kontrata nr. 8758 datë 31.12.2020, Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 377 datë 08.09.2015, shkresa nr. 2553 prot., datë 29.05.2020 *"Mbi nevojën e përdorimit nga zëri i kostove operative të projektit HSIP"*.
Ndikimi:	Përcaktimi i çmimit të qerasë mujore jo mbi bazën e studimit të tregut dhe në mungesë të marrjes së ofertave, duke lidhur kontratë qiraje me subjekt privat për pronën apartament të përshtatur për zyrë.
Shkaku	Mungesa e marrjes së ofertave për përcaktimin e çmimit të qerasë.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa që Zyra e

Koordinimit të Projektit HSIP, të akomodohet në ambientet e saj, në rast të pamundësisë së ambienteve, të nisë një procedurë të re ligjore për lidhjen e kontratës së qerasë për një ambient privat për zyra, duke patur parasysh optimizimin e shpenzimeve për këtë zë buxhetor të projektit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 63/5 prot., datë 12.11.2021, nga ana e Subjektit znj. B. D. në cilësinë e menaxheres së projektit HSIP dhe njëkohësisht të nëpunësit autorizues të njësisë së koordinimit të projektit HSIP, znj. D. Gj. në cilësinë e specialistes së financës së projektit HSIP dhe njëkohësisht të nëpunësit zbatues të njësisë së koordinimit të projektit HSIP dhe znj. J. S. në cilësinë e specialistes së prokurimeve të projektit HSIP si dhe në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes së ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit të audituar: Znj. B. D., znj. D. Gj. dhe znj. J. S. kanë paraqitur të njëjtat argumente që ka parashtruar edhe në observacionin e projekt raportit me shkresë nr. 63 prot., datë 16.08.2021, duke mos sjell asnjë fakt apo argument të ri në lidhje me gjetjet e grupit të auditimit. *Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:* Për sa më lart, komentet nuk do të merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

3.Titulli i gjetjes: Ushtrim i funksionit të Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit në kushtet e paligjshmërisë.

Situata: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se emërimi i Drejtores së Kabinetit znj. E. H., me Urdhër nr. 96, datë 11.03.2016 të Ministrit të MSHMS në pozicionin e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit është kryer në kundërshtim me kërkesat e parashtruara nga Manuali Operacional i Projektit të vitit 2015 si dhe atyre të Manualit Operacional të ndryshuar në vitin 2019, sipas të cilit është shprehur se në këtë pozicion duhet të emërohet Zv. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Njëkohësish duhet theksuar fakti se ky emërim është kryer në kundërshtim edhe me Rregulloren e Brendshme të MSHMS, pasi funksionaret e Kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.

Kriteri: Manuali Operacional i Projektit, varianti i parë i vitit 2015 si dhe ai i ndryshuar në vitin 2019, pika 2.1 Angazhimet Insititucionale dhe Zbatuese, paragrafi i parë *ku përcaktohet se*:

*'**Zëvendësministri i Shëndetësisë do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e përgjithshëm të projektit** brenda MHSP dhe në të gjithë kyçin institucionet, siç ka qenë rasti në shumicën e projekteve të tjera'.*

Rregullorja e Brendshme *"Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale"*, neni 3, pika 2, germa c *ku përcaktohet se*:

"Kabineti i Ministrit është strukturë organizative politike që funksionon pranë Ministrit dhe vepron në grup për të përmbushur të gjitha prioritetet politike të t. Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejt Ministrin në

	ndjekjen e politikave në fushën e shëndetit dhe mbrojtjes sociale, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Funksionaret e Kabinetit ***nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror****".*
Ndikimi:	Prezenca e një Koordinatori të Përgjithshëm të Projektit të emëruar në kundërshtim me kriteret e sipërcituara përbën shkak për krijimin e kushteve të paligjshmërisë së akteve administrative.
Shkaku	Interpretim i gabuar i Manualit Operacional të Projektit.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për zëvendësimin e Koordinatorit të Përgjithshëm aktual të Projektit dhe emërimin në këtë pozicion të funksionarëve sipas kërkesave të parashtruara nga Manuali Operacional i Projektit.

2.3 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projekteve në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.

Me ligjin nr. 57/2015, është ratifikuar marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim për Projektin *"Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë"*.

Komponentët e projektit sipas kontratës së nënshkruar me ligjin nr. 57/2015, janë:

- Komponenti 1: Përmirësimi i shërbimeve spitalore
- Komponenti 2: Zgjerimi i sistemit të menaxhimit të informacionit shëndetësor/e- Health
- Komponenti 3: Përmirësimi i sistemit të financimit të shëndetësisë
- Komponenti 4: Monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i Projektit.

Projekti *"Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë"* ka pësuar 2 ndryshime përgjatë jetës së tij:

1. Ndryshimi i parë i projektit

Më datë 01.10.2018, nga ana e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është bërë me dije Ministri i Financës dhe Ekonomisë për ristrukturimin e Projektit ñPërmirësimi i Sistemit Shëndetësorò, me arsyetimin se *"... pas një analize të kujdesshme mbi progresin e ecurisë së projektit, i cili prej nga data e fillimit të zbatimit ka pasur vonesa të konsiderueshme në zbatimin në kohë të aktiviteteve të dakordësuara dhe indikatorëve respektivë, si dhe me vlerë disbursimi në masën 11% të fondit total të akorduar për këtë projekt, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe grupi i ekspertëve të Bankës Botërore dakordësuan se objektivat fillestarë dhe plani i projektit kanë qenë ambiciozë dhe rrjedhimisht rishikimin e objektivave fillestarë të projektit ..."*.

Këto ndryshime janë si më poshtë:

- ✓ **Riformulim i objektivave të projektit (PDO)** në qëllim dhe përmbajtje. Objektivi fillestar i projektit ishte: a) të kontribuojë në përmirësimin e efiçencës së dhënies së shërbimit shëndetësor në spitalet e përzgjedhur; b) të përmirësojë menaxhimin e informacionit në sistemin shëndetësor dhe; c)të rrisë aksesin financiar për shërbimet shëndetësore. Riformulimi i objektivit të projektit që reflekton dhe ristrukturimin e projektit është: ***Të fillojë modernizimi i shërbimeve shëndetësore në spitalet publike***.
- ✓ **Rishikimi i indikatorëve**

Indikatorët sipas tabelës më poshtë janë hequr, rishikuar apo janë vendosur të rinj.

Tabela nr. 4: Rishikimi i indikatorëve të projektit ñPërmirësimi i sistemit shëndetësorò

Nr.	Indikatorët (PDO)	Hequr (D) Rishikuar (R) Aktivitet i ri (N)	Targeti				
			Viti 1 2016	Viti 2 2017	Viti 3 2018	Viti 4 2019	Viti 5 2020
1	Numri total i spitaleve që kanë filluar zbatimin e rekomandimeve të Master Planit për spitalet	R					3 spitale kanë hartuar Planet e Veprimit
2	Përqindja e pacientëve të shtruar në spitale të përzgjedhura ku pranimi dhe dalja nga spitali është kryer elektronikisht	D	0	0	15	35	50
3	Reduktimi i çmimit mesatar për (a) 10 barnat më shumë të lëshuar me recetë; dhe (b) 10 barnat spitalorë me kosto më të lartë	D	3	6	11	18	25
4	Përqindja e qytetarëve të varfër të përfshirë në sistemin e sigurimeve shëndetësore	D	52	55	58	60	65
5	Numri i spitaleve rajonale me Sistem Informacioni të krijuar dhe funksional	N	0	0	0	4 spitale me sistem informacioni	4 spitale me sistem informacioni të krijuar dhe funksional
6	Numri i spitaleve rajonale që përmbushin standardet minimale të akreditimit (kumulativ)	N				1	3
7	Spitale me Bord Drejtuesish	D	0	3	7	13	15
8	Numri i spitaleve që kanë ngritur mekanizimin e kënaqshmërisë së	R	0	0	0	0	4

	qytetarëve						
9	*Rishikimi dhe adoptimi i strategjisë dhe planeve për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore*	*R*	*0*				*Përditësimi i strategjisë ekzistuese dhe adoptimi i planeve nga MSHMS*
10	*Numri i protokolleve klinike dhe manualeve mjekësore të rishikuara dhe zbatimi i tyre për 5 sëmundje kronike kryesore*	*R*					*5 protokolle klinike dhe manuale mjekësore të zbatuara dhe monitoruara në të gjithë spitalet rajonale*
11	*Master plani i e-Health / aktivitetet HMIS*	*R*	*Jo*	*Jo*	*Jo*	*Jo*	*Po*
12	*Qendra Kombëtare e Informacionit Shëndetësor (QKISH) e krijuar dhe funksionale*	*D*	*Jo*	*Po Pjesërisht (Ngritja e qendrës)*	*Po Pjesërisht (Ngritja e qendrës Biomedikal & mirëmbajtjes)*	*Po (QKISH funksionale)*	*Po (QKISH në funksion të plotë)*
13	*Numri i regjistrave të konsoliduar dhe online*	*N*				*1*	*4*
14	*Numri i spitaleve rajonale me sistem informacioni të ngritur dhe funksional*	*Kaluar si tregues i PDO*	*0*	*2*	*4*	*6*	*7*
15	*Qendra shëndetësore që adoptojnë sistemin e pagesës bazuar në performancë*	*D*	*Krijimi i sistemit*	*Adoptimi i sistemit*	*20*	*100*	*200*

16	*Zbatimi i reformës së pagesës nga spitalet*	*D*	*0*	*7*	*15*	*7*	*15*
17	*Udhërrëfyesi për reformën e pagesave për spitalet e adoptuar nga FSDKSH*	*N*				*Hartimi i Udhëzuesit*	*Adoptimi i udhëzuesit nga MSHMS*
18	*Numri i paketave (10 në total) sipas platformës së re*	*N*					*8*
19	*Përqindja e qytetarëve që përfitojnë nga përdorimi i Sistemit të ri të Informacionit*	*D*	*Hartimi i studimit*	*HIS i ngritur*	*Kërkesat e përpunuara*	*35*	*50*
20	*Organizimi i Kontributeve Shëndetësore "Udhëzuesi" i hartuar dhe zbatuar*	*D*	*Jo*	*Hartuar*	*Zbatuar*	*Po*	*Po*
21	*Raporti i barnave gjenerik me kosto më të ylët në treg për 10 barna me patentë*	*D*	*38*	*50*	*60*	*70*	*80*
22	*Trajnimi i personelit shëndetësor dhe stafit të FSDKSH (disagreguar në bazë gjinore)*	*R*				*50 gra; 40 burra*	*55 gra 45 burra*
23	*Numri i spitaleve të rehabilituara dhe/ose pajisur me pajisje mjekësore*	*N*			*11 spitalet rajonale me pajisje mjekësore*	*11 spitalet rajonale me pajisje mjekësore dhe 1 spital rajonal i rehabilituar*	*11 spitalet rajonale me pajisje mjekësore dhe 1 spital rajonal i rehabilituar dhe Pediatria e QSUT e rehabilituar*

Burimi: POM i rishikuar (2019) dhe Raporti i fundit tremujor progresiv për vitin 2020

Objektivat e mësipërm, të shënuar me (D) janë hequr me arsyetimin se projekti është thjeshtuar. Me këtë ndryshim të projektit janë hequr 10 prej tyre. Nga këto përmendim:

- Reduktimi i çmimit mesatar për (a) 10 barnat më shumë të lëshuar me recetë; (b) 10 barnat spitalorë me kosto më të lartë;
- Përqindja e qytetarëve të varfër të përfshirë në sistemin e sigurimeve shëndetësore.

Në letrën për ristrukturimin e projektit Banka Botërore shprehet se *"që nga viti 2017 progresi i bërë në drejtim të objektivave zhvillimorë të projektit ka qenë jo i kënaqshëm dhe nuk ka patur progres në lidhje me realizimin e treguesve"*. Pasi janë hequr 10 objektiva, në vijim janë rishikuar 5 prej atyre ekzistuese të mbetura dhe janë vendosur 6 të rinj.

✓ **Ristrukturimi i komponentëve dhe fondeve respektive**

Tabela nr. 5: Ristrukturimi i komponentëve dhe fondeve respektive

Për Komponent	Sipas PAD & marrëveshjes së Huas (EUR)	Rishikimi i fondeve për komponent (EUR)
Komponenti 1: Nga ñPërmirësimi i shërbimit spitalorò riformulohet ñPërmirësimi i menaxhimit dhe infrastrukturës në Spitalet Publikeò.	15 100 000	18 061 000
Komponenti 2: Nga ñShtrirja e sistemit të menaxhimit të Informacionit Shëndetësorò riformulohet ñPërmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor për Shërbimet Spitaloreò.	13 600 000	13 039 000
Komponenti 3: ñPërmirësimi i Sistemit Financiar në Shëndetësiò hiqet.	2 400 000	0
Komponenti 4: ñMonitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i projektitò ï renditje e re	919 750	919 750
Tarifa	80 250	80 250
Total	**32 100 000**	**32 100 000**

Burimi: POM i rishikuar (2019)

Nga ky ndryshim, projekti nga katër komponentë që kishte në fillim, në vijim ka tre komponentë, duke qenë se është hequr komponenti 3 *"Përmirësimi i Sistemit Financiar në Shëndetësi"*. Fondi që ishte për këtë komponent i ka kaluar komponentit të parë ñPërmirësimi i menaxhimit dhe infrastrukturës në Spitalet Publikeò, i cili është riformuluar. (Tabela e mësipërme).

Ky ndryshim i projektit është miratuar me VKM nr. 339, datë 22.05.2019, ñPër miratimin, në parim, të letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin ñPër përmirësimin e sistemit të shëndetësisëò, të ratifikuar me ligjin nr. 57/215.

2. Ndryshimi i dytë i projektit:

Banka ka miratuar më datë 05.10.2020 kërkesën e Ministres së Financave dhe Ekonomisë për:

a) shtyrjen e datës së mbylljes së projektit deri më 31.12.2022;

b) ndryshimin e përqindjes së disbursimit;

c) rialokimin e të ardhurave të huas pa ndryshuar koston e tij në total:

Ndryshimi i dytë i projektit është miratuar me VKM nr. Nr. 829, datë 21.10.2020, *"Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas ndërmjet republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin "Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë"*, ratifikuar me ligjin nr. 57/2015.

Me ndryshimin dhe zgjatjen e projektit me 2 vjet ka ndryshuar afati i realizimit të objektivave si më poshtë:

Tabela nr. 6:

Indikatorët	Viti 6 2021	Viti 7 2022	Komente
Numri total i spitaleve që kanë filluar zbatimin e rekomandimeve të Master Planit për spitalet	3 spitale kanë hartuar Planet e Veprimit	3 spitale kanë hartuar Planet e Veprimit	Është bërë finalizimi i kontratës dhe rishikimi i Master Planit.
Numri i spitaleve rajonale me Sistem Informacioni të krijuar dhe funksional	4 spitale me sistem informacio ni	4 spitale me sistem informacioni të krijuar dhe funksional	Në proces
Numri i spitaleve rajonale që përmbushin standardet minimale të akreditimit (kumulativ)	3	3	Realizuar. 4 spitale rajonale (Vlore, Durrës, Lezhe, Elbasan) kanë përmbushur standardet minimale të akreditimit në 2019.
Numri i spitaleve që kanë ngritur mekanizimin e kënaqshmërisë së qytetarëve	4	4	Të gjithë spitalet kanë ngritur mekanizimin e kënaqshmërisë së qytetarëve. Ata mbledhin mendimet (feedback ï un) e pacientëve, mbi 60% e të cilëve e përdorin këtë mekanizëm. Feedbek-u i pacientëve/qytetarëve ka ndihmuar MSHMS për decentralizimin e shërbimeve si p.sh. kryerjen e dializës perinatale në disa spitale rajonale, shërbim që më parë mundësohej vetëm nga QSUT.
Rishikimi dhe adoptimi i strategjisë dhe planeve për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore	Jo	Përditësimi i strategjisë ekzistuese dhe adoptimi i planeve nga MSHMS	Ky aktivitet akoma nuk ka filluar. Është parashikuar të fillojë në fund të muajit shtator 2021. Kujtojmë se në tabelën e mësipërme të indikatorëve ishte parashikuar që të kryhej brenda vitit 2020.
Numri i protokolleve klinike dhe manualeve mjekësore të rishikuara dhe zbatimi i tyre për 5 sëmundje kronike kryesore	5 prot. klinike dhe manuale mjek. të zbatuara dhe monitoruar a në të gjithë sp. rajon	5 protokolle klinike manuale mjekësore të zbatuara dhe monitoruara në të gjitha spitalet rajonale	Është vonuar. I njëjti target ishte parashikuar për të përfunduar në vitin 2020.
Master plani i e-Health / aktivitetet HMIS	Po	Po	Në proces. Megjithëse afati është shtyrë vazhdimisht që nga fillimi i projektit, rishikimi i Master Planit akoma nuk ka përfunduar. Aktualisht janë hartuar dokumente dhe raporte që i vijnë në ndihmë procesit të rishikimit të tij, siç janë: -Plani i investimeve për infrastrukturë dhe pajisje teknike me plane të përshtatshme biznesi për implementim; -Politikat për Mbështetjen dhe Nxitjen e Zbatimit të Master Planit të Spitalit; -Raporti periodik mbi rezultatet e arritura duke përfshirë propozim për racionalizimin e shërbimeve shëndetësore; -Kuadri konceptual, parimet dhe parametrat e matshëm; -Raporti Final ñPasqyrë e shkurtër e studimeve, raporteve dhe planeve përkatëse të mëparshme në sistemin Spitalor të

			Republikës së Shqipërisë dhe harta e kontekstit shëndetësor të Republikës së Shqipërisëò; -Politikat për mbështetjen dhe nxitjen e zbatimit të Master Planit të spitalit; Përshkrimi i metodologjisë dhe Analiza e përgjithshme e situatës e statistikat; etj.
Numri i regjistrave të konsoliduar dhe online	4	4	Regjistrat kryesorë janë hartuar dhe përditësimi sipas Master Planit për projektin do të konsolidohet në fund të projektit.
Udhërrëfyesi për reformën e pagesave për spitalet e adoptuar nga FSDKSH	Hartimi i Udhërrëfyesit	Adoptimi i Udhërrëfyesit nga MSHMS	Puna në vijim. Kontrata për hartimin e Udhërrëfyesit u kompletua dhe është dorëzuar raporti final në MSHMS.
Numri i paketave (10 në total)sipas platformës së re	8	10	Janë vonuar për shkak të dështimit të bisedimeve. Aktiviteti do thjeshtohet dhe do rifillojë me terma të ndryshuar reference.
Trajnimi i personelit shëndetësor dhe stafit të FSDKSH (disagreguar në bazë gjinore)	Objektivi:55 femra; 45 meshkuj Total: 464; (308 femra; 155) meshkuj	Objektivi:55 femra; 45 meshkuj Total: 464; (308 femra; 155) meshkuj	Ky objektiv është tejkaluar
Numri i spitaleve të rehabilituara dhe/ose pajisur me pajisje mjekësore	2 regional hospitals& QSUT (Pediatria) rehabilituar / 11 spitale rajonale të pajisura	3 regional hospitals&QSUT (Pediatria) rehabilituar / 11 spitale rajonale të pajisura	Puna në vijim. Të 11 spitalet rajonale u pajisën sipas planifikimit. Pritet që puna për rinovimin e spitalit të Kukësit të fillojë në muajin Tetor. Puna për ristrukturimin e Spitalit Pediatrik në QSUT ka filluar dhe është në vijim.

Marrim në analizë disa prej objektivave që kanë qenë që nga fillimi i projektit:

- ✓ Rishikimi dhe adoptimi i strategjisë dhe planeve për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Ky objektiv ka qenë që nga fillimi i projektit dhe është rishikuar me ndryshimin e parë. Objektivi kishte target që deri në vitin 2020 të bëhej përditësimi i strategjisë ekzistuese dhe adoptimi i planeve nga MSHMS. *Ndërkohë që nuk është arritur targeti, me zgjatjen e projektit për dy vjet pritet që aktiviteti në fjalë të fillojë në fund të muajit shtator 2021*.
- ✓ Numri i protokolleve klinike dhe manualeve mjekësore të rishikuara dhe zbatimi i tyre për 5 sëmundje kronike kryesore. *Objektivi është vonuar në realizimin e tij. I njëjti target, 5 protokolle klinike dhe manuale mjekësore të zbatuara dhe monitoruara në të gjithë spitalet rajonale, ishte parashikuar për në vitin 2020 është shtyrë për në vitin e fundit 2022*.
- ✓ Master plani i e-Health / aktivitetet HMIS. *Ky objektiv është akoma në proces, megjithëse afati është shtyrë vazhdimisht që nga fillimi i projektit, rishikimi i Master Planit akoma nuk ka përfunduar. Aktualisht janë hartuar dokumentet dhe raportet përbërëse të versionit të rishikuar të tij, por nuk ka një dokument përfundimtar, qoftë edhe draft dhe me shtyrjen e vazhduar në fund mund të mos mbetet kohë edhe për periudhën e nevojshme të implementimit të tij*.
- ✓ Numri i paketave (10 në total) sipas platformës së re. Sqarohet nga subjekti se këto paketa janë vonuar për shkak të dështimit të bisedimeve. Aktiviteti do thjeshtohet dhe

do rifillojë me terma të ndryshuar reference dhe të realizohet deri në përfundim të projektit. *Ndërkohë që ky objektiv nuk është realizuar që nga fillimi i projektit duket e vështirë që në vijim, në më pak kohë që ka mbetur nga mbyllja e projektit, të realizohet, duke ngritur shumë pikëpyetje*.

Nga analiza më sipër u konstatua se shtyrja në kohë e realizimit të këtyre objektivave përbën risk për zbatimin e projektit dhe shtyrjen e afatit të përfundimit të tij duke rritur në vijim dhe koston e realizimit të tij.

1. Titulli i gjetjes:	Rishikimi i Master Planit nuk ka përfunduar.
Situata:	Në MSHMS janë dorëzuar të gjitha materialet sipas kontratës por nuk ka dokument të plotë të realizuar, dhe me shtyrjen e vazhduar në fund mund të mos mbetet kohë edhe për periudhën e nevojshme të implementimit të tij.
Kriteri:	Manuali Operacional i Projektit HSIP fillestar (viti 2015) dhe Manuali Operacional i Projektit HSIP i rishikuar (viti 2019).
Ndikimi:	Risk për mosrealizimin e trajnimit të stafit dhe implementimin e Master Planit gjatë kohës së mbetur të jetës së projektit.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	MSHMS të botojë versionin final të Master Planit të përbërë nga materialet e hartuara si dhe të ngrejë ekipin që do të vërë në jetë implementimin e tij duke përfshirë dhe kryerjen e trajnimeve për stafet e spitaleve.
2. Titulli i gjetjes:	Objektivat e projektit HSIP janë ndryshuar vazhdimisht dhe nuk janë realizuar plotësisht.
Situata:	Projekti për përmirësimin e sistemit shëndetësor ka pasur që nga fillimi shumë vonesa në realizimin e objektivave duke ndryshuar vazhdimisht objektivat dhe afatet e duke vënë kësisoj në pikëpyetje realizimin e tyre.
Kriteri:	Manuali Operacional i Projektit HSIP fillestar (viti 2015) dhe Manuali Operacional i Projektit HSIP i rishikuar (viti 2019).
Ndikimi:	Risk për mos përmbushje/realizim të Projektit brenda afateve të parashikuara dhe rritjen e kostove të tij me pasojë përdorim pa efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Nga ana e Zyrës së Koordinimit të Projektit në bashkëpunim me Grupet Teknike për secilin komponent dhe me dakordësinë e Bankës Botërore, të bëhet një analizë e plotë në lidhje me arsyet dhe përgjegjësitë konkrete të mosrealizimit të objektivave që kanë mbetur të parealizuara që nga fillimi i projektit dhe të hartohet një plan me objektiva konkrete e të matshme, me afate reale dhe të arritshme si dhe me persona përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tyre.

2.4 Mbi prokurimin e fondeve të kredisë si dhe ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit.

Në zbatim të kësaj pike të Programit të Auditimit nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me Prokurimet rezultoi se në total janë realizuar / kontraktuar / likuiduar / audituar procedura prokurimesh për Shërbime Konsulence, Mallra dhe Punime Civile sipas tabelave të mëposhtme:

Tabela nr. 7

Informacion mbi Auditimin e Procedurave të Prokurimeve					
Numri i kontratave	Vlera e Kontratave	Procedura të audituara			
		Në numër	%	Në vlerë	%
Shërbime Konsulence					
30	3,761,574	2	7 %	1,774,056	47 %
Mallra					
12	8,849,278	9	75 %	8,818,086	99 %
Punime Civile					
3	12,817,203	3	100 %	12,817,203	100 %
Shërbime Konsulence+Mallra+Punime Civile					
45	**25,428,055**	**14**	**31 %**	**23,409,345**	**92 %**

Tabela nr. 8

Informacion mbi Auditimin e Zbatimit të Kontratave					
Numri i kontratave	Vlera e Kontratave	Kontrata të audituara			
		Në numër	%	Në vlerë	%
Shërbime Konsulence					
30	3,761,574	2	7 %	1,774,056	47 %
Mallra					
12	8,849,278	7	58 %	7,984,506	90 %
Punime Civile					
3	12,817,203	3	100 %	12,817,203	100 %
Shërbime Konsulence+Mallra+Punime Civile					
45	**25,428,055**	**14**	**31 %**	**23,409,345**	**92 %**

Pra në total u audituan:

- *92 % në vlerë e procedurave të prokurimit;*
- *90 % në vlerë e zbatimit të kontratave (Shërbime/Mallra/Punime);*

Informacioni mbi likuidimet e kryera për kontratat e lidhura sipas tabelës nr. 2.4.2 si më sipër është si më poshtë:

Tabela nr. 9

Informacion mbi Likuidimet e Kontratave të lidhura			
Numri i kontratave	Vlera e Kontratave	Vlera e Likuiduar	
		Në vlerë	%
Shërbime Konsulence			
30	3.761.574	1.316.924	35%
Mallra			
12	8.849.278	4.845.769	55%
Punime Civile			
3	12.817.203	5.610.198	44%
Shërbime Konsulence+Mallra+Punime Civile			
45	**25.428.055**	**11.772.891**	**46%**

Për çdo procedurë prokurimi të audituar rezultuan gjetjet si më poshtë:

1. Procedura me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'*

Tabela nr. 10

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "*Punime civile për rikonstruksionin e Spitalit Pediatrik QSUT*"		
1. Urdhër Prokurimi Urdhër Nr. 768 datë 02.11.2018 (i ndryshuar me urdhrin nr. 3589 prot., datë 08.07.2019) **2. Lloji i Procedurës –** Tender i hapur Ndërkombëtar	**3. Hartuesit e specifikimeve teknike/kritereve te kualifikimit:** Shkresa datë 12.10.2015; 22.12.2015 dhe Urdhër nr. 116 datë 24.03.2016 (nr. 1713 prot) Z. P. M. (Koordinator) Znj. D. K. (Anëtar) Znj. S. N. (Anëtar) Znj. L. P.(Anëtar) Znj. A. L. (Anëtar) Znj. T. C. (Anëtar)	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 768 datë 02.11.2018 (i ndryshuar me urdhrin nr. 3589 prot., datë 08.07.2019) J. D. F. B. O. A. Th. B. V. H.
5. Fondi i parashikuar nga Projektuesi (me TVSH) 7, 987,879 Euro 1,114,813,908 leke	**6. Oferta e kualifikuar e para me TVSH** JV U. I. T. S. T. L. S. (JV Leader) & .... SHPK (JV member) ik - T., Albania 1,098,019,044 Lekë	**7. Diferenca me fondin e parashikuar (me TVSh)** 16,794,864 Lekë me e ulet se projekti
8. **Data e hapjes së tenderit** 29 maj 2019 ora 10: 00(faza 2)	9. Burimi Financimit Huaja Nr. 8466-AL Banka Botërore. IBRD ñ Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor ò	**10. Operatorët Ekonomikë Pjesëmarrës** *Në fazën e parakualifikimit:* 1. JV U. I. T. S. T. L. S. and ñ....ò SHPK (T. , Albania) 2. C. M. Spa ï Italy 3. JV P. C.& A. K. SHPK Italy, Albania 4. S. E. 5. JV A. Ltd & A. C. Ltd & E.2. Ltd Albania, Albania, Albania *Në fazën e tenderit (te dy te kualifikuar) :* **1.** JV U. I. T. S. T. L. S. and ñ....ò SHPK (T. , Albania) me oferte : **1,098,019,044 Lekë me TVSH (oferta fituese)** **2.** JV P. C. (JV Leader) and A. K. SHPK (JV Member)- Italy Albania me oferte: **1,125,390,702 Lekë me TVSH**

1. Titulli i gjetjes: Vendosje e Kritereve jo në përputhje me nevojat e investimit.

Situata:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'*, rezultoi se nga ana e Grupit Teknik të Punës të ngritur për përcaktimin e specifikimeve teknike, janë vendosur si kritere për aplikantët dhe ofertuesit mbi ato të nevojshme për kryerjen e këtij investimi. Konkretisht nga auditimi rezultuan si më poshtë:

- Në lidhje me Kriteret e licencave:

'Aplikantët duhet të paraqesin me aplikimin e tyre, dokumentacionin shtesë si vijon:

Licencë profesionale të kërkuar për ofertuesin e suksesshëm, për tu paraqitur përpara lidhjes së kontratës, për ekzekutimin e punimeve janë:

NP 1– Kategoria D; NP 2– Kategoria G; NP 3 – Kategoria D; NP 11 – Kategoria D; NS 1– Kategoria B; NS 2 – Kategoria A; NS 3 – Kategoria B; NS 9 – Kategoria D; NS 12 – Kategoria E; NS 13 – Kategoria D; NS 14 – Kategoria D; NS 18 – Kategoria B; NS 19 – Kategoria A;'.

Në fakt referuar preventivit të hartuar nga ana e Projektuesit BOE R... s.r.l & A..., rezulton se këto kategori licencash nuk janë në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të

preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së aplikantëve ne këtë fazë. VKM nr. 42, datë 16.01.2008 *"Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi"*, i ndryshuar, Lidhja nr. 4 ka është përcaktuar se niveli i shoqërisë (niveli i licencës/kategorisë) në raport me vlerën në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi është si më poshtë:

Niveli i Shoqërisë	Sipas Vlerave në Lekë të Punimeve të Kryera për çdo Kategori Punimi
A	0 ï 20 milion lekë
B	21 ï 50 milion lekë
C	51 ï 100 milion lekë
D	101 ï 200 milion lekë
E	201 ï 400 milion lekë
F	401 ï 800 milion lekë
G	Mbi 800 milion lekë

Duke, analizuar rezulton se:

- ✓ NDËRTIME TË PËRGJITHSHME

I. Është kërkuar kategoria e licencës D për *Punime gërmimi*, e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë 101,000,000 ï 200,000,000 lekë.

Referuar VKM të përmendur më sipër citohet se: *"Punime Gërmimi: Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore"*.

Në fakt volume për gërmime dheu, sipas preventivit kemi në total vlerën prej 9,876,191.75 (Aneksi 4, Tabela 4.1). Nga sa më sipër rezulton se punimet e gërmimit, përfshirë edhe punimet e nevojshme për transportin, për të dyja godinat, si atë të parashikuar për tu rikonstruktuar edhe atë të parashikuar për tu ndërtuar si shtesë godine, janë në vlerën **9,876,191.75 lekë**, vlerë për të cilën kategoria A e licencën për NP 1 do të ishte më se e mjaftueshme. Vendosja e kategorisë D për punime gërmimi do të duhej të ishte vendosur për punime duke filluar nga shuma **101,000,000 lekë**, <u>e cila është më shumë se 10 herë më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter</u>.

II. Është kërkuar kategoria e licencës G për *Ndërtime civile dhe industriale*, e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë mbi 800,000,000 lekë.

Referuar VKM të përmendur më sipër citohet se: *"Ndërtime civile e industriale: **Konsiderohen ndërtime**, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse"*.

Në fakt volumet totale për punimet që lidhen me ndërtimin e ri janë në shumën **626,509,678.67 lekë**. Nga sa më sipër rezulton se punimet e nevojshme të ndërtuar shtesën e godinës, janë në vlerën **626,509,678.67 lekë**, vlerë për të cilën kategoria F e licencën për NP 2 do të ishte më se e mjaftueshme. Vendosja e kategorisë G për punime gërmimi do të duhej të ishte vendosur për punime duke filluar nga shuma **800,000,000 lekë**, e cila është më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter.

- ✓ NDËRTIME SPECIALE

I. Është kërkuar kategoria e licencës B për *Punime për prishjen e ndërtimeve,* e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë 21,000,000 ï 50,000,000 lekë.

Referuar VKM të përmendur më sipër citohet se: *"Punime për prishjen e ndërtimeve: Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve."*.

Në fakt volume për prishjen e ndërtimeve, sipas preventivit kemi në total vlerën prej **9,002,735** *(e detajuar kjo vlerë përshkruhet në Aneksin nr. 2.4.2)*. Nga sa më sipër rezulton se punimet për prishjet, përfshirë edhe punimet e nevojshme për transportin, për të dyja godinat, si atë të parashikuar për tu rikonstruktuar edhe atë të parashikuar për tu ndërtuar si shtesë godine, janë në vlerën **9,002,735 lekë**, vlerë për të cilën kategoria A e licencën për NS 1 do të ishte më se e mjaftueshme. Nga sa më sipër rezulton se nuk justifikohet e vendosja si kriter e kategorisë B për këtë pikë të licence.

- Në lidhje me xhiron minimale vjetore

"Xhiroja mesatare vjetore në ndërtim në shumën 2,038,000,000 lekë e llogaritur si total i pagesave të certifikuara të marra për kontrata në progres dhe/apo të kryera brenda 5 viteve të fundit, pjesëtuar për 5".

Në fakt, referuar *Manualit të Parakualifikimit për Prokurimin e Punimeve dhe Guidës së Përdoruesve*, Seksioni III Kërkesat dhe Kriteret e Kualifikimit, faqe 27, pas pikës 3.2 Xhiroja Mesatare vjetore në ndërtim, paragrafit shpjegues citohet se:

*"Shuma e cituar, normalisht nuk duhet të jetë më pak se dyfishi i xhiros vjetore të vlerësuar në kontratën e propozuar të Punëve (**bazuar në një parashikim linear të kostos së vlerësuar nga Punëdhënësi, duke përfshirë edhe shumat e paalokuara (fondin rezervë), gjatë kohëzgjatjes së kontratës**). Shumëzuesi prej 2 mund të zvogëlohet për kontrata shumë të mëdha (p.sh, më të mëdha se 200 mln dollarë ekuivalent) por nuk duhet të jetë më pak se 1.5.*

Periudha kohore është zakonisht pesë vjet ose më shumë, por mund të reduktohet në jo më pak se tre vjet (në marrëveshje me Bankën) në rrethana të veçanta të vendit, në mënyrë të tillë që të sigurohet mundësi për një industri ndërtimi të sapo krijuar me vetëm një përvojë të shkurtër kohore, etj.".

Në fakt, nga ana e Grupit Teknik është interpretuar jo në mënyrën e duhur citimi i mësipërm pasi vlera e kontratës është marrë e plotë dhe jo duke e vlerësuar atë në raport me kohëzgjatjen e kontratës. Pra, thënë ndryshe, nuk mund të kërkohet e njëjta Xhiro Mesatare Vjetore për një kontratë me

vlerë 1,114,813,908 lekë e cila ka një afat realizimi prej 26 muajsh dhe një kontratë po me vlerë 1,114,813,908 lekë e cila ka një afati zbatimit kontrate me (p.sh.) 5 vite. Kjo pasi, referuar citimit të mësipërm shuma e xhiros mesatare vjetore *nuk duhet të jetë më pak se dyfishi i xhiros vjetore të vlerësuar në kontratën e propozuar të Punëve*, por gjithnjë *...bazuar në një parashikim linear të kostos së vlerësuar nga Punëdhënësi, duke përfshirë edhe shumat e paalokuara (fondin rezervë), gjatë kohëzgjatjes së kontratës*. Për ta bërë më të qartë një situatë të tillë, në paragrafin III.2 *Nota Udhëzuese*, është marrë një shembull sipas të cilit xhiroja mesatare vjetore është përllogaritur si më poshtë:

Shembull:
Llogaritja e minimumit të kërkuar të "Mesatares së Xhiros Vjetore"
Përshkrimi: Objekt Portual
Kostoja e Llogaritur (përfshirë fondin rezervë): 120 milion USD
Afati: 4 vite
Kontrata: SBDË Unit Rate
(a) Mesatarja e pritshme vjetore e faturave në ndërtim, duke supozuar një projeksion linear:
120 milion USD ÷ 4 = 30 milion USD/vit
(b) Aplikimi i shumëzuesit normal me 2.0:
Minimumi i kërkuar i xhiros mesatare vjetore: $ 30 milion USD × 2.0 = 60 milion USD/vit

Kështu, nëse do të ndiqnim të njëjtin arsyetim edhe për rastin në fjalë ku vlera e parashikuar e kontratës është 1,114,813,908 lekë, do të kishim:

Përshkrimi: Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)
Kostoja e Llogaritur (përfshirë fondin rezervë): 1,114,813,908 lekë
Afati: 26 muaj (2.17 vite)
(a) Mesatarja e pritshme vjetore e faturave në ndërtim, duke supozuar një projeksion linear:
1,114,813,908 lekë ÷ 2.17 vite = 513,739,128 lekë/vit
(b) Aplikimi i shumëzuesit normal me 2.0:
Minimumi i kërkuar i xhiros mesatare vjetore: 513,739,128 lekë/vit × 2.0=1,027,478,256 lekë/vit

Duke bërë diferencën rezulton se kërkesa për xhiro mesatare vjetore është bërë **1,010,521,744 lekë më tepër** *(2,038,000,000 lekë – 1,027,478,256 lekë)* se ai i përcaktuar sipas rregullave të parashikuara nga Banka Botërore, ose sa dyfishi i asaj të kërkuar.

Kriteri:

Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.5.4 *Specifikimet Teknike ku përcaktohet se*: *'Specifikimet teknike duhet të përgatiten për të lejuar kompeticionin më të gjerë të mundshëm dhe në të njëjtën kohë të prezantojnë një deklaratë të qartë të standardeve të kërkuara për punëtori/specialistë, pajisje dhe performancë... Vetëm kur kjo të jetë kryer, objektivat e ekonomicitetit, efiçiencës dhe paanësisë në prokurime do të arrihen, reagushëmëria e ofertave do të sigurohet dhe detyra pasardhëse e vlerësimit do të lehtësohet. ... kujdes duhet treguar në hartimin e specifikimeve për të siguruar që ato nuk janë kufizuese. Standarde kombëtare dhe shqiptare duhet të përdoren sa më shumë të jetë e mundur. ... Është përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës të këtij komponenti që të sigurohet arritja e këtyre standardeve gjatë hartimit të specifikimeve teknike. Ndryshimet e specifikimeve teknike përfshirë këtu kriteret e vlerësimit dhe kostove të vlerësuara janë gjithashtu përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës'* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, *ku*

	<u>përcaktohet se:</u> 'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit'.
Ndikimi:	Vendosja e kritereve jo në përputhje me nevojat e investimit ndikon në konkurrencën e lirë dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e Grupit Teknik të Punës si dhe Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

<u>Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Grupit Teknik i Punës i përbërë nga z. P. M. (Koordinator Për Komponentin 1) dhe znj. L. P., znj. S. N., znj. D. K. dhe znj. A. L. (Anëtarë të Grupit teknik të punës) si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..</u>

2. Titulli i gjetjes: Kualifikim dhe Shpallje fitues e BOE me mangësi në dokumentacion.

Situata:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se në raportin e vlerësimit nga ana e Komisionit përkatës është cituar se: *'... çmimet janë plotësisht në përputhje me Manualin e Ndërtimit (sipas ligjit shqiptar) dhe në përputhje me BoQ të Projektit në lekë...'*. Gjithashtu, në faqen 13 të këtij materiali, paragrafi *Analizat e Çmimeve*, është cituar se *"Komisioni i Vlerësimit ka rishikuar me kujdes analizat e çmimeve nga të dy ofertuesit dhe arriti dhe gjithashtu bëri një krahasim me çmimet e përgatitura nga ana e shoqërisë e cila përgatiti hartimin e projektit'*.

Në fakt, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e BOE të shpallur fitues S. T. L. S. & ñ....ò ShPK nuk disponohen në dosje të gjitha analizat e çmimeve të preventivit pasi janë paraqitur të tilla vetëm një material me 108 faqe e cila përmban 496 analiza çmimesh <u>në të cilat nuk përfshihen</u>:

Godina Ekzistuese:

- Analizat e çmimeve për 40 zëra tek Kategoria Punime Elektrike, nën kategoria *Punime për pajisjet elektrike* me vlerë të ofertuar <u>8,855,250 lekë pa TVSH</u>;
- Analizat e çmimeve për 182 zëra tek Kategoria Punime Mekanike, me vlerë të ofertuar <u>52,178,824 lekë pa TVSH</u>;

Shtesa Anësore:

- Analizat e çmimeve për 65 zëra tek Kategoria Punime Elektrike, me vlerë të ofertuar <u>2,345,200 lekë pa TVSH</u>;
- Analizat e çmimeve për 56 zëra tek Kategoria Punime Elektrike, nën kategoria *Punime për pajisjet elektrike* me vlerë të ofertuar <u>41,767,250 lekë pa TVSH</u>;
- Analizat e çmimeve për 433 zëra tek Kategoria Punime Mekanike, me vlerë të ofertuar <u>97,842,850 lekë pa TVSH</u>;
- Analizat e çmimeve për 97 zëra tek Kategoria Punime Mekanike, nën kategoria *Punime për pajisjet mekanike* me vlerë të ofertuar <u>91,088,000 lekë pa TVSH</u>;

Pra në total rezulton se nga ana e BOE të shpallur fitues <u>nuk janë paraqitur</u> në total analizat e çmimeve për gati <u>1369 zëra pune</u>, ose gati <u>70 %</u> e totalit

	të tyre në numër dhe 294,077,374 lekë pa TVSH, ose mbi 33 % në vlerë.
Kriteri:	Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt *ku përcaktohet se*: *'Komisioni i vlerësimit është përgjegjës për vlerësimin dhe krahasimin e ofertave/propozimeve të marra dhe përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Ofertave/Raportin të Vlerësimit Teknik/Raportit Final të Vlerësimit i cili do ti dërgohet Bankës pasi procesi i vlerësimit të ketë përfunduar'*; si dhe Marrëveshja e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, *ku përcaktohet se: 'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit'*.
Ndikimi:	Kualifikimi dhe shpallja fitues i Operatorëve Ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret teknike/financiare të vendosura për pranim/kualifikim nuk siguron përdorim me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve dhe Ofertave si dhe e Koordinatorit të Përgjithshëm i Projektit.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura duke patur si qëllim kryesor mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve dhe Ofertave i përbërë nga znj. V. H. (QSUT), J. D. (MSHMS), O. A. (MSHMS), F. B. (MSHMS) dhe Th. B. (MSHMS) si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..

2. Procedura me objekt *'Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit'*

Tabela nr. 11

<table>
<tr><th colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Urdhër Nr. 487 datë 28.08.2021 (Nr. 2601/9 prot., datë 28.08.2020)

2. Lloji i Procedurës –
Tender i hapur Ndërkombëtar</td><td>3. Hartuesit e specifikimeve teknike/kritereve te kualifikimit:
Urdhëri për ngritjen e ekipit teknik të komponentit të parë të projektit HSIP: Urdhër Nr. 808 datë 20.11.2018 (Nr. 5955/1 prot datë 20.11.2018) i amenduar me urdhrin Nr. 782 datë 18.12.2019 (Nr.5836 prot datë 18.12.2019):
F. B.
M. C.
M. Ç.
J. D.
B. M.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër Nr. 487 datë 28.08.2021 (Nr. 2601/9 Prot datë 28.08.2020) ku përcaktohet përbërja si më poshtë:
J. D.
J. J.
V. H.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi i parashikuar nga Projektuesi (me TVSH)
410,228,226 LEKE
3,348,802 ú</td><td>6. Oferta e kualifikuar e para (me TVSH)
C. N. C. d. P. L. ñC. M.ò

349,210,674 LEKE</td><td>7. Diferenca me fondin e parshikuar (me TVSh)
Oferta fituese 61,017,552 lekë më e ulët se fondi i parashikuar</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
31 Gusht 2020 ora 12:00</td><td>9. Burimi Financimit
Huaja Nr. 8466-AL Banka Botërore. IBRD
ñ Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor ò</td><td>10. Operatorët Ekonomikë Pjesëmarrës
<table><tr><th>Emri</th><th>Vlera e Ofertës</th><th>Statusi</th></tr><tr><td>JV G. L. G. T. and C... &</td><td></td><td>Sõkualifikuar</td></tr></table></td></tr>
</table>

		Rr...SHPK	341,844,418 Lekë	Për mosplotësim kriteresh
		C. N. C. d. P. L. ñC. M.ò	349,210,674 Lekë	Kualifikuar (fituesi)
		.... SHPK	381,490,515 Lekë	Kualifikuar
		C... SHPK	381,885,787 Lekë	Kualifikuar
		JV A. K. & A...	412,145,185 Lekë	Kualifikuar

3. Titulli i gjetjes: Vendosje e Kritereve jo në përputhje me nevojat e investimit.

Situata:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit'*, rezultoi se në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës janë paraqitur për ofertuesit e mundshëm disa kërkesa si më poshtë:

- <u>Në lidhje me kategoritë e kërkuara të licencave</u>

'Licencë profesionale të kërkuar për ofertuesin e suksesshëm, për tu paraqitur përpara lidhjes së kontratës, për ekzekutimin e punimeve janë: NP 1 – Kategoria B; NP 2 – Kategoria F; NP 4 – Kategoria B; NP 11 – Kategoria B; NP 12 – Kategoria B; NS 1 – Kategoria A; NS 2 – Kategoria B; NS 3 – Kategoria B; NS 4 – Kategoria D; NS 8 – Kategoria D; NS 12 – Kategoria E; NS 13 – Kategoria C; NS 14 – Kategoria C; NS 18 – Kategoria B; NS 19 – Kategoria B;'. Në fakt referuar preventivit të hartuar nga ana e Projektuesit BOE R.. s.r.l & A..., rezulton se këto kategori licencash nuk janë në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes. Referuar VKM nr. 42, datë 16.01.2008 *"Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi"*, i ndryshuar, Lidhja nr. 4 rezulton se është përcaktuar se niveli i shoqërisë (niveli i licencës/kategorisë) në raport me vlerën në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi është si më poshtë:

<u>Tabela nr. 12</u>

Niveli i Shoqërisë	Sipas Vlerave në Lekë të Punimeve të Kryera për çdo Kategori Punimi
A	0 ï 20 milion lekë
B	21 ï 50 milion lekë
C	51 ï 100 milion lekë
D	101 ï 200 milion lekë

E	201 ï 400 milion lekë
F	401 ï 800 milion lekë
G	Mbi 800 milion lekë

Duke, analizuar rezulton se:

I. Është kërkuar kategoria e licencës B për NP 1 *Punime gërmimi*, e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë 21,000,000 ï 50,000,000 lekë.

Referuar VKM të përmendur më sipër citohet se: *"Punime Gërmimi: Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore"*. Në fakt volume për gërmime dheu, sipas preventivit kemi shumën total prej **1,999,436 lekë**, vlerë për të cilën kategoria A e licencën për NP 1 do të ishte e mjaftueshme. Vendosja e kategorisë B për punime gërmimi do të duhej të ishte vendosur për punime duke filluar nga shuma **21,000,000 lekë**, e cila është më shumë se 10 herë më e lartë nga ajo e nevojshme për tu vendosur si kriter.

II. Është kërkuar kategoria e licencës F për NP 2 *Punime për prishjen e ndërtimeve,* e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë mbi 410,000,000 lekë. Referuar VKM të përmendur më sipër citohet se: *"Ndërtime civile e industriale: Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse"*. Sipas Preventivit të hartuar nga ana e Projektuesit rezulton se vlera e totale e tij është në shumën 354,745,457.5 lekë pa TVSH (përfshirë këtu vlerën e fondit rezervë). Gjithashtu, rezulton edhe se vlera prej 16,962,938 lekë i përket kategorisë Sistemime të Jashtme, *Punime për Rruge, Trotuare dhe Gjelbërim*. Për rrjedhojë duke bërë krahasimet rezulton se kjo kategori licencë është përtej domosdoshmërive që dikton preventivi i punimeve pasi vlera për këtë kategori punimesh është në shumën 337,782,519.5 lekë pa TVSH. Vendosja e kategorisë E për punime gërmimi do të duhej të ishte e mjaftueshme pasi parashikon punime nga shuma 201,000,000 lekë ï 400,000,000 lekë.

III. Është kërkuar kategoria e licencës B për NP 4 kur në fakt vlera e punimeve kategorisë Sistemime të Jashtme, *Punime për Rruge, Trotuare dhe Gjelbërim* është në masën 16,962,938 lekë, vlerë kjo për të cilën kategoria A do të ishte e mjaftueshme.

IV. Është kërkuar kategoria e licencës D për NS 8 *Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri,* e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë 101,000,000 ï 200,000,000 lekë.

Referuar VKM të përmendur më sipër citohet se: *"Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej*

betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara". Sipas preventivit në total vlera e punimeve që lidhen me *Punime konstruksione metalike dhe beton arme*, është në shumën 90,773,852 lekë, vlerë kjo për të cilën kategoria C do të ishte e mjaftueshme.

V. Është kërkuar kategoria e licencës E për NS 12 *Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit*, e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë minimale prej 201,000,000 lekë, kategoria e licencës C për NS 13 *Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni*, e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë minimale prej 51,000,000 lekë si dhe kategoria e licencës C për NS 14 *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV*, e cila i korrespondon një volumi punimesh me vlerë minimale prej 51,000,000 lekë. Duke mbledhur rezulton se vlera total e punimeve për këto 3 kategori duhet të jetë të paktën në shumën 303,000,000 lekë, vlerë kjo e cila përbën 85 % (???), kur në fakt referuar preventivit shuma e punimeve për këto tre kategori punimesh është në masën 58,622,886 lekë, vlerë për të cilën kategoria A për çdo njërën prej NS ï ve do të ishte e mjaftueshme.

- Në lidhje me Eksperiencën e Mëparshme

Në paragrafin 4 Eksperienca, pika 4.2 (b), është kërkuar që Aplikantët duhet të paraqesin si kontratë të ngjashme *"1 kontratë me volume gërmimi prej 15,000 dhe punime betoni me një sasi prej minimumi 7,000 m^3"*.
Në fakt nga analiza e Preventivit të punimeve rezulton se në total punimet e gërmimit janë në sasinë prej 3,565 m^3, ose gati 4 herë më pak. Gjithashtu, për sa i përket punimeve të betonit rezulton se volumi total i punimeve të betonit është në sasinë prej 2340 m^3, ose 3 herë më pak.

Kriteri:

Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.5.4 Specifikimet Teknike *ku përcaktohet se*: *'Specifikimet teknike duhet të përgatiten për të lejuar kompeticionin më të gjerë të mundshëm dhe në të njëjtën kohë të prezantojnë një deklaratë të qartë të standardeve të kërkuara për punëtori/specialistë, pajisje dhe performancë... Vetëm kur kjo të jetë kryer, objektivat e ekonomicitetit, efiçiencës dhe paanësisë në prokurime do të arrihen, reagushëmëria e ofertave do të sigurohet dhe detyra pasardhëse e vlerësimit do të lehtësohet. ... kujdes duhet treguar në hartimin e specifikimeve për të siguruar që ato nuk janë kufizuese. Standarde kombëtare dhe shqiptare duhet të përdoren sa më shumë të jetë e mundur. ... Është përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës të këtij komponenti që të sigurohet arritja e këtyre standardeve gjatë hartimit të specifikimeve teknike. Ndryshimet e specifikimeve teknike përfshirë këtu kriteret e vlerësimit dhe kostove të vlerësuara janë gjithashtu përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës'* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, *ku përcaktohet se:* *'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e*

	Funksionimit të Projektit'.
Ndikimi:	Vendosja e kritereve jo në përputhje me nevojat e investimit ndikon në konkurrencën e lirë dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e Grupit Teknik të Punës si dhe e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Grupit Teknik i Punës i përbërë nga znj. F. B., znj. M. C., znj. M. Ç., znj. J. D. dhe z. B. M. si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..

4. Titulli i gjetjes:	Kualifikim dhe Shpallje fitues e BOE me mangësi në dokumentacion.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultuan mangësitë si më poshtë: Në lidhje me stafin kyç: A. Për Inxhinierin Elektrik të Terrenit janë kërkuar 10 vite eksperiencë punë në punime elektrike. Në fakt sipas dokumentacionit të dorëzuar **nuk konfirmohet funksioni** i z. E. M. në 3 eksperiencat e tij të punës në K... TV (korrik 2001 ï janar 2014), Në A... TV (korrik 2014 ï Tetor 2016) dhe E.. ï A.. (tetor 2016 ï aktualisht); B. Për Inxhinierin Supervizor të Terrenit janë kërkuar 10 vite eksperiencë punë në punime ndërtime civile. Në fakt sipas dokumentacionit të dorëzuar rezulton se z. M. K. është diplomuar në fushën e inxhinierisë në kategorinë master në vitin 2018, ose më pak se 8 vite përpara datës së dorëzimit të ofertave nga ana e aplikantëve. Gjithashtu, pas kërkesës së bërë për dokumentacion shtesë nga ana e Zyrës së Koordinimit të Projektit rezulton se ky punonjës **nuk përmbush as vitet në eksperiencë pune në punë ndërtimi** pasi për periudhën shkurt 2010 ï janar 2011 rezulton i punësuar si hartograf dhe jo si inxhinier për punime ndërtimi.
Kriteri:	Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pikën 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt *ku përcaktohet se*: *'Komisioni i vlerësimit është përgjegjës për vlerësimin dhe krahasimin e ofertave/propozimeve të marra dhe përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Ofertave/Raportin të Vlerësimit Teknik/Raportit Final të Vlerësimit i cili do ti dërgohet Bankës pasi procesi i vlerësimit të ketë përfunduar'* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, *ku përcaktohet se: 'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit'*.
Ndikimi:	Kualifikimi dhe shpallja fitues i Operatorëve Ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret teknike/financiare të vendosura për pranim/kualifikim nuk siguron përdorim me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve dhe

Ofertave si dhe e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit.

Rëndësia: E mesme.

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirëpërdorimin e fondeve të Projektit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve dhe Ofertave i përbërë nga znj. J. D. (MSHMS), znj. J. J. (MSHMS) dhe znj. V. H. (MSHMS) si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..

3. Procedura me objekt *'Pajisje mjekësore për Spitalet Rajonale'*, Loti 3 Radiologjia

Tabela nr. 13

<table>
<tr><th colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale" Loti 3 "Radiologjia"</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë përmes shkresës Nr. 154, datë 20.03.2017 dhe regjistruar në 20.03.2017, nr. prot., 1579
- P. M.
- P. K.
- D. K.
- L. P.
- S. N.
Urdhri është ndryshuar si më poshtë:
- P. M.
- P. K.
- M. P.
- V. Xh.
L. P.</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e specifikimeve teknike
Shkresat e datës 12.10.2015, 22.12.2015 dhe Urdhri nr. 116 datë 24.03.2016 administruar me nr. 1713 prot., datë 24.03.2016 me përbërje:
z. P. M.;
znj. D. K.;
znj. S. N.;
znj. A. L.;
znj. T. C.;</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 154, datë 20.03.2017 administruar me nr. 1579 prot., datë 20.03.2017 dhe nr. 218, datë 05.05.2017 me përbërje:
z. P. M.;
z. P. K.;
znj. M. P.;
znj. V. Xh.;
znj. L. P.;</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
Tender i Hapur Ndërkombëtar</td></tr>
<tr><td>5. Fondi i parashikuar nga ekipi (me TVSH)
Loti 3 "Radiologjia" (shiko akt ï konstatimin nr. X)
987,943 Euro</td><td>6. Oferta e kualifikuar e para (pa TVSh)
(OE/BOE Kontrata nr. datë vlera pa TVSH)
<table>
<tr><th>Referenca</th><th>Loti</th><th>Operatori Ekonomik</th><th>Data e nënshkrimit</th><th>Vlera me TVS</th></tr>
<tr><td>HSIP/G/ICB/01-2016-3</td><td>Lot 3</td><td>JV H. L. & S....</td><td>Nr.719 prot date 29.01.2018</td><td>1,272,384 euro</td></tr>
</table></td><td>7. Diferenca me fondin limit (me TVSh)
Loti 3: 284, 441Euro</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
10 Prill 2017 në orën 11:00
(Hapje publike)</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit
Huaja Nr. 8466-AL Banka Botërore. IBRD ñ Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor ò P163239.</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td><td>10. Operatorët Ekonomikë Fitues
Loti 3: JV H. L. & S....</td></tr>
</table>

5. Titulli i gjetjes: Vendosje e Kritereve jo në përputhje me nevojat e investimit.

Situata: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale, Loti 3 Radiologjia'*, rezultoi se në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës të dorëzuara Njësisë së Koordinimit të Projektit konstatohet se këto

specifikimet nuk i janë referuar në asnjë rast standardeve të kërkuara për pajisjet objekt prokurimi. Për të gjitha pajisjet dhe pjesët shoqëruese të tyre janë përdorur parametra duke cituar shprehje si:

Për Pajisjen X-Ray

Fuqia e gjeneratorit *jo më pak se* 50 kW; Voltazhi i X-ray nga 40 në 125 kV; Rangu i lëvizjes horizontale *rreth* 180 cm; Përmasat e tavolinës *afërsisht* 210 x 80 cm; Pesha maksimale ngritëse *min*. 180 kg; Syze X-Ray *afërsisht* 80 cm x 40 cm; Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 kHU; Etj.

Për Pajisjen X-Ray e lëvizshme:

Gjeneratori X-ray min. 32 kW; Gjeneratori X-ray me frekuencë 40 Hz;
Rangu u voltazhit të tubit 40 ï 125 kV me 1 KV shtesë; Rangu i mAs: 0.1 deri në 100 mAs; Fokusi i vogël min. 0.8 mm, fokusi i madh min. 1.3 mm;
Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 100 kHU; Rangu i rregullimit të distancës fokus ï film *afërsisht* 40 ï 200 cm; Rezolucioni *minimal* 3.0 lp/mm; Fusha e pikselit *max* 150 ̃m; Rrotullimi i Tubit rreth suportit +/- 180 ^{0}; Panel i sheshtë detektimi me fushë aktive të shikimit *min*. 35 x 43 cm; Etj.;

Për Pajisjen Radiografi dhe Fluoroskopi:

Fuqia e gjeneratorit *jo më pak se* 50 kW; Radiografia mA, *deri në të paktën* 550 mA; Fluoroskopi 50 kVp ï 125 Vp; Fuqia e llambës *jo më pak se* 50 kW; Fokus i dyfishtë: fokusi i vogël 0.8 mm ose më pak, fokusi i gjerë 1.3 *afërsisht*; Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 kHU; Tavolina më përmasa *afërsisht* 220 x 65 cm; Lartësia e tavolinës *afërsisht* 110 cm; Diametri i intensifikuesit të imazhit *jo më pak se* 23 cm; Fuqia e monitorit 50/60 Hz, 220/230 V; Paneli vertikal me një rang të dimensioneve të kasetës nga 18 x 24 cm në 35 x 43 cm; Lëvizja vertikale e kasetës *afërsisht* 40 ï 190 cm nga qendra; Etj.;

Për Pajisjen Mamografi:

Rangu i voltazhit 22 ï 35 KV; Anoda e rrotullueshme *e preferueshme* me një anode Tungstani për të reduktuar dozën me fokus *afërsisht* 0.1 ï 0.3 mm; Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 kHU; Rrotullimi i boshtit *afërsisht* 0 -+ 90 gradë; 0 ï 150 gradë i motorizuar; Rregullim i lartësisë i motorizuar deri në 75 cm me frena elektromagnetike; Dimensione të detektorit të aktivizimit *jo më pak se* 24 x 30 cm; Maksimumi i dimensionit të pikselit 100 ̃m; Etj.;

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se specifikimet teknike të vendosura nga ana e grupit teknik të punës nuk janë konform kërkesave të Manualit Operacional të Projektit pasi nuk përmbushin në mënyrën e duhur detyrimet e pikës 3.5.4 *Specifikime Teknike*. Me përjashtim të një rasti të vetëm ku është përmendura standardi EN 60601 ï 1 ï 1 ï 3, në asnjë rast tjetër, këto specifikime nuk i janë referuar standardeve dhe nuk janë japin një deklaratë të qartë pasi në të gjitha rastet janë vendosur kufij minimal, maksimal apo kërkesa për parametra brenda një diapazoni të caktuar. Nga ana e Grupit Teknik nuk janë marrë masa për përdorimin e Standardeve ndërkombëtare apo shqiptare në hartimin e specifikimeve teknike. Sipas paragrafit 3.5.4 është kërkuar që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të merren në konsideratë:

- Konfirmimi me standardet;
- Përcaktim i qartë i natyrës së kërkesës;

Kriteri:	Këto kritere, të cituara në mënyrë të tillë, përveç se nuk përmbushin kërkesat për të qenë të qarta dhe që ti referohen standardeve, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura për paracaktimin e operatorit ekonomik fitues. Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.5.4 *Specifikimet Teknike*, <u>*ku përcaktohet se*</u>: *'Specifikimet teknike duhet të përgatiten për të lejuar kompeticionin më të gjerë të mundshëm dhe në të njëjtën kohë të prezantojnë një deklaratë të qartë të standardeve të kërkuara për punëtori/specialistë, pajisje dhe performancë... Vetëm kur kjo të jetë kryer, objektivat e ekonomicitetit, efiçiencës dhe paanësisë në prokurime do të arrihen, reagushëmëria e ofertave do të sigurohet dhe detyra pasardhëse e vlerësimit do të lehtësohet. ... kujdes duhet treguar në hartimin e specifikimeve për të siguruar që ato nuk janë kufizuese. Standarde kombëtare dhe shqiptare duhet të përdoren sa më shumë të jetë e mundur. ... Është përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës të këtij komponenti që të sigurohet arritja e këtyre standardeve gjatë hartimit të specifikimeve teknike. Ndryshimet e specifikimeve teknike përfshirë këtu kriteret e vlerësimit dhe kostove të vlerësuara janë gjithashtu përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës'* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, <u>*ku përcaktohet se:*</u> *'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit'*.
Ndikimi:	Vendosja e kritereve jo në përputhje me nevojat e investimit ndikon në konkurrencën e lirë dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e Grupit Teknik të Punës si dhe e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit.
Rëndësia:	E lartë.
5.1 Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

<u>*Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Grupi Teknik i Komponentit të Parë i përbërë nga z. P. M. (Koordinator), znj. D. K. (Anëtare), znj. S. N. (Anëtare), znj. L. P. (Anëtare), znj. A. L. (Anëtare), znj. T. C. (Anëtare) si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..*</u>

6. Titulli i gjetjes:	Kualifikim dhe Shpallje fitues e BOE me mangësi në dokumentacion.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale., Loti 3 Radiologjia'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultuan mangësitë si më poshtë: <u>Nga auditimi konstatohet se:</u> 1. Subjektet S. M. ShPK H. L. ShPK nuk përmbushin kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii). Konkretisht rezulton se sipas pikës 3.1 Kërkesat e paskualifikimit citohet se: *"Dokumentet e mëposhtme duhet të përfshihen në ofertë:* *Evidencë e dokumentuar e kualifikimeve të ofertuesit për të realizuar*

kontratën nëse oferta e tij është pranuar që:

iii. Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues prodhon (krijon ose prodhon):

- *Ofertuesi është i themeluar në vendin e prodhimit të mallrave;*
- *Është i licencuar nga autoriteti rregullues në vendin e prodhimit për të furnizuar mallrave;*
- *Ka prodhuar dhe tregtuar produktet specifike pjesë e këtyre dokumenteve për të paktën 2 vjet dhe produkte të ngjashme për të paktën 5 vjet;*

iv. Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues nuk prodhon (krijon ose prodhon):

- *Ofertuesi është autorizuar në mënyrën e duhur nga një prodhues i mallrave i cili përmbush kriteret e pikës (i) së mësipërme për të furnizuar Mallrat në vendin e blerësit"*;

Ky bashkim operatorësh nuk rezulton të ketë dorëzuar dokumentet e nevojshme për plotësimin e pikave të paragrafit *ii*;

2. Subjektet S. M. ShPK dhe H. L. ShPK nuk disponojnë në certifikatën e konformitetit sipas Normës ISO 9001:2008, tek *Qëllimi*, Importim të pajisjeve teknologjike duke mos përmbushur kështu kriterin sipas të cilit është përcaktuar se:

"Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 për import, tregtim, instalim, mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore";

3. Subjektet S. M. ShPK dhe H. L. ShPK nuk kanë specifikuar datën e saktë të fillimit dhe përfundimit të kontratave kryesore të furnizimi siç përcaktohet në kriterin:

"Një listë të kontratave kryesore të furnizimit të kryera brenda pesë viteve të fundit, duke siguruar informacion të detajuar në lidhje me emrin e klientit, adresat e kontaktit, emrin e pajisjeve të pajisura, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës";

4. Subjekti H. L. ShPK nuk përmbush kriterin në lidhje me referencën pasi kontrata për të cilinë ky subjekt ka paraqitur referencën përkatëse ka si objekt *"Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për vitin 2016"*. Kjo kontratë, nuk është kontratë furnizimi në radhë të parë por është kontratë mirëmbajtjeje dhe së dyti nuk cilëson zërat (pajisjet e mirëmbajtura). Edhe referenca për kontratën me objekt *"Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësorë për vitin 2015"* është me të njëjtën problematikë si më sipër. Në kushte të tilla këto dokumente nuk duhet të ishin marrë në konsideratë;

5. Marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur me datë 15.03.2017 midis subjekteve H. L. ShPK dhe S. M. ShPK rezulton se ka parashikuar në Draft përshkrimin e kontratës edhe kontributin mes palëve i cili do të jetë në raportet 85 % subjekti S. M. ShPK dhe 15 % subjekti H. L. ShPK, në fakt referuar preventivit të kontratës dhe autorizimeve për të cilat këta subjekteve kanë marrë miratimin në lidhje me tregtimin e produkteve rezulton se ky raport është në masën 81 % S. M. ShPK dhe 19 % H. L. ShPK.

Kriteri:

Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt <u>*ku përcaktohet se*</u>: *'Komisioni i vlerësimit është përgjegjës për vlerësimin dhe krahasimin e ofertave/propozimeve të marra dhe përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Ofertave/Raportin të Vlerësimit Teknik/Raportit Final të Vlerësimit i cili do ti dërgohet Bankës pasi procesi i vlerësimit të ketë përfunduar'* si dhe me

Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, *ku përcaktohet se: 'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit'*.

Ndikimi: Kualifikimi dhe shpallja fitues i Operatorëve Ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret teknike/financiare të vendosura për pranim/kualifikim nuk siguron përdorim me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.

Shkaku Veprimet dhe mosveprimet e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve dhe Ofertave si dhe Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit.

Rëndësia: E lartë.

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit i përbërë nga z. P. M., z. P. K., znj. V. Xh., znj. L. P., znj. M. P. si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..

7. Titulli i gjetjes: Vendosje e kritereve diskriminuese me qëllim paracaktimin si fitues të Operatorëve Specifikë.

Situata: Për procedurën me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale., Loti 3 Radiologjia'*, në vijim të konkluzionit të arritur në lidhje me specifikimet teknike të cilat rezultuan se nuk janë zbatuar në përputhje me kërkesat e paragrafit 3.5.4 ku është kërkuar që këto specifikime ti referohen Standardeve dhe të jenë të tilla që të përfaqësojnë një deklaratë të qartë, grupi i auditimit krahasoi këto specifikime me ato të pajisjeve të JV S. M. ShPK & H. L. ShPK të shpallur fitues. Konkretisht rezultoi si më poshtë:

Tabela nr. 14

Nr.	Specifikimi teknik	Oferta
	Për Pajisjen X-Ray	
1	Fuqia e gjeneratorit jo më pak se 50kW	Fuqia 50 kW
2	Rrymat radiografike deri në 600mA	630 mA
3	Fokus i dyfishtë: fokusi i vogël 0.6 mm ose më pak, fokusi i madh 1.2 afërsisht	Fokusi 0.6 mm - 1.2 mm
4	Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 Khu;	300 Khu
5	Rrotullimi i Tubit X-Ray rreth krahut të teleskopit +/- 120 ^{0}	+/- 120 ^{0}
6	Dimensionet e tavolinës afërsisht 210 cm me 80 cm	220 cm me 81 cm
	Për Pajisjen X-Ray e lëvizshme	
1	Gjeneratori X-ray min. 32 kW	32 kW
2	Gjeneratori X-ray me frekuencë 40 Hz	40 - 125 kV
3	Rangu u voltazhit të tubit 40 ï 125 kV me 1 KV shtesë	40 - 125 kV 1 KV shtesë
	Rryma e tubit: rangu afërsisht 50 ï 300 mA	50-320 mA
4	Rangu i mAs: 0.1 deri në 100 mAs	Rangu i mAs: 0.1 deri në 110 mAs
5	Fokusi i vogël min. 0.8 mm, fokusi i madh min. 1.3 mm;	Fokusi i vogël min. 0.8 mm, fokusi i madh min. 1.3 mm;
6	Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 100 kHU	107 kHU
7	Rrotullimi i Tubit rreth suportit +/- 180 ^{0}	+/- 180 ^{0}
8	LCD monitor me prekje të paktën 19ôô	19ôô
9	Ëorkstation i instaluar me kapacitet HDD	500 GB

	min. 500 GB	
10	Panel i sheshtë detektimi me fushë aktive të shikimit min. 35 x 43 cm	35 x 43
	Rangu i rregullimit të distancës fokus ï film afërsisht 40 ï 200 cm	41.6 ï 205.6 cm
Për Pajisjen Radiografi dhe Fluoroskopi		
1	Fuqia e gjeneratorit jo më pak se 50 kW	50 kW
2	Radiografi mA, deri në të paktën 550mA	630 mA
3	Radiografia kV: 50 deri 130 kV	40 deri 150 kV
4	Fluoroskopia 50 kVp ï 125 kVp	40 deri 125 kVp
5	Fokus i dyfishtë: fokusi i vogël 0.8 mm ose më pak, fokusi i gjerë 1.3 afërsisht	Fokusi i vogël 0.6 mm ï fokusi i gjerë 1.2 mm
6	Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 kHU	400 kHU
7	Koha mesatare 30 sekonda	30 sekonda
8	Dimensionet afërsisht 220 x 65 cm	240 x 85 cm
9	Lartësia e shtratit afërsisht 110 cm	60 ï 130 cm
	Diametri i intensifikuesit të imazhit jo më pak se 23 cm	23 cm
Për Mamografinë		
1	Anoda e rrotullueshme ***e preferueshme*** me një anode Tungstani për të reduktuar dozën me fokus ***afërsisht*** 0.1 ï 0.3 mm	0.1 mm ï 0.3 mm
2	Kapaciteti ruajtës i ngrohjes së anodave 300 kHU	300 kHU
3	Rregullim i lartësisë i motorizuar deri në 75 cm me frena elektromagnetike	Lartësia nga 65 cm ï 140 cm e pajisur me frena elektromagnetike
4	Dimensione të detektorit të aktivizimit ***jo më pak se*** 24 x 30 cm	24 cm x 30 cm
5	Detektor me të paktën 60 % DQE të matur nën 10 mR dose	65 %
6	Maksimumi i dimensionit të pikselit 100 ζm;	85 ζm

Nga krahasimi si më sipër rezulton se këto parametra përveçse nuk janë të tilla që të kenë referencë standardet përkatëse apo të jenë një deklaratë e qartë e asaj çka kërkohet, por njëkohësisht ato janë të tilla që përputhen saktësisht me parametrat e ofruar nga ana e bashkimit të subjekteve të shpallur fitues duke mbështetur kështu konkluzionin e arritur në paragrafin e mësipërm sipas të cilit, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura me qëllim kualifikimin dhe shpalljen fitues të subjekteve S. M. ShPK & H. L. ShPK.

Kriteri:

Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.5.4 *Specifikimet Teknike* <u>*ku përcaktohet se*</u>: *'Specifikimet teknike duhet të përgatiten për të lejuar kompeticionin më të gjerë të mundshëm dhe në të njëjtën kohë të prezantojnë një deklaratë të qartë të standardeve të kërkuara për punëtori/specialistë, pajisje dhe performancë... Vetëm kur kjo të jetë kryer, objektivat e ekonomicitetit, efiçiencës dhe paanësisë në prokurime do të arrihen, reagushëmëria e ofertave do të sigurohet dhe detyra pasardhëse e vlerësimit do të lehtësohet. ... kujdes duhet treguar në hartimin e specifikimeve për të siguruar që ato nuk janë kufizuese. Standarde kombëtare dhe shqiptare duhet të përdoren sa më shumë të jetë e mundur. ... Është përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës të këtij komponenti që të sigurohet arritja e këtyre standardeve gjatë hartimit të specifikimeve teknike. Ndryshimet e specifikimeve teknike përfshirë këtu kriteret e vlerësimit dhe kostove të vlerësuara janë gjithashtu përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës'* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas

	ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, *ku përcaktohet se: 'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit'*.
Ndikimi:	Vendosja e kritereve diskriminuese dhe/ose jo në përputhje me nevojat e investimit ndikon në konkurrencën e lirë dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e Grupit Teknik të Punës si dhe e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit.
Rëndësia:	E lartë.
7.1 Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Grupi Teknik i Komponentit të Parë i përbërë nga z. P. M. (Koordinator), znj. D. K. (Anëtare), znj. S. N. (Anëtare), znj. L. P. (Anëtare), znj. A. L. (Anëtare) dhe znj. T. C. (Anëtare) si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..

4. Procedura me objekt *'Pajisje mjekësore për Spitalet Rajonale'*, Loti 1, 4 dhe 6

Tabela nr. 15

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale" Loti 1 *"Kujdesi Intensiv"*; Loti 4 *"Oftalmoskopi"*; Loti 6 *"Angiografi"*.		
1. Urdhër Prokurimi Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë përmes shkresës Nr. 154, datë 20.03.2017 dhe regjistruar në 20.03.2017, nr. prot., 1579 - P. M. - P. K. - D. K. - L. P. - S. N. Urdhri është ndryshuar si më poshtë: - P. M. - P. K. - M. P. - V. Xh. L. P.	**3. Hartuesit e specifikimeve teknike** Shkresat e datës 12.10.2015, 22.12.2015 dhe Urdhri nr. 116 datë 24.03.2016 administruar me nr. 1713 prot., datë 24.03.2016 me përbërje: z. P. M.; znj. D. K.; znj. S. N.; znj. A. L.; znj. T. C.;	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 154, datë 20.03.2017 administruar me nr. 1579 prot., datë 20.03.2017 dhe nr. 218, datë 05.05.2017 me përbërje: z. P. M.; z. P. K.; znj. M. P.; znj. V. Xh.; znj. L. P.;
2. Lloji i Procedurës – Tender i Hapur Ndërkombëtar		

<table>
<tr>
<td>5. Fondi i parashikuar nga ekipi (me TVSH)

Loti 1 “Kujdesi Intensiv”: 1,406,160 Euro

Loti 4 “Oftalmoskopi”237,429 Euro

Loti 6 “Angiografi : 442,800 Euro</td>
<td>6. Oferta e kualifikuar e para (pa TVSh)
(OE/BOE Kontrata nr. datë vlera pa TVSH)
<table>
<tr><th>Referenca</th><th>Loti</th><th>Operatori Ekonomik</th><th>Data e nënshkrimit</th><th>Vlera me TVSH</th></tr>
<tr><td>HSIP/G/ICB/ 01-2016-1</td><td>Lot 1</td><td>M... Shpk</td><td>Nr.77 3 Prot 30.01.2018</td><td>680,760 Euro</td></tr>
<tr><td>HSIP/G/ICB/ 01-2016-4</td><td>Lot 4</td><td>F... Shpk</td><td>Nr. 718 Prot 29.01.2018</td><td>152,820 Euro</td></tr>
<tr><td>HSIP/G/ICB/ 01-2016-6</td><td>Lot 6</td><td>SH...</td><td>Nr. 4284 prot date 09.07.2018</td><td>373,200 Euro</td></tr>
</table></td>
<td>7. Diferenca me fondin limit (me TVSh)

Loti 1:725,400 Euro
Loti 4: 84 609 Euro
Loti 6: 69,600 Euro</td>
</tr>
<tr>
<td>8. Data e hapjes së tenderit
10 Prill 2017 në orën 11:00
(Hapje publike)</td>
<td colspan="2">9. Burimi Financimit
Huaja Nr. 8466-AL Banka Botërore. IBRD ñ Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor ò P163239.</td>
<td>10. Operatorët Ekonomikë Fitues

Loti 1: M... Shpk
Loti 4: F... Shpk
Loti 6: SH...</td>
</tr>
</table>

8. Titulli i gjetjes: Vendosje e Kritereve jo në përputhje me nevojat e investimit.

Situata:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit me objekt *‘Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale,* Loti 1 *“Kujdesi Intensiv”*; Loti 4 *“Oftalmoskopi”*; Loti 6 *“Angiografi”*, rezultoi se specifikimet teknike të përcaktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës të dorëzuara Njësisë së Koordinimit të Projektit, nuk i janë referuar standardeve të kërkuara për pajisjet objekt prokurimi. Për të gjitha pajisjet dhe pjesët shoqëruese të tyre për Lotin 1, Lotin 4 dhe Lotin 6 rezulton se janë kërkuar parametra konkretë dhe/ose diapazone të tyre por në asnjë rast nuk janë cituar standarde referuese. Kjo situatë është konstatuar në të gjitha Lotet për pajisje si:

Loti 1

Defibrilator; Inkubator; Transportues inkubatori; Pompë infuzioni; Pompë shiringash; Elktro-kirurgji; Nebulizator; Monitor; Makineri anestezie; Ventilatorë; EEG;

Loti 4

Auto refraktometër; Set lentesh; Kornizë lentesh; Etj;

Loti 6

Krahu ï C; Imazhet digjitale dhe post ï procesimi; Etj;

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se specifikimet teknike të vendosura nga ana e grupit teknik të punës nuk janë konform kërkesave të Manualit Operacional të Projektit pasi nuk përmbushin në mënyrën e duhur detyrimet e pikës 3.5.4 *Specifikime Teknike*. Këto specifikime nuk i janë referuar standardeve dhe nuk janë japin një deklaratë të qartë pasi pothuajse në të gjitha rastet janë vendosur kufij minimal, maksimal apo kërkesa për parametra brenda një diapazoni të caktuar. Nga ana e Grupit Teknik nuk janë marrë masa për përdorimin e Standardeve ndërkombëtare apo shqiptare në hartimin e specifikimeve teknike. Sipas paragrafit 3.5.4 është kërkuar që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të merren në konsideratë:

- Konfirmimi me standardet;
- Përcaktim i qartë i natyrës së kërkesës;

Këto kritere, të cituara në mënyrë të tillë, përveç se nuk përmbushin kërkesat për të qenë të qarta dhe që ti referohen standardeve, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të

argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura.

Kriteri: Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 *Specifikimet Teknike* *ku përcaktohet se*: *'Specifikimet teknike duhet të përgatiten për të lejuar kompeticionin më të gjerë të mundshëm dhe në të njëjtën kohë të prezantojnë një deklaratë të qartë të standardeve të kërkuara për punëtori/specialistë, pajisje dhe performancë... Vetëm kur kjo të jetë kryer, objektivat e ekonomicitetit, efiçiencës dhe paanësisë në prokurime do të arrihen, reagushëmëria e ofertave do të sigurohet dhe detyra pasardhëse e vlerësimit do të lehtësohet. ... kujdes duhet treguar në hartimin e specifikimeve për të siguruar që ato nuk janë kufizuese. Standarde kombëtare dhe shqiptare duhet të përdoren sa më shumë të jetë e mundur. ... Është përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës të këtij komponenti që të sigurohet arritja e këtyre standardeve gjatë hartimit të specifikimeve teknike. Ndryshimet e specifikimeve teknike përfshirë këtu kriteret e vlerësimit dhe kostove të vlerësuara janë gjithashtu përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës'* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, *ku përcaktohet se: 'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit'*.

Ndikimi: Vendosja e kritereve jo në përputhje me nevojat e investimit ndikon në konkurrencën e lirë dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.

Shkaku Veprimet dhe mosveprimet e Grupit Teknik të Punës si dhe e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit.

Rëndësia: E lartë.

8.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Grupi Teknik i Komponentit të Parë i përbërë nga z. P. M. (Koordinator), znj. D. K. (Anëtare), znj. S. N. (Anëtare), znj. L. P. (Anëtare), znj. A. L. (Anëtare) dhe znj. T. C. (Anëtare) si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..

9. Titulli i gjetjes: Kualifikim dhe Shpallje fitues i BOE me mangësi në dokumentacion.

Situata: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale,* Loti 1 *"Kujdesi Intensiv"*; Loti 4 *"Oftalmoskopi"*; Loti 6 *"Angiografi"*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultuan mangësitë si më poshtë:

Loti 1

1. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se subjekti M... ShPK nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii).

Konkretisht rezulton se sipas pikës 3.1 Kërkesat e paskualifikimit citohet se:

"Dokumentet e mëposhtme duhet të përfshihen në ofertë:

Evidencë e dokumentuar e kualifikimeve të ofertuesit për të realizuar kontratën nëse oferta e tij është pranuar që:

i. Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues prodhon (krijon ose prodhon):

- *Ofertuesi është i themeluar në vendin e prodhimit të mallrave;*
- *Është i licencuar nga autoriteti rregullues në vendin e prodhimit për të furnizuar mallrave;*
- *Ka prodhuar dhe tregtuar produktet specifike pjesë e këtyre dokumenteve për të paktën 2 vjet dhe produkte të ngjashme për të paktën 5 vjet;*

ii. *Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues nuk prodhon (krijon ose prodhon):*

- *Ofertuesi është autorizuar në mënyrën e duhur nga një prodhues i mallrave i cili përmbush kriteret e pikës (i) së mësipërme për të furnizuar Mallrat në vendin e blerësit"*;

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë dorëzuar dokumentet e nevojshme për plotësimin e pikave të paragrafit i;

2. Subjekti M... ShPK nuk ka specifikuar datën e saktë të fillimit dhe përfundimit të kontratave kryesore të furnizimi siç përcaktohet në kriterin:

"Një listë të kontratave kryesore të furnizimit të kryera brenda pesë viteve të fundit, duke siguruar informacion të detajuar në lidhje me emrin e klientit, adresat e kontaktit, emrin e pajisjeve të pajisura, shumën e kontratës, ***datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës****"*;

Loti 4

1. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se subjekti F... ShPK nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii).

Konkretisht rezulton se sipas pikës 3.1 Kërkesat e paskualifikimit citohet se:

"Dokumentet e mëposhtme duhet të përfshihen në ofertë:

Evidencë e dokumentuar e kualifikimeve të ofertuesit për të realizuar kontratën nëse oferta e tij është pranuar që:

i. *Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues prodhon (krijon ose prodhon):*

- *Ofertuesi është i themeluar në vendin e prodhimit të mallrave;*
- *Është i licencuar nga autoriteti rregullues në vendin e prodhimit për të furnizuar mallrave;*
- *Ka prodhuar dhe tregtuar produktet specifike pjesë e këtyre dokumenteve për të paktën 2 vjet dhe produkte të ngjashme për të paktën 5 vjet;*

ii. *Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues nuk prodhon (krijon ose prodhon):*

- *Ofertuesi është autorizuar në mënyrën e duhur nga një prodhues i mallrave i cili përmbush kriteret e pikës (i) së mësipërme për të furnizuar Mallrat në vendin e blerësit"*;

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë dorëzuar dokumentet e nevojshme për plotësimin paragrafit i;

Loti 6

1. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se subjekti SH... d.... nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (i).

"Dokumentet e mëposhtme duhet të përfshihen në ofertë:

Evidencë e dokumentuar e kualifikimeve të ofertuesit për të realizuar kontratën nëse oferta e tij është pranuar që:

i. *Për rastin e një ofertuesi i cili ofron të furnizojë Mallra në zbatim të kontratës që ky Ofertues prodhon (krijon ose prodhon):*

- *Ofertuesi është i themeluar në vendin e prodhimit të mallrave;*
- *Është i licencuar nga autoriteti rregullues në vendin e prodhimit për të furnizuar mallrave;*
- *Ka prodhuar dhe tregtuar produktet specifike pjesë e këtyre dokumenteve për të paktën 2 vjet dhe produkte të ngjashme për të paktën 5 vjet;*

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë dorëzuar dokumentet e nevojshme për plotësimin e paragrafit i. Një dokument i paraqitur me titull *Artikull i regjistrimit* nuk është në gjuhën angleze por në gjuhën kroate, veprim ky në kundërshtim me pikën G.C.C 5.1 ku përcaktohet se: *"Gjuha duhet të jetë anglisht"*

2. Subjekti SH... d.... nuk disponon certifikatën e konformitetit sipas Normës ISO 9001:2008, e cila është kërkuar të jetë për ofertuesin pasi certifikata e paraqitur ka si të përshkuar tek *Qëllimi, Shitje dhe shërbim të sistemeve mjekësore dhe pajisje analitike dhe pajisje mjekësore; shitje e produkteve medicinale* duke mos përmbushur kështu kriterin sipas të cilit është përcaktuar se:

"Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 për ***import****, tregtim, instalim, mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore"*;

3. Subjekti SH... d.... nuk ka përcaktuar monedhën në të cilën janë shprehur çmimet e ofruar për pjesët në rast nevoje për periudhën 7 vjeçare pas periudhës së garancisë;

Kriteri:

Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt <u>*ku përcaktohet se*</u>: *'Komisioni i vlerësimit është përgjegjës për vlerësimin dhe krahasimin e ofertave/propozimeve të marra dhe përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Ofertave/Raportin të Vlerësimit Teknik/Raportit Final të Vlerësimit i cili do ti dërgohet Bankës pasi procesi i vlerësimit të ketë përfunduar'* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i, <u>*ku përcaktohet se:*</u> *'Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit'*.

Ndikimi:

Kualifikimi dhe shpallja fitues i Operatorëve Ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret teknike/financiare të vendosura për pranim/kualifikim nuk siguron përdorim me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.

Shkaku

Veprimet dhe mosveprimet e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve dhe Ofertave si dhe e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit.

Rëndësia:

E lartë.

9.1 Rekomandimi:

Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

<u>*Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit i përbërë nga z. P. M., z. P. K., znj. V. Xh., znj. L. P., znj. M. P. si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..*</u>

1. <u>Procedura me objekt : FV. Rezonanca Magnetike MRI për spitalin Rajonal Elbasan ñloti 5ò</u>

Tabela nr. 16

Lloji i procedurës së prokurimit	Tender i Hapur Ndërkombëtar
Lloji i rishikimit të BB për prokurimin	Rishikimk paraprak (Prior revieë)
Baza ligjore e procedurës së prokurimit	- ñUdhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe i shërbimeve jokonsulente në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive e granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botëroreò të muajit janar 2011 (i rishikuar në korrik 2014) Seksioni II ñTender i hapur ndërkombëtarò - Manuali Operacional i projektti HSIP seksioni ñTender i Hapur ndërkombëtarò

Tabela nr. 17

Pajisje mjekësore për spitalet rajonale lot 5 rezonanca magnetike MRI procedurë me rishikim paraprak nga banka botërore		
1.Urdhër për hartim specifikimesh, buxhet të parashikuar, kritere kualifikimi (ekipi teknik komponenti 1) : Shkresa datë 12.10.2015; 22.12.2015 dhe Urdhër Nr.116 datë 24.03.2016 (Nr.1713 prot) Z. P. M. (Koordinator) Znj.D. K. (Anëtar) Znj.S. N. (Anëtar) Znj. L. P.(Anëtar) Znj.A. L. (Anëtar) Znj. T. C. (Anëtar)	**3.Komisioni për përllogaritjen e fondit të parashikuar** Shkresa datë 12.10.2015; 22.12.2015 dhe Urdhër Nr.116 datë 24.03.2016 (Nr.1713 prot) Z. P. M. (Koordinator) Znj.D. K. (Anëtar) Znj.S. N. (Anëtar) Znj. L. P.(Anëtar) Znj.A. L. (Anëtar) Znj. T. C. (Anëtar)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Sipas Urdhrit te Prokurimi Nr. 154, datë 20.03.2017 - P. M. - P. K. - D. K. - L. P. - S. N. Me Amendamentin nr,1 UP nr, 218 date 05.05.2017 KVO është ndryshuar si më poshtë: - P. M. - P. K. - M. P. - V. Xh. - L. P.
2.Procedura prokurimit ICB (tender i hapur ndërkombëtar)		
5.Fondi i parashikuar (me tvsh) 674,104.67 EURO	**6.Oferta fituese (me tvsh)** 618,000 Euro CIP destinacioni final	**7. Diferenca me fondin e parashikuar (me tvsh)** 56,104.67 euro
8. Data e hapjes së tenderit: 10 Prill 2017 në orën 11:00 (Hapje publike)	**9.Burimi Financimit** Huaja Nr. 8466-AL Banka Botërore. IBRD ñ Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor ò P163239.	**10.Operatoret Ekonomike** Për Lot 5 ŏ P... M... S... N... B.V ŏ S... ŏ G.. H.. ŏ JV ñB.. E... & I... T..., T... & B... S... (T... G... SPAò)
b. Zbatimi i Kontratës		
11.Lidhja e kontratës Nr. 774 prot. 30 Janar 2018 ŏ Amendamenti Nr.1 datë 08.06.2018 ŏ Amendament Nr. 2 datë 30.08.2018 ŏ Amendament NR.3 (nr. 3737/3 prot datë 18.09.2018) ŏ Amendament Nr. 4 datë 19.11.2018	**12.Vlera e kontratës (me tvsh)** 618,000 Euro CIP **Shtesa në vlerë:** Nuk ka	**13.Likuiduar deri datë 31.05.2021** 80% në dërgim 20% në dorëzim, miratim dhe pranim final **14. Ekipi i menaxhimit te kontrates** Sipas Up nr.806 date 20.11.2018. 1.F. B. 2.O. A. 3.L. P. 4.V. Xh. 5.F. S.

Kjo procedurë ka pasur ndryshime të shpeshta të specifikimeve teknike. Ekipi teknik i komponentit të parë të projektit, ka përgatitur versionin fillestar të specifikimeve (përfshirë grafik shpërndarje, parashikim kosto ndarje në lote dhe specifikime teknike) i cili është dërguar në Bankën Botërore për miratim më 22 Dhjetor 2016.

10. Titulli i gjetjes:	Ndryshime të shpeshta të specifikimeve teknike.
Situata:	Më datë 11.01.2017, Banka Botërore ka dërguar komentet e saj mbi dokumentet e tenderit dhe specifikimet teknike të cilat janë reflektuar nga ekipi teknik më datë 13.01.2017. Më datë 24.01.2017, ekipi teknik i komponentit të parë ka konfirmuar se pranon komentet e Bankës Botërore, dhe po në të njëjtën datë ka ridërguar për miratim në BB specifikimit teknike shoqëruar me dokumentin e tenderit. Më datë 30.01.2017 Banka Botërore ka dërguar sërish komente mbi dokumentin e tenderit dhe pas reflektimit të ndryshimeve, BB më datë 31.01.2017 ka dhënë miratim final të dokumentit të tenderit dhe specifikimeve. Më datë 31.01.2017, grupi teknik i punës i ka përcjell Zyrës së Koordinimit të Projektit, versionin përfundimtar të specifikimeve dhe kërkesave teknike të hartuara prej tyre dhe të miratuar nga Banka Botërore në datë 31.01.2017, për prokurimin me objekt ñPajisje Mjekësore për spitalet rajonaleò. Ekipi teknik i komponentit të parë të projektit HSIP, përbehej nga: Z. P. M. (Koordinator), Znj. D. K. (Anëtar), Znj. S. N. (Anëtar), Znj. L. P..
	<u>Konkluzion:</u> Ekipi teknik krahas ndryshimit të parametrave teknik, duke vendosur parametra më të ulëta se specifikimet teknike fillestare të hartuara për MRI, duhej njëkohësisht të reflektonte edhe ndryshimin e fondit të parashikuar për blerjen e rezonancës magnetike MRI, sipas specifikimeve teknike të reja të reflektuara dhe të miratuara nga BB. Për sa më lart, ekipi teknik ka vepruar në kundërshtim me: Parashikimet e Manualit Operacional të Projektit HSIP, seksioni Technical Working Groups (TWG) *"Changes to ToR's and/or technical specifications including qualification criteria (including clarifications to these documents) and cost estimations are also responsibility of the TWG"*. Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. P. M., znj. D. K., znj. S. N., znj. L. P., znj. A. L., znj. T. C. në cilësinë e anëtareve të ekipit teknik.
Kriteri:	Manuali Operacional i Projektit HSIP.
Ndikimi:	Mos reflektim i zvogëlimit të fondit të parashikuar për këtë pajisje.
Shkaku	Ndryshimet e parametrave teknik për MRI.
Rëndësia:	E mesme.
10.1 Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rastet e ndryshimit të specifikimeve teknike, krahas tyre duhet të kërkoj nga komisioni përkatës reflektimin dhe ndryshimin edhe të fondit të parashikuar për atë procedurë prokurimi.

<u>*Publikimi i Ftesës për ofertë dhe ndryshimet në dokumentin e tenderit pas publikimit*</u>

Ftesa për ofertë është miratuar nga Banka Botërore sipas e-mail datë 31.01.2017 dhe është publikuar në portalin elektronik ndërkombëtar UNDB Online, në faqen web të MSHMS, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare Nr. 3 viti 2017, botuar më 13.02.2017

Në përputhje me dokumentin e tenderit Seksioni I ñUdhëzime për ofertuesinò Neni 7 ñQartësia e dokumentit të tenderitò paragrafi 7.1, të gjitha pyetjet, komentet dhe çështjet e ndryshme të ngritura nga ofertuesit janë shqyrtuar nga MSHMS dhe janë pasqyruar në amendamentet e dokumentit të tenderit, si më poshtë:

- ŏ Amendament Nr.1, datë 23 Shkurt 2017
- ŏ Amendament Nr.2, datë 2 Mars 2017
- ŏ Amendament Nr.3, datë 15 Mars 2017
- ŏ Amendament Nr.4, datë 15 Mars 2017
- ŏ Amendament Nr.5, datë 23 Mars 2017
- ŏ Amendamenti Nr.6, datë 23 Mars 2017

Hapja dhe vlerësimi i ofertave

Sipas amendamentit nr.5, afati për dorëzimin e ofertave është zgjatur nga data 20.03.2017 në datën 10.04.2017

Për lotin nr.5, kanë paraqitur interes 4 (katër) OE. Hapja e ofertave është zhvillua më datë 10.04.2017 në orën 11:00 në sallën e takimeve të MSHMS, në prani të ekipit të vlerësimit dhe përfaqësuesve të autorizuar të firmave. Anëtarët e ekipit të vlerësimit janë përcaktuar nga Ministri i Shëndetësisë përmes shkresës Nr. 154 prot., datë 20.03.2017.

Ofertat për Lotin 5 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.18

Operatori Ekonomik	**Çmimi i ofertuar**	
	Monedha	**Vlera**
P... M... S... N... B..	EUR	515,000.00
S...	EUR	539,000.00
G.. H..	EUR	556,000.00
JV ñB... E... & I... T..., T... & B... S... (T... G... SPAò)	EUR	798,170.00

Rezultatet e vlerësimit nga ekipi i vlerësimit janë si më poshtë:

Tabela nr.19

Ofertuesi	Çmimi i ofertuar		Çmimi i korrigjuar	Ulje çmimi		Çmimi i korrigjuar dhe me zbritje
P... M... S... N... B.V	EUR	515,000.00	515,000.00	0	0	515,000.00
S...	EUR	539,000.00	539,000.00	0	15,000	524,000.00
G.. H..	EUR	556,000.00	**Skualifikuar në fazën e vlerësimit paraprak**			
JV ñB... E... & I... T..., T... & B... S... (T... G... SPAò)	EUR	798,170.00	798,170.00	0	0	798,170.00

Ofertuesi *G.. H..* është skualifikuar, pasi oferta e paraqitur nga ky ofertues për Lotin 5 ka patur vlefshmëri për 315 ditësh nga data e përcaktuar për afatin e paraqitjes së ofertës, në vend të 462 ditëve të kërkuara sipas Amendamentit Nr. 5 të dokumentit të tenderit. Në përputhje me nenin 18: "Një ofertë e vlefshme për një periudhë më të shkurtër se ajo e kërkuar nga blerësi, refuzohet si jo e pranueshmeò.

Tri ofertat e mbetura, janë vlerësuar nga ekipi i vlerësimit si teknikisht korrekte dhe fitues është shpallur ofertuesi P... M... S... N... B.V me çmimin më të ulët në shumën 515,000 euro

Tabela nr.20

Ofertuesi i vlerësuar teknikisht me çmimin më të ulët:		P... M... S... N... B.V.	
2.	Vend i origjinës se mallrave	Kinë (MRI); Itali (UPS)	
3.	Data e parashikuar për nënshkrimin e kontratës	Shtator 2017	
4.	Koha e parashikuar e lëvrimit	8- 12 javë pas nënshkrimit të kontratës .	
5.	Oferta	EUR	**515,000**

Në përfundim e procedurës së kualifikimit të OE nga ekipi i vlerësimit është hartuar ñRaporti i vlerësimitò më datë 04.07.2017, i cili është miratuar nga Koordinatorja e Përgjithshme e Projektit më datë 16.10.2017. Më pas ekipi i vlerësimit ka hartuar shtojca nr. 1 të raportit të vlerësimit më datë 12 tetor 2017, i cili është miratuar nga koordinatorja e projektit më datë 26.10.2017. Banka Botërore më datë 30.10.2017 ka paraqitur komente mbi raportin e vlerësimit dhe ekipi vlerësimit i ka reflektuar komentet e BB në raportin e rishikuar të datës 10.11.2017, i cili ka marrë miratimin nga koordinatorja e projektit më datë 15.11.2017. Më pas, më datë 22.11.2017 Banka Botërore ka miratuar raportin e vlerësimit dhe ka kërkuar të vijohet me nënshkrimin e kontratës me kusht që: ekipi i vlerësimit të konfirmojë se informacioni dhe dokumentet e paraqitura nga P. M. S. N. B., të jenë të tij dhe jo të kompanisë mëmë. Nëpërmjet shkresës nr. 192 prot., datë 01.12.2017, ekipi i vlerësimit ka konfirmuar se dokumentacioni i paraqitur nga P. M. S. N. B. është i tij dhe jo i kompanisë mëmë.

2.Procedura me objekt ñFurnizimi dhe instalimi i softit te sistemit të menaxhimit financiar në 420 qendra të kujdesit parësorò

Tabela nr. 21

Lloji i procedurës së prokurimit	Tender i Hapur Kombëtar
Lloji i rishikimit të BB për prokurimin	Rishikim pas fakti (Post review)
Baza ligjore e procedurës së prokurimit	ñUdhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe i shërbimeve jokonsulente në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive e grandeve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botëroreò të muajit janar 2011 (i rishikuar në korrik 2014) Seksioni II ñTender i hapur ndërkombëtarò
	Manuali Operacional i projektit HSIP seksioni ñTender i Hapur kombëtarò

Tabela nr. 22

Furnizimi dhe instalimi i softit te sistemit të menaxhimit financiar në 420 qendra të kujdesit parësor		
1.Urdhër për hartim specifikimesh, buxhet të parashikuar, kritere kualifikimi (ekipi teknik komponenti 1) Përgatitja e Specifikimeve teknike për këtë procedurë, është realizuar nga një konsulenti individual i kontraktuar nga MSHMS (në kuadër të projektit HSIP) Z.A. M.	3.**Komisioni për përllogaritjen e fondit të parashikuar** Nga evidenca dokumentare e vendosur ne dispozicion te grupit te auditimit nuk konstatohet një komision për përllogaritjen e fondit limit.	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Ministri Nr. 70 datë 13 Shkurt 2021 Nr.795 prot datë 13.02.2017) Ekipi i vlerësimit ka përbërjen si më poshtë: M. P. E. H. E. L.
2.Procedura prokurimit NCB (tender i hapur kombëtar)		
5.Fondi i parashikuar (me tvsh) 400,000 EURO	**6.Oferta fituese (me tvsh)** 45,600,000 Lekë (340,680 Euro) CIP destinacioni final	**7. Diferenca me fondin e parashikuar (me tvsh)** 59,320 euro më e ulët se parashikimi
8. Data e hapjes së tenderit: 29 Mars, 2017	**9.Burimi Financimit** Huaja Nr. 8466-AL Banka Botërore. IBRD ñ Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor ò P163239.	**10.Operatoret Ekonomike** a. Bashkim operatoresh ñI... & B... E...ò b. Bashkim operatoresh - ñH... SHPK. dhe S... & S... SHPK.ò,
b. Zbatimi i Kontratës		

11.Lidhja e kontratës	**12.Vlera e kontratës** (me tvsh)	**13.Likuiduar** deri datë 31.05.2021
Kontrata nr. 2580/10 date 23 Tetor 2017	45,600,000 Leke (340,680 Euro) CIP destinacioni final	38,569,995 leke 84.6 %

Referuar ñProject Appraisal Documentò-PAD me Rep. nr. PAD1058 date 20.01.2015 komponenti 3 ndarja A3.1.3, është parashikuar fondi prej 400,000 euro për programin e menaxhimit financiar për 100 PHCs (Qendra Shëndetësore ne sistemin parësor të kujdesit shëndetësor). Por në procedurën e zhvilluar për furnizimin dhe vendosjen e sistemit të menaxhimit financiar është referuar për 420 QSH. Rritja dhe përfshirja e të gjitha qendrave në këtë sistem nuk është e pasqyruar në asnjë dokument që grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion nga ana e PCU.

Nga evidenca dokumentare e vendosur në dispozicion nga PCU grupit të auditimit nuk konstatohet relacioni dhe anëtarët e komisionit për llogaritjen fondin e parashikuar për këtë procedurë.

Përgatitja dhe miratimi i specifikimeve teknike dhe dokumentit të tenderit:

Përgatitja e Specifikimeve teknike për këtë procedurë, është realizuar nga një konsulent individual i kontraktuar nga MSHMS (në kuadër të projektit HSIP) Z. A. M.. Specifikimet teknike të hartuara nga konsulenti, kanë marrë miratimin nga Banka Botërore, më datë 25.04. 2017.

Publikimi i Ftesës për ofertë

Ftesa për ofertë është publikuar në Agjencinë e Prokurimit Publik (Buletini i Njoftimeve Publike Nr.7 datë 20.02.2017)

Për këtë procedurë kanë shprehur interes dhe kanë blere dokumentacion 4 (katër) kompani:

1.I... T... A... Sh.a., 2. I..., 3. G...- G. Th. C... - Itali, 4. T-S... H... LTD - Hungari

Hapja dhe vlerësimi i ofertave

Afati i dorëzimit të ofertave ka qenë data 29.03.2017 ora 11:00. Brenda këtij afati kanë paraqitur dy ofertat si më poshtë:

Tabela 23

Operatori Ekonomik		**Vlera e Ofertuar**	
Emri	Vendi	Monedha	Shuma
Bashkim operatoresh ñI... & B... E...ò	Shqipëri	ALL	38,000,000 leke
		USD	304,560 USD
Bashkim operatoresh ñ- ñH... SHPK. dhe S... & S... SHPK.ò,	Shqipëri	ALL	217,231,200 leke
		EURO	1,602,000 EURO

Hapja e ofertave publike u zhvillua më 29.03.2017 ora 11:00 në sallën e takimeve ï Ministria e Shëndetësisë, në prani të Ekipit të Vlerësimit (ngritur me Urdhrin e Ministrit nr. 795 prot., datë 13.02.2017) dhe përfaqësuesve autorizuar të firmave. Në mbështetje të seksionit 1 të dokumentit të tenderit ñUdhëzime për ofertuesiò neni 25 ñHapja e ofertaveò , minutat e takimit të hapjes publike u janë dërguar firmave pjesëmarrëse në hapje dhe Bankës Botërore me e-mail datë 29.03.2017 (ditën e hapjes së ofertave). Ekipi i vlerësimit kualifikoi të dy ofertuesit. Vlerësimi paraprak pasqyrohet në tabelën nr. 1 aneksi nr. 4.

Vlerësim i kritereve të post-kualifikimit.

Duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në dokumentin e tenderit, ekipi i vlerësimit ka verifikuar të gjitha dokumentet mbështetëse të paraqitura nga i vetmi ofertues i vlerësuar, në mënyrë që të vendosë nëse është i kualifikuar për të realizuar kontratën në mënyrë të suksesshme. Nga ky vlerësim, ekipi i vlerësimit ka konkluduar se bashkimi i operatoreve ò I... & B... E...ò është konsideruar i kualifikuar dhe i pranueshëm për lidhjen e kontratës.

Vlerësimi teknik
Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve -ò I... & B... E... SHPK.ò, nga pikëpamja teknike ka rezultuar e pranueshme nga komisioni i vlerësimit. Raporti i vlerësimit për këtë procedurë është hartuar, më datë 25.04.2017 dhe është miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 795/1 prot., datë 19.05.2017. Të dhëna mbi vlerësimin teknik për këtë procedure gjenden ne tabelën nr. 2 aneksi nr. 4.
3.Procedura me objekt: ñMbështetje e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë se re për menaxhimin e QSUTò
Të dhëna të përgjithshme të prokurimit:

Tabela nr. 24

Mbështetje e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar - zbatimi i strategjisë së re për menaxhimin e QSUT-së procedurë me rishikim paraprak nga Banka Botërore		
1.Urdhër për hartim specifikimesh, buxhet të parashikuar, kriteret kualifikimi : Termat e Referencës janë hartuar nga një konsulent individual i kontraktuar nga MSHMS Z. R. B. G.	**3.Komisioni për përllogaritjen e fondit të parashikuar** Termat e referencës janë hartuar nga një konsulent individual i kontraktuar nga MSHMS Z. R. B. G.	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** U.P. nr. 580.Prot datë 29.12.2016, i ndryshuar me UP. 217 date 05.05.2017 i ndryshuar UP nr. 217/1 date 02.10.2017 ka emëruar anëtarët e ekipit të vlerësimit si më poshtë: -E. H. -F. P. -S. A. -N. Ç. -S. N.
2.Procedura prokurimit QCBS (Vlerësim cilësi/kosto)		
5.Fondi i parashikuar (me tvsh) 1,678,214 USD	**6.Oferta fituese (me tvsh)** 1,144,632 Euro	**7. Diferenca me fondin e parashikuar (me tvsh)** 256,631 Euro
8. Data e hapjes së propozimeve teknike : Date: Maj 8, 2017 Ora: 10:00	**9.Burimi Financimit** Huaja Nr. 8466-AL Banka Botërore. IBRD ñ Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor ò P163239.	**10.Operatoret Ekonomike** 1. C. S. 2. S. I. 3. P... 4. G. Th. & U...
b. Zbatimi i Kontratës		
11.Lidhja e kontratës 12 Dhjetor 2018	**12.Vlera e kontratës (me tvsh)** 1,144,632 Euro	**13.Likuiduar** deri datë 31.05.2021 686,779.20 Euro

Qëllimi: Mbështetja në zbatimin e strategjisë së re të menaxhimit për QSUT me qëllim që të kontribuojnë në përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së QSUT, dhe si rezultat të përmirësojë efikasitetin e përdorimit dhe efektivitetin e niveleve të ndryshme të rrjetit të kujdesit shëndetësor si një vazhdimësi e shërbimeve.
Drejtimet kryesore të angazhimit të konsulentit janë:

- Zbatimi i një sistemi të vazhdueshëm të përmirësimit të cilësisë për të kontribuar në riorganizimin e sistemit të referimit si dhe ristrukturimin/rigjenerimin e procesit të menaxhimit në të dy fushat administrative dhe klinike për të përmirësuar rezultatet dhe cilësinë e kujdesit në QSUT.
- Projektimi, zhvillimi/adaptimi dhe implementimi i një sistemi të ri të automatizuar të informacionit për menaxhimin e spitalit (HMIS) në mënyrë që të optimizojë shpenzimet, të përmirësojë dhe modernizojë praktikat e menaxhimit dhe të lehtësojë instalimin e një kulture të bazuar në prova të vendimmarrjes dhe llogaridhënies në menaxhimin e QSUT-së

Tabela nr. 25

Lloji i procedurës së prokurimit	QCBS (Përzgjedhje në bazë të cilësisë dhe kostos)
Lloji i rishikimit të BB për prokurimin	Rishikim paraprak
Baza ligjore e procedurës së prokurimit	ñUdhëzimet: Prokurimi i shërbimeve të konsulencës në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive e granteve të IDA-s

	nga Huamarrësit e Bankës Botëroreò të muajit janar 2011 (i rishikuar në korrik 2014) seksioni ñQuality and Cost based Selectionò Manuali Operacional i projektit HSIP seksioni ñPërzgjedhje në bazë të cilësisë dhe kostosò

Sipas kërkesave të Udhëzuesve të Bankës Botërore për prokurimin e shërbimeve të konsulencës, për këtë procedurë janë ndjekur hapa e procesit të prokurimit si më poshtë vijon:
Përgatitja dhe miratimi i Termave te Referencës dhe publikimi i kërkesës për shprehje interesi
Përcaktimi i Termave të referencës ï ToRs për përzgjedhjen e konsulentit janë bërë me procedurë tenderi sipas metodës IC nga një konsulent ndërkombëtar individual me vlerë të kontratës 46,286 euro.
Në takimin e parë datë 10.01.2017, ekipi i vlerësimit ka përcaktuar kriteret e vlerësimit, bazuar në kërkesat e Termave te Referencës, si më poshtë në tabelë.

Tabela nr. 26

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Pikët
1.	Përvoja e përgjithshme e firmës (numri i viteve) ne fushën e caktuar	20 pikë
2.	Numri i kontratave te ngjashme (kontratat e se njëjtës natyre dhe kompleksitet), përfunduar 5 vitet e fundit	20 pikë
3.	Kualifikimet përkatëse dhe përvoja specifike në fushën e menaxhimit të spitalit	40 pikë
4.	Numri i viteve të stafit kryesor në firmë	20 pikë
TOTAL		100 pikë

-Kërkesa për shprehje Interesi është miratuar nga Banka Botërore sipas e-mail datë 31.01.2017 dhe është publikuar: Në portalin e UNDB; Në web-in MSHMS dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

Shprehjet e interesit pas publikimit

Brenda afatit të përcaktuar më datë 08.05.2017, si afati i fundit i hapjes së propozimeve teknike, komisioni i vlerësimit ka bërë hapjen e zarfeve për propozimet teknike.
Për këtë procedurë janë ftuar 8 (tetë) firma për të marrë pjesë, dhe kanë paraqitur interes dhe ofertë teknike vetëm 4 (katër) firma. Zarfet me ofertën financiare kanë qëndruar të mbyllura.
Mbas vlerësimit të propozimeve teknike dhe mbas marrjes no objection nga IBRD për subjektet që nuk kaluan fazën e vlerësimit për propozimet teknike, ofertat financiare te tyre, janë kthyen mbrapsht të pa hapura
Konsulentët të cilët paraqitën shprehje interesi, paraqiten në aneksin 4 tabela nr.9.

Procesi i vlerësimit të shprehjeve të interesit

Ekipi i vlerësimit, pasi vlerësoi të gjitha shprehjet e interesit kundrejt përmbushjes së kërkesave të Termave të Referencës, i ka kualifikuar dhe renditur, si më poshtë:

Tabela nr. 27

Nr.	Emri i konsulentit	Shteti	Piket	Renditja
1.	JV G... & U...	Itali	87.6	1
2.	A...	Spanje	87.2	2
3.	C. S.	France	87	3
4.	U...	Kanada	86.6	4
5.	S...	Hungari	84.2	5
6.	Global Healthcare Accreditation	USA	75.8	6
	*Lista e pritjes			
1.	S... I...	Panama	73.4	7
2.	P... | Assistant Manager	Shqipëri	71	8

-Raporti i vlerësimit për shprehjet e interesit është dërguar pranë Bankës Botërore për miratim më 07.03.2017 dhe BB ka miratuar raportin (shoqëruar me short listën e mësipërme) më datë 14.03.2017.

Procesi i vlerësimit teknik për kompanitë e short listës

Në përputhje me ñUdhëzuesit e Prokurimit të Shërbimeve të Konsulencës në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive e grandeve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botëroreò të muajit janar 2011 (i rishikuar në korrik 2014) seksioni ñPërzgjedhja mbi bazë cilësia edhe Kostoò paragrafi 2.9 ñPërgatitja dhe dërgimi i Ftesës për Propozimò, janë ndjekur hapat vijues të procedurës duke dërguar për miratim pranë Bankës Botërore Ftesën për Propozim më datë 14.03.2017, ftesa është miratuar nga BB më datë 15.03.2017. (shiko aneksin nr. 4 tabela nr. 3). Ekipi i vlerësimit në përputhje me komentet e Bankës Botërore, ka përgatitur 5 raporte vlerësimi sipas kronologjisë së mëposhtme:

1. Raport vlerësimi datë 20 nëntor 2017, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 2355/2 prot., datë 30.11.2017 me rezultatet e paraqitura në tabelën nr. 4 aneksi nr. 4;

2. Raport vlerësimi datë 11.12.2017, miratuar nga MSHMS me shkresën nr. 5287 prot., datë 16.12.2017 me rezultat si më poshtë (pa ndryshuar renditjen e kompanive): (shiko tabelën nr. 5 aneksi 4);

Raport vlerësimi datë 26.01.2018, miratuar nga MSHMS me shkresën nr. 995 prot., datë 06.02.2018 me rezultat te paraqitura në tabelën nr. 6 aneksi nr. 4;

Me shkresën nr. 2977 prot., datë 04.05.2018 Ministri i shëndetësisë ka miratuar raportin e rishikuar të vlerësimit të përgatitur e finalizuar nga komisioni i vlerësimit në datën 16.04.2018, sipas komenteve të IBRD të dërguar me datë 20.03.2018. Komisioni i vlerësimit i përcaktuar mbi bazën e amendamentit nr. 2 UP nr. 217/1 datë 02.10.2017, përbëhet nga: znj. E. H., znj. F. P., znj. N. C., znj. S. N., znj. S. A.. Vlerësimi për propozimet teknike paraqitet në tabelën nr. 7 aneksi nr. 4. Me shkresën nr. 2977/1 datë 12.06.2018 Ministri i Shëndetësisë ka miratuar raportin e rishikuar të vlerësimit te përgatitur e finalizuar nga komisioni i vlerësimit ne datën 28.05.2018 me ndihmën e Zyrës së Koordinimit të Projektit, sipas komenteve te bankës Botërore të dërguara me datë 23.05.2018. Komisioni i vlerësimit i përcaktuar mbi bazën e amendamentit nr. 2 UP nr. 217/1 datë 02.10.2017, përbëhet nga: znj. E. H., znj. F. P., znj. N. C., znj. S. N., znj. S. A. kanë bërë vlerësimin e propozimeve teknike të pasqyruara tabelën nr. 8 aneksi nr. 4.

Nga auditimi rezulton se, fazën e vlerësimit financiar e ka kaluar vetëm kompania C. S. me sasinë e pikëve 85.81. Minimumi i pikëve për të kaluar ne fazën tjetër ka qenë 75 pikë.

Vlerësimi financiar

Më datë 06.08.2018, IBRD ka dhënë no objection për raportin e vlerësimit teknik mbi bazën e vlerësimit QBQSS. Në ambientet e PCU, më datë 28.08.2018 ora 10:30 janë hapur ofertat financiare. M.q.s vetëm konsulenti C. S. ishte kualifikuar për vlerësimin e propozimit teknik, komisioni i vlerësimit të ofertave hapi vetëm zarfin me ofertën financiare të kompanisë ñC. S.ò e cila kishte ofruar për shërbimin e kërkuar, shumen 953,860 euro (pa TVSH) dhe taksa 251,015.79 euro. Vlerësimi është bërë sipas parashikimeve të POM të miratuara nga IBRD. Për vlerësimin total, MOP ka parashikuar dy vlerësime:

Vlerësimin teknik

Vlerësimin financiar

S(t) score technic = 85.81 pikë

Pesha e pikëve (80%) S(t)*80% = 68.65 pikë

Financial evaluation

S(p) score prize 100

Pesha e pikëve financiare s(p) 20 pikë

Vlerësimi total: S(t)T+s(p)P= 68.65+20=88.65 pikë

Raporti i kombinuar teknik financiar nga ekipi i vlerësimit ka përfunduar më datë 31 Gusht 2018.

- **Procedura e prokurimit të kontratës së mallrave "Pajisje mjekësore për spitalet, Loti 2 dhe 6"**

Për këtë procedurë u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1- *Dokumentacioni i arkivuar nga Zyra e Koordinimit të Projektit në lidhje me procedurën e prokurimit për punimet me objekt "Pajisje mjekësore për spitalet, Loti 2 dhe 6"*;
2- *Udhëzuesi i procedurave të Prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-konsulente për kredi dhe grante nga IBRD dhe IDA për huamarrësit ndaj Bankës Botërore (i vitit 2014);*
3- *Korrespodenca të ndryshme;*
4- *Etj.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua se:

Si përfituese dhe implementuese direkt e Huas së Bankës Botërore AL ï 8466, e ratifikuar në Parlament me anë të ligjit nr. 572015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"* Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të këtij Projekti, ka parashikuar edhe pajisjen e spitaleve rajonale me pajisje mjekësore.

- *Fondi i parashikuar i investimit*

Spitalet që do pajisen me këto pajisje janë spitalet rajonale të Beratit, Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Kukësit, Fierit, Lezhës, Shkodrës dhe Vlorës.

Loti 2 i prokurimit të pajisjeve mjekësore ka të bëjë me prokurimin e aparateve të Ultrasonografisë dhe Endoskopisë. Nr. i referencës së aktit është *HSIP/G/ICB/01-2016-2* dhe vlera e kontratës *996,075 €*. Sipas specifikimeve teknike, Loti 2 përfshin pajisjen e spitaleve me:

- Aparat Ultratingull kardiak ï 2 copë për Spitalin e Durrësit;
- Aparat Ultratingull abdominal ï 6 copë gjithsej, 2 për spitalin e Durrësit, dhe nga 1 për spitalet e Dibrës, Gjirokastrës, Kukësit dhe Vlorës;
- Aparat Ultratingull obstetrik e gjinekologjik ï 8 copë gjithsej, nga 1 për spitalet e Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Korçës, Fierit, Lezhës, Shkodrës dhe Vlorës;
- Bronkoskop ï 4 copë gjithsej, nga 1 për spitalet e Durrësit, Elbasanit, Shkodrës dhe Vlorës;
- Laparoskop ï 5 copë gjithsej, nga 1 për spitalet e Durrësit, Elbasanit, Fierit, Shkodrës dhe Vlorës.

Loti 6 i prokurimit të pajisjeve mjekësore ka të bëjë me prokurimin e aparatit të Angiografisë. Numri i referencës së aktit është *HSIP/G/ICB/01-2016-6* dhe vlera e kontratës *373,200 €*. Sipas specifikimeve teknike Loti 6 përfshin aparaturën Angiograf për spitalin Rajonal të Fierit. (Bazuar në Planin e Shpërndarjes së aparaturave ï Dokumentet e Ofertimit për Prokurimin e Mallrave në Sektorin Shëndetësor, Kapitulli VII ñSkeduli i Kërkesaveò).

- *Ecuria e Procedurës së Prokurimit*

Të gjitha lotet kanë qenë të përfshira në një procedurë të vetme prokurimi.

- Nëpërmjet shkresës së datës 31.01.2017, Grupi Teknik i Punës, i përbërë nga z. P. M., Koordinator i Komponentit dhe znj. D. K., znj. S. N., znj. L. P., znj. A. L. e znj. T. C., anëtare të Grupit Teknik të Punës, është bërë prezantimi i Specifikimeve dhe Kërkesave Teknike për prokurimin e pajisjeve mjekësore për spitalet rajonale, Njësisë së Koordinimit të Projektit ñPërmirësimi i Sistemit të Shëndetësisëò.

- Sipas shkresës nr. 54 prot. datë 03.02.2017, Qendrës së Botimeve Zyrtare (QBZ) i është dërguar kërkesa për publikimin e ñNjoftimit Specifik të Prokurimitò ñPajisje Mjekësore për Spitalet Rajonaleò.
- Në datën 10.04.2017 është bërë lista e ofertuesve në këtë procedurë ku janë listuar 27 pjesëmarrës.
- Nëpërmjet Amendamentit Nr. 1, datë 05.05.2017, nr. 1579/1 prot., ka hyrë në fuqi Urdhri i Prokurimit nr. 218, datë 06.05.2017 ñPër prokurimin e Pajisjeve mjekësore për Spitalet Rajonaleò, si dhe modifikimin e paragrafit 3 të Urdhrit të Prokurimit nr. 154, datë 20.03.2017, ku ofertat e marra do të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit, i përbërë nga z. P. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Spitalor; z. P. K., me detyrë Drejtor i Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore, znj. M. P., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Sistemeve Mjekësore, MSH; znj. V. Xh., me detyrë Specialiste, Drejtoria e Administrimit Spitalor, Sektori i Standardeve dhe Protokolleve Spitalore, MSH; dhe znj. L. P., me detyrë Specialiste e Sektorit të Sistemeve Mjekësore.
- Më datë 05.04.2017 Grupi Teknik i Punës i ka dërguar me email Zyrës së Koordinimit të Projektit tabelën përmbledhëse me specifikimet teknike pas rishikimeve dhe përditësimit të datës 23.03.2017.

- *<u>Në lidhje me kriteret e vlerësimit</u>*

Në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës (të cilat janë të njëjtat për të gjitha lotet) konstatohet se janë paraqitur për ofertuesit e mundshëm disa kërkesa si më poshtë: Evidencë dokumentare që ofertuesi i ka kualifikimet e nevojshme për realizimin e kontratës, si:

- Licenca nga autoriteti rregullator i vendit të prodhimit të mallrave që ofron;
- Ka marrë pjesë më parë në procese të ngjashme të paktën 2 vjet për të njëjtat mallra dhe të paktën 5 vjet për mallra të ngjashme;
- Ofertuesi është i autorizuar nga prodhuesi i mallrave për të tregtuar ato në vendin e Blerësit;
- Një deklaratë të kapacitetit prodhues;
- Xhiron mesatare vjetore për një sasi të paktën sa 1.5 herë çmimet e loteve për të cilat aplikon;
- Listë të kontratave të mëparshme të furnizimit të pesë viteve të fundit me informacion të detajuar;
- Të paktën një letër reference të lëshuar nga kontraktori më i fundit për plotësimin e suksesshëm të një kontrate të ngjashme;
- Certifikatë ISO 9001 për importimin, marketingun, instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore;
- Certifikatë ISO 9001 / ISO 3485 të prodhimit të pajisjeve të ofruara;
- Certifikata MDD 93 / 42 CE konformiteti për të gjitha pajisjet për secilin lot;
- Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë origjine dhe vendin e kompaninë prodhuese;
- Deklaratën që pajisjet e ofruara janë të reja dhe produkt origjinal i teknologjisë së re;
- Ofertuesi duhet të ketë të paktën 2 punonjës me profesion inxhinier të specializuar për instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore; etj.

Në vijim, sipas shkresës me nr. 1579 prot., datë 20.03.2017 është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 154 datë 20.03.2017 i Titullarit z. I. B., sipas të cilit është përcaktuar edhe lloji i procedurës Tender Konkurrues Ndërkombëtar, në të cilin është bërë edhe përcaktimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përbërë nga z. P. M., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Spitalor; z. P. K., Drejtor i Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore; znj. D. K., Specialiste e Drejtorisë së Prokurimeve dhe Investimeve; znj. L. P., Specialiste e Sektorit të Sistemeve Mjekësore; dhe znj. S. N., Përgjegjëse e Sektorit të Standardeve dhe Protokolleve,

me vlerë të fondit të parashikuar shumën 4,900,000 Euro. Shuma për Lotet 2 dhe 6 është 1,369,275 Euro.
- Më datë 10.04.2017 është bërë hapja e ofertave për të 6 lotet e procedurës së prokurimit.
- Me shkresën nr. 4241 prot, datë 16.10.2017 është miratuar nga Drejtorja e Kabinetit në MSHMS, (personi i deleguar nga Ministrja e MSHMS) vijimi i proceduarve të prokurimit për ñPajisje Mjekësore për Spitalet Rajonaleò dhe për këtë është autorizuar Njësia e Koordinimit të Projektit të vijojë procedurat sipas Manualit Operacional të Projektit për dërgimin në Bankën Botërore të Raportit të Vlerësimit të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit në datën 29.06.2017.
- Me shkresën nr. 181 prot, datë 26.10.2017 është miratuar nga Drejtorja e Kabinetit në MSHMS, E. H. (personi i deleguar nga Ministrja e MSHMS) vijimi i procedurave të prokurimit për ñPajisje Mjekësore për Spitalet Rajonaleò dhe për këtë është autorizuar Njësia e Koordinimit të Projektit të vijojë procedurat sipas Manualit Operacional të Projektit për dërgimin në Bankën Botërore të Shtojcës së Raportit të Vlerësimit Nr. 1, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit në datën 12.10.2017.
Në procesverbalin e mbajtur për hapjen e ofertave rezulton se kanë marrë pjesë në këtë procedurë në total 27 subjekte për të gjitha lotet, duke qenë se janë përmbledhur në të njëjtën tabelë dhe ditë. Për lotin 2 ñUltrasonografi dhe Endoskopiò, dhe Lotin 6 ñAngiografiò kanë marrë pjesë subjektet si më poshtë:

Tabela 28

Nr.	Emri i Kompanisë	Vlera e Ofertës për secilin Lot (€)
1	I... T.., T... & B... S...& B.. E..	Loti 2:753,273
2	JV ñB... E... & I... T..., T... & B... S...ò	Loti 6: 364,190
3	M... SHPK.	Loti 2: 887,000
4	P... M... S... N... B.V	Loti 2: 836,937 Loti 6: 313,767
5	JV ñB... ï B... S... & E...ò	Loti 2: 1,133,166.3
6	SH... / E... S...	Loti 6: 311,000
7	G.. H..	Loti 6: 363,000
8	S... H...	Loti 6: 362,000
9	I... S...	Loti 2: 830,062.62
10	G... SHPK.	Loti 2: 949,000

- *Në lidhje me vlerësimin e ofertave*

Për Lotin 2, sipas objeksioneve të Bankës, ofertuesi JV- ñI... T... T... & B... S... B... E... duhej refuzuar për shkak të mangësive lidhur me sigurinë e ofertës. Ofertuesi i dytë me ofertën më të ulët ekonomike është ñI... S...ò Spa. Ai përmbush specifikimet teknike dhe kriteret paskualifikuese dhe Komiteti i Vlerësimit e rekomandon si fituese. Në lidhje me Lotin 6, fillimisht është shpallur fituese P... M... S... N... B.V. Në vijim në shtesën që i është bërë raportit të vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas objeksionit të Bankës dhe vlerësimin e saj si me ñdevijime të voglaò, është shpallur fituese firma Sh. Z., e cila në raportin e parë të vlerësimit nga KVO është refuzuar. Në vijim në shtesën që i është bërë raportit të vlerësimit pas objeksionit të Bankës lidhur me vlerësimin e ofertës së dhe vlerësimin e saj si me ñdevijime të voglaò të hartuar nga Komisioni i Vlerësimit, është shpallur fituese firma Sh. Z.. Komisioni i Vlerësimit e ka rekomanduar si fituese firmën Sh. Z. sepse plotëson specifikimet teknike. Pasi është njoftuar Banka për përcaktimin e kësaj firme si fituese, në emailin e datës 30.10.2017, znj. M. M., Specialiste e Prokurimeve në Zyrën e Bankës në Tiranë, ka bërë me dije se Banka nuk ka komente për këtë përzgjedhje. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, sa i takon sistemit UPS për aparatin Angiograf në tabelë specifikohet se *formulari i Autorizimit të prodhuesit i paraqitur nga firma fituese është i skanuar dhe jo i vulosur nga ofertuesi*. Fituesit e loteve janë shpallur dhe njoftuar nga

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. O. M., nëpërmjet shkresës me nr. 5204/5, datë 12.12.2017 (fituesja e lotit 2) dhe nëpërmjet shkresës nr. 5204/1 datë 12.12.2017.
Në datën 10.11.2017 është hartuar nga KVO Raporti i rishikuar i vlerësimit të ofertave dhe rekomandimi për shpalljen e fituesve, i cili është miratuar nga Drejtorja e Kabinetit të MSHMS, znj. E. H., nëpërmjet shkresës me nr. 186 prot., datë 15.11.2017.

- **Procedura e prokurimit të kontratës së punimeve për projektin "Rishikimi i Master Planit ekzistues spitalor në Shqipëri (Plani i racionalizimit të lehtësimit shëndetësor për Shqipërinë)**

Për këtë procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1- *Dokumentacioni i arkivuar nga Zyra e Koordinimit të Projektit në lidhje me procedurën e prokurimit për kontratën me objekt "Rishikimi i Master Planit ekzistues spitalor (Plani i racionalizimit të lehtësimit shëndetësor për Shqipërinë)"*;
2- *Udhëzuesi i Bankës Botërore "Për përzgjedhjen e punësimin e konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" (e vitit 2014);*
3- *Korrespodenca të ndryshme;*
4- *Etj.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua se:

Si përfituese dhe implementuese direkt e Huas së Bankës Botërore AL ï 8466, e ratifikuar në Parlament me anë të ligjit nr. 572015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"* Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të këtij Projekti, ka parashikuar rishikimin e Master Planit ekzistues spitalor.

- *Fondi i parashikuar i investimit*

Objektivi kryesor i këtij konsultimi është rishikimi dhe përditësimi i Master Planit ekzistues spitalor bazuar në vlerësimet më të fundit të situatës sa i takon infrastrukturës shëndetësore dhe mbështetjen e qeverisë me elaborimin e një plani të racionalizuar e të përshtatshëm shëndetësor për instalimin e një rrjeti gjithëpërfshirës ambulator e spitalor përgjatë gjithë vendit si dhe identifikimin e nevojave për investime në pajisje mjekësore nëpër spitale si pjesë e implementimit të master planit. Nr. i referencës së aktit është *HSIP/CS/QCBS/05-2015* dhe vlera e kontratës *629,424 €*.

- *Ecuria e Procedurës së Prokurimit*

- Me shkresën me nr. 4063 prot., datë 27.06.2018 është bërë prezantimi i termave të referencës për shërbimin e konsulencës ñRishikimi i Master Planit ekzistues spitalor në Shqipëri (Plani i racionalizimit të lehtësimit Shëndetësor për Shqipërinë)ò, të përgatitura e miratuara nga Grupi Teknik i Punës së komponentit të 1-rë: ñPërmirësimi i Shërbimeve Spitaloreò, në bashkëpunim me Njësinë e Koordinimit të projektit. Grupi Teknik i Punës përbëhet nga P. M. (koordinator), S. N., L. P., A. L. dhe D. K. (anëtarë).
- Me shkresën nr. 6116 datë 24.10.2018, në vijim të rekomandimeve të Bankës Botërore Termat e Referencës për këtë procedurë janë rishikuar duke përfshirë disa aktivitete të reja të cilat ndihmojnë në arritjen e rezultateve maksimale për këtë aktivitet. Shuma e përcaktuar në Planin e ri të prokurimit është 800,000 ú dhe ndërkohë grupi i punës, i përbërë nga znj. F. B. (koordinatore), znj. M. H., znj. J. D., znj. M. C. dhe z. B. M. (anëtarë), ka rritur në konkluzionin se buxheti i mjaftueshëm për këtë aktivitet është rreth 482,676ú.

- *Në lidhje me kriteret e vlerësimit*

Në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik konstatohet se janë paraqitur për ofertuesit e mundshëm disa kërkesa si më poshtë:

Eksperienca e nevojshme e kërkuar:

Eksperiencë dhe njohuri në fushën e menaxhimit shëndetësor, planifikimit dhe reformës së sistemeve shëndetësore. Njohje e sistemit shëndetësor shqiptar dhe kuadrit ligjor rregullator përkatës.

Kualifikimet

Kompania konsulente duhet të ketë dëshmi dhe rekorde të projekteve të mëparshme të realizuara:

- Regjistër profesional të projekteve të master planeve të ndryshme për spitale kombëtare ose sisteme të kujdesit shëndetësor;
- Eksperiencë të provuar në të paktën 2 detyra të së njëjtës madhësi e qëllim dhe të paktën 5 vjet eksperiencë si evidencë e shkruar;
- Preferohet të kenë punuar më parë në reformimin e sistemit shëndetësor të një vendi anëtar të BE-së, të vendeve në periudhë tranzicioni, si dhe vende që janë në fazën e para-aksesimit në BE;
- Eksperienca të mëparshme në Shqipëri përbëjnë avantazh.

Në vijim përfshihen dhe kërkesat për stafin e nevojshëm dhe certifikimet, ku përmendim:

- *Lideri i ekipit ndërkombëtar dhe specialist i menaxhimit shëndetësor*, i cili të ketë eksperiencë dhe master në menaxhim shëndetësor, ekonomik, menaxhim dhe administrim biznesi, ose në fushën e përmendur në termat e referencës, etj.
- *Ekonomist në fushën e financave publike*, i cili të ketë master në fushën e menaxhimit shëndetësor ose financë ekonomi, ose në një fushë tjetër të përshkruar nga ToR, si dhe eksperienca të mëparshme lidhur me analizat ekonomike, etj.
- *Planifikues investimesh*, i cili të ketë master në fushën e menaxhimit shëndetësor, ekonomik dhe menaxhim dhe administrim biznesi, ose në një fushë tjetër të përshkruar nga ToR, si dhe eksperienca të mëparshme lidhur me planifikimin, etj.
- *Inxhinier Ndërtimi*, i cili të ketë master në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit, menaxhimit shëndetësor, ekonomik, menaxhim dhe administrim biznesi, ose në një fushë tjetër të përshkruar nga ToR, si dhe eksperienca të mëparshme lidhur me planifikimin dhe pajisjen e ndërtesave të spitaleve, etj.

Po njësoj kërkohen *Planifikues Burimesh Njerëzore në fushën e kujdesit shëndetësor*, *Menaxher të institucioneve të kujdesit shëndetësor*, *Specialist GIS*, *Zhvillues i planit të strategjisë së komunikimit për reformat e sektorit publik* si dhe *Ekspert lokal*, njohës i sistemit shëndetësor në Shqipëri.

E gjithë ekspertiza e mësipërme duhet të jetë në dispozicion dhe nuk ka problem nëse një person kryen më shumë se një funksion nga ato që janë listuar më sipër.

Ekipi konsulent do të raportojë rregullisht në MSHMS në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet. Raportet që do të përgatiten për MSHMS dhe për Bankën Botërore janë si më poshtë:

- Raporti fillestar;
- Raportet paraprake;
- Raportin përfundimtar të përfundimit të shërbimit, i cili në brendësi ndër të tjera përmban dhe
    - Draftin e Master Planit për Spitalin,
    - Policat e propozuara për të ndihmuar në implementimin e këtij të fundit,

- Planin e Implementimi të Master Planit, Strategjinë e Komunikimit, etj.

Për të gjitha këto raporte, Termat e Referencës, të rishikuara, me shkresën nr. 6116 datë 24.10.2018, është përcaktuar në mënyrë të detajuar se çfarë duhet të përmbajnë.
Për termat e rishikuara të referencës është marrë no-objection nga Banka Botërore nëpërmjet e-mailit të datës 25.10.2018.
Vlerësimi nga ana e grupit të punës është bërë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 29

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikë
1	Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e kërkuar	30
2	Numri i kontratave të ngjashme gjatë 5 viteve të fundit	30
3	Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimet e personelit kryesor	40
Total		**100**

Nëpërmjet shkresës nr. 6429 prot., datë 08.11.2018, ka dalë Urdhri i Prokurimit i së njëjtës datë me nr. 775, ñPër prokurimin e konsulencës ñRishikimi i Master Planit ekzistues spitalor në Shqipëri (Plani i Racionalizimit të lehtësimit Shëndetësor për Shqipërinë)ò. Urdhri i prokurimit është për rifillimin e procedurës së prokurimit, me numrin HSIP/CS/QCBS/05-2015. Metoda e prokurimit është QCBS (përzgjedhje sipas kualifikimeve dhe kostos) bazuar në Udhëzuesin e Bankës Botërore ñPër përzgjedhjen e punësimin e konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botëroreò (botim i vitit 2011, rishikuar në vitin 2014), Seksioni II ñPërzgjedhja sipas metodës së kualifikimeve dhe kostosò. Ekipi i vlerësimit të shprehjeve të interesit përbëhet nga F. B., J. D. dhe E. L.. Me shkresën nr. 339 prot., datë 12.11.2018, Menaxherja e projektit znj. B. D. i ka kërkuar Qendrës së Botimeve Zyrtare publikimin e Ftesës për Shprehje Interesi për ñRishikimin e Master Planit Ekzistues Spitalor në Shqipëri, duke e shoqëruar me termat e rishikuara të referencës. QBZ e ka publikuar këtë kërkesë në Botimin nr. 46 të vitit 2018, në datën 27.11.2018.
Shprehjet e interesit janë hapur më datë 12.12.2018, në orën 10:00. Brenda afatit të vendosur kanë shprehur interesin e tyre 18 konsulentë nga vende të ndryshme.

1. I... M... (Spanjë)
2. JV M. GmBH and A... A... M... (Gjermani-Gjermani)
3. S... I... (Panama)
4. I... I... A.. (Emiratet e Bashkuara Arabe)
5. I... H... U... (Canada)
6. U... R... (USA)
7. JV: C... C... GmBH & M... C... & O... H... C... (Austri, Spanjë, Hollandë)
8. N... A.... E... C... & T... (Turqi) & P... (Greqi)
9. I... H... & P... (Hungari)
10. JV: I... G... & S... C... GmBH (Austri-Austri)
11. O... P... M... (Mbretëria e Bashkuar)
12. JV: E... H... M... & P... C... (Gjermani-Shqipëri)
13. JV: I... I... C... A... S... & E... P... D... C... (Belgjikë-Kroaci-Shqipëri)
14. JV: P... P..., P... A... and I... R... (Poloni-Shqipëri-Shqipëri)
15. JV: E... P...; G... C...; P... (Greqi-Francë-Shqipëri)
16. JV C. S., S... and D... në nën konsulencë me B... (Francë-Francë-Spanjë)
17. JV: M... C... Ltd, H... S... M... C... of S... U... and A...-S... SHPK. (Hungari-Hungari-Shqipëri)
18. E... H... G... (Danimarkë).

- Gjashtë firmat që u shortlistuan në vijim janë përkatësisht numrat (si më sipër): 2, 6, 7, 12, 14 dhe 16.

Raporti i vlerësimit i përgatitur nga KVO është miratuar nga Ministri i MSHMS nëpërmjet shkresës me nr. 547 prot., datë 25.01.2019.
- Pas kësaj, në vijim i është dërguar firmave të shortlistuara kërkesa për propozim për paraqitjen e propozimeve të tyre teknike dhe financiare. Kjo kërkesë është dërguar pas plotësimit të komenteve të Bankës Botërore dhe miratimit nga ana e Ministres së MSHMS me shkresën nr. 547/3 prot., datë 06.03.2019.
- Në vijim, në datën 07.03.2019, i janë dërguar kërkesat për propozime për shkrehje interesi 6 kompanive të shortlistuara nga faza e parë.

- Në lidhje me vlerësimin e ofertave

- Në datën 08.04.2019, në orën 10:00, është bërë hapja e propozimeve teknike ku kanë paraqitur ofertat e tyre 5 nga 6 kompanitë e shortlistuara, konkretisht:

1. JV M... GmBH and A... A... M... (Gjermani-Gjermani)
2. U... R... (USA)
3. JV: C... C... GmBH & M... C... S... dhe O... H... C... (Austri, Spanjë, Hollandë)
4. JV: P... P..., P... A... & I... R... (Poloni-Shqipëri-Shqipëri)
5. JV C... S..., S... and D... në nën konsulencë me B... (Francë-Francë-Spanjë).

- Me shkresën nr. 547 prot., datë 23.05.2019, Ministri i MSHMS ka bërë miratimin e raportit të vlerësimit të popozimeve teknike për procedurën.
Sipas vlerësimeve për propozimet teknike renditja e kompanive ishte:

Tabela nr. 30

Kompania	Pikët	Renditja
JV: P... P..., P... A... & I... R... (Poloni-Shqipëri-Shqipëri)	92.69	E para
JV M... GmBH and A... A... M... (Gjermani-Gjermani)	83.54	E dyta
JV C... S..., S... and D... në nën konsulencë me B... (Francë-Francë-Spanjë)	77.01	E treta
JV: C... C... GmBH & M... C... S... dhe O... H... C... (Austri, Spanjë, Hollandë)	76.07	E katërta
U... R... (USA)	75.05	E pesta

- Hapja e propozimeve financiare është bërë më datë 24.06.2019, në orën 10:00, në prani të KVO-së. Propozimet ishin nga të njëjtat kompani që bënë dhe propozimet teknike. Pas përllogaritjes së pikave të marra nga oferta teknike dhe ajo ekonomike, renditja ishte si më poshtë:

Tabela nr. 31

Kompania	Oferta financiare	Pikët	Renditja
JV: P... P..., P... A... & I... R... (Poloni-Shqipëri-Shqipëri)	524,520 ú	91.372	E para
JV M... GmBH and A... A... M... (Gjermani-Gjermani)	659,981 $	82.212	E dyta
JV C... S..., S... and D... në nën konsulencë me B... (Francë-Francë-Spanjë)	451,651 ú	81.608	E treta
JV: C... C... GmBH & M... C... S... dhe O... H... C... (Austri, Spanjë, Hollandë)	714,400 ú	73.496	E katërta
U... R... (USA)	736,791 ú	72.30	E pesta

Përfundimisht kompania me vlerësimet e kombinuara më të larta është JV: P... P..., P... A... & I... R.... (Poloni-Shqipëri-Shqipëri).
- Në datën 21.08.2018 është lidhur kontrata me nr. 3964 prot., ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe JV P... P..., P... A... and I... R....

2.5 Mbi zbatimin e kontratave të lidhura për mallra, shërbime dhe punime përfshirë verifikimin dhe inspektimin në lidhje me produktet finale të këtyre kontratave.

Tabela nr. 32

Informacion mbi Auditimin e Zbatimit të Kontratave					
Numri i kontratave	Vlera e Kontratave	Kontrata të audituara			
		Në numër	%	Në vlerë	%
Shërbime Konsulence					
30	3,761,574	2	7 %	1,774,056	47 %
Mallra					
12	8,849,278	7	58 %	7,984,506	90 %
Punime Civile					
3	12,817,203	3	100 %	12,817,203	100 %
Shërbime Konsulence+Mallra+Punime Civile					
45	**25,428,055**	**14**	**31 %**	**23,409,345**	**92 %**

Pra në total u audituan:

- *92 % në vlerë e procedurave të prokurimit;*
- *90 % në vlerë e zbatimit të kontratave (Shërbime/Mallra/Punime);*

Informacioni mbi likuidimet e kryera për kontratat e lidhura sipas tabelës nr. 2.4.2 si më sipër është si më poshtë:

Tabela nr. 33

Informacion mbi Likuidimet e Kontratave të lidhura			
Numri i kontratave	Vlera e Kontratave	Vlera e Likuiduar	
		Në vlerë	%
Shërbime Konsulence			
30	3.761.574	1.316.924	35%
Mallra			
12	8.849.278	4.845.769	55%
Punime Civile			
3	12.817.203	5.610.198	44%
Shërbime Konsulence+Mallra+Punime Civile			
45	**25.428.055**	**11.772.891**	**46%**

2.5.1 Mbi zbatimin e kontratës *"Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin pedriatik ekzistues"*

1. Titulli i gjetjes: Rritje e fondit limit si pasojë e mos respektimit të strukturës së kostos për zërat e preventivit.

Situata: Projekti për objektin *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"*, është

hartuar nga ana e BOE *R... & A...*, me të cilin sipas aktit me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, me datë 30.11.2016, është lidhur kontrata për shërbime konsulence mes këtij BOE dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Në zbatim të kontratës së shërbimit si më sipër nga ana e konsulentit është hartuar Projekti i ndërtimit të godinës së re dhe rikonstruksionit të godinës ekzistuese me një vlerë totale të parashikuar investimi si më poshtë:

Tabela nr. 34

1	RIKONSTRUKSION GODINA EKZISTUESE	Lekë	**363,002,294**
2	SHTESË ANËSORE E GODINËS	Lekë	**751,811,614**
PËRMBLEDHËSE			**1,114,813,908**

Tabela nr. 35

1	RIKONSTRUKSION GODINA EKZISTUESE	Euro	**2,690,568**
2	SHTESË ANËSORE E GODINËS	Euro	**5,297,311**
PËRMBLEDHËSE			**7,987,879**

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *".... & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 ú me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Kontrata është lidhur mes palëve dhe konkretisht, znj. O. M., Ministër i MSHMS, në rolin e punëdhënësit dhe z. A. M. Administrator i *".... "* ShPK, në rolin e përfaqësuesit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë. Siç konstatohet nga sa më sipër rezulton se diferenca mes vlerës së parashikuar të investimit dhe vlerës së kontratës është 16,794,864 lekë me TVSH, ose 1.5 % më pak. Koordinator për Kontratën që përfshin detyrën e projektimit, sipas Urdhrit nr. 410, datë 26.09.2016, administruar në MSHMS me nr. 2493/3 prot., datë 28.09.2016, është caktuar znj. D. K., specialiste në Drejtorinë e Prokurimeve. Sipas dokumentit *Letër pranimi për Fazën e Parë*, administruar në MSHMS me nr. 2246 prot., datë 27.04.2017, nga ana e Koordinatorit të Kontratës është miratuar përmbushja e detyrimeve kontraktuare të BOE R... & A... duke miratuar projektin e dorëzuar. Kontrata e lidhur mes BOE *R... & A...* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes me objekt ñ*Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin pedriatik ekzistues"* dhe me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016, ka parashikuar këto detyra ndaj konsulentit:

Faza 1: *Vlerësimi teknik i ndërtesave të spitaleve pediatrike*;

Faza 2: *Studimi dhe hartimi i projektit inxhinierik, Specifikimet Teknike dhe Preventivi*;

Faza 3: *Përgatitja e specifikimeve teknike për instalimin e pajisjeve mjekësore dhe aparaturave në mjediset e godinës së spitalit pedriatik ekzistues*;

Faza 4: *Mbikëqyrja e Punëve Civile për rehabilitimin fizik dhe azhornimin e Infrastrukturës së spitalit Pediatrik bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga autoritetet e menaxhimit të spitaleve dhe në përputhje me Planin e Përgjithshëm të Spitalit (Prill 2014)*.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se preventivi i hartuar nga ana e konsulentit përmban gabime në metodologjinë e përdorur në hartimin e analizave të kostos për zërat e përfshirë në preventiv. Sipas Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos se punimeve te ndërtimit"* punimet e ndërtimit ndahen në dy kategori kryesore:

- Punime ndërtimi;
- Punime teknologjike dhe të montimit;

Vetë punimet teknologjike dhe të montimit ndahen më tej në:

a. Punime teknologjike;
b. Punime montimi;

Nga këto më sipër, analiza e kostove e punimeve të ndërtimit dhe atyre teknologjike është e tillë që:

- Shpenzimet e drejtpërdrejta përbëhen nga:

Kostot për punëtori + kostot për transport + kostot për materiale + kostot për makineri;

- Shpenzimet e përgjithshme (ose plotësuese siç njihen ndryshe) llogariten në përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta e konkretisht 8 % e tyre;
- Fitimi i sipërmarrësit përllogaritet me përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta e konkretisht 10 % e tyre;
- Shuma e këtyre kategorive (shp. të drejtpërdrejta + shp. të përgjithshme + fitim) përbën edhe çmimin e zërit të punës;

Kurse, analiza e kostos e punimeve të montimit ndryshon për nga struktura në krahasim me punimet e ndërtimit dhe atyre teknologjike pasi:

- Shpenzimet e drejtpërdrejta përbëhen nga:

Kostot për punëtori + kostot për transport + kostot për materiale (vetëm materialet plotësuese dhe jo pajisjet) + kostot për makineri;

- Shpenzimet e përgjithshme (ose plotësuese siç njihen ndryshe) llogariten në përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta e konkretisht 50 % e tyre;
- Fitimi i sipërmarrësit përllogaritet me përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta e ato plotësuese të marra së bashku, konkretisht 10 % e tyre;

Shumës së këtyre kategorive (shp. të drejtpërdrejta + shp. të përgjithshme + fitim) duke i shtuar edhe vlerën e pajisjes përbëjnë edhe çmimin e zërit të furnizimit dhe punës. Sipas Udhëzimit të mësipërm në punime montimi përfshihen:

Në këto punime përfshihen punimet për montimin e pajisjeve dhe të makinerive, si:

1. Montimi i makinerive metalpunuese, transportuese e ngritëse (ashensorë, elevatorë, transportierë, vinç-ura, monorelsa etj.), presa, pompa, kompresorë etj.

2. Montimi i kaldajave në ndërtesat qytetare dhe industriale, përfshirë barabanët, skeletet e sheshet metalike, aksesorët si dhe aparatet e ndryshme (si manometër, termometër etj.).

3. Montimi i pajisjeve dhe aparaturave të ndryshme, me apo pa presion, të parashikuara në projektet teknologjike, të gatshme ose në pjesë, si: bunkerë, rezervuarët, ushqyesit, ciklonet, skeletet e sheshet metalike të

tyre etj. (edhe në rastin kur përgatiten nga sipërmarrësi).
4. Aksesoret dhe mbushjet e pajisjeve teknologjike, si zgarat, portat e bokaportat dhe mekanizmat përkatëse në kaldajat e furrat, mbushjet me kimikate (si katalizatore, rrëshirë, rashike, pjata e unaza porcelani dhe materiale te ndryshme) etj.
5. Montimi i pajisjeve dhe aparaturave ne instalimet e ndryshme elektrike, telefonike, citofonike, si me poshtë vijon:
a) montimi i llambave të zakonshme dhe i ndriçuesve të çdo lloji (me përjashtim të portollampave të zakonshme), paneleve, kuadrove shpërndarëse të fuqisë motorike. komandimit, sinjalizimit, ndriçimit te kasetave elektro-telefonike e te matje-kontrollit, përfshirë pajisjet e montuara brenda tyre;
b) montimi i pajisjeve dhe i instalimeve ne kabinat elektrike, centraleve telefonike, nënstacioneve e transformatorëve (përfshi vajin), gjeneratorëve, akumulatorëve, reaktorëve, elektromotorëve etj.;
c) montimi i aparateve dhe pajisjeve të fuqisë motorike, te matje-kontrollit, te drejtimit dhe sinjalizimit, si dhe i çelësave, siguresave, shkarkuesve e leshuesve magnetite etj.
6. Montimi i bojlerëve, pompave, aspiratoreve, kondicionerëve, rezervuarëve, qendrore e vendore, matësve te ujit, gazit, energjisë, aparateve telefonike etj. në ndërtesat e instalimet e çdo lloji, si dhe i armaturave të ndryshme, si saraçineska, valvola etj., të komanduara me energji elektrike ose pneumatike etj.
7. Montimi i pajisjeve elektroshtepiake, perdeve, luksaflekseve, dollapëve, të tryezave për ndërtesat e ndryshme, qytetare dhe industriale etj. Në këto punime përfshihen edhe shkarkimi, depozitimi, dekonservimi i pajisjeve dhe makinerive, përfshirë, transportin ne vendin e montimit dhe provat pa ngarkese te tyre.

Në fakt nga ana e projektuesit punimet e montimit për pajisjet elektrike dhe mekanike janë hartuar me një strukturë të tillë kostoje si të ishin punime ndërtimi të nënkategorisë punime ndërtimi, duke rritur kështu vlerën e preventivit. Gjithashtu, për punimet mekanike, rezulton se analiza e kostos së zërave të përfshirë në preventiv ka edhe një gabim tjetër i cili konsiston në faktin se shuma prej 10 % e fitimit nuk është llogaritur mbi shpenzimet e drejtpërdrejta por mbi shumën [shpenzime të drejtpërdrejta + shpenzimeve të përgjithshme] duke rritur kështu vlerën e preventivit. Grupi i auditimit, pasi bëri një renditje të zërave në bazë të vlerës (sasi x çmim), për gati 95 % (në vlerë) të totalit të zërave të përfshira në kategorinë *Pajisje*, përllogariti çmimet e korrigjuara sipas strukturës së kostos që dikton udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos se punimeve te ndërtimit"* për pajisjet elektrike dhe ato mekanike.
Në tabelën e mëposhtme paraqiten diferencat totale mes çmimeve të preventivit të llogaritura nga ana e hartuesit të projekt-preventivit të punimeve si dhe çmimeve të korrigjuara nga ana e Audituesve për çdo objekt dhe kategori punimesh:

Tabela nr. 36

Objekti	Diferencat në Punime për pajisjet elektrike	Diferencat në Punime për pajisjet mekanike
Ekzistues	6,683,251	242,498

Shtesa	11,173,579	13,297,645
Shuma	17,856,830	13,540,143
TOTAL	**31,396,973 lekë**	

Si përfundim, rezulton se nga ana e konsulentit janë preventivuar tepër shuma prej 31,396,973 lekë pa TVSH. (Aneksi 5.1, Tabelat 5.1.1, 5.1.2, 5.1.3 dhe 5.1.4).

Kriteri:

- Kontrata e shërbimit me objekt *"Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin pediatrik ekzistues"* me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016, konkretisht detyra 2 *Studimi dhe hartimi i projektit inxhinierik, Specifikimet Teknike dhe Preventivi*, sipas të cilës Projektuesi duhet të përgatisë edhe koston e investimit;

- VKM me nr. 629 datë 15.07.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"*, Pika 1 <u>*ku përcaktohet se:*</u>

"Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi".

- VKM nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar:

Pika 2 <u>*ku përcaktohet se*</u>:

"Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim";

Pika 9 <u>*ku përcaktohet se*</u>:

"Vlera e zërave të punës të preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik të projektuara nga subjekte, publike apo private, llogariten si prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit me çmimet për njësi të manualit teknik të çmimeve në fuqi";

Pika 11 ku përcaktohet se:

"Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programime të fondeve, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të llogarisin çmimet e zërave të punës, për të përcaktuar vlerën limit të objektit, në bazë të manualit të miratuar të çmimeve të ndërtimit, mbështetur në analizat teknike të çmimeve".

- Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*:

Kreu I, germa A, paragrafi i fundit <u>*ku përcaktohet se:*</u> *"Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat"*

Kreu II, Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit:

Germa B, <u>*ku përcaktohet se*</u>: *Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, që përfshihen në çmimet njësore të zërave të punës, për punimet e ndërtimit dhe punimet teknologjike llogariten me përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta, ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe*

makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit.;
Fitimi për punimet e ndërtim-montimit, që ndryshon sipas llojit, madhësisë dhe kohëzgjatjes s2 objektit etj., llogaritet në përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta dhe plotësuese.
- Urdhri nr. 410 datë 26.09.2016, administruar në MSHMS me nr. 2493/3 prot., datë 28.09.2016, pika 2 përgjegjësitë e Koordinatorit të Kontratës, paragrafi i dytë *ku përcaktohet se: Koordinatori i Kontratës do të jetë përgjegjës për:*
"- Pranimin, komentimin dhe miratimin e raporteve dhe çdo lloj produkti tjetër të kërkuar nga klienti brenda 10 ditëve pune nga dita e prezantimit nga ana e konsulentit".

Ndikimi: Mangësi në zbatimin e kontratës të konsulencës.

Shkaku Mungesa e njohurive të preventivuesit si dhe kryerja formale e detyrave nga ana e personit të ngarkuar për monitorimit të kontratës.

Rëndësia: E lartë.

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve të personave me kualifikimet, njohuritë, angazhimin dhe nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi BOE R... & A... si dhe Koordinatori i kontratës znj. D. K. si dhe Koordinatori i Përgjithshëm i Projektit znj. E. H..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3892 prot., datë 12.11.2021, administruar në KLSH me nr. 579/33 prot., datë 12.11.2021.

Pretendimet e subjektit të audituar:
"Së pari përgjegjësia e projektuesit, lidhur me hartimin e strukturave të kostos rezulton e paarsyetuar, në respekt e në zbatim të neni 100/c të K.Pr.Admnitrative ku thuhet se: Akti adminitrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast ..."
Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:
Pretendimet Tuaja në lidhje me rritjen e vlerës së preventivit në zbatim të kontratës me objekt *"Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin pediatrik ekzistues"*, nuk merren në konideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të paraqitura nga ana e subjektit të audituar në observacionet e dërguara për Aktet e Konstatimit.
Grupi i auditimit merr në konsideratë pjesërisht observacionin, konkretisht citimet e bëra nga ana e audituesve shtetërorë në lidhje me ndikimin e rritjes së vlerës së preventivit pas argumenteve të sjella duke bërë edhe ndryshimet përkatëse përgjatë materialit.

2.5.2 Mbi zbatimin e kontratës *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"*

2. Titulli i gjetjes: Përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomiciteti i fondeve si rrjedhojë e likuidimeve si zëra të veçantë të disa zërave të preventivit të cilët janë të përfshirë tek *Shpenzimet e Plotësuese*.

Situata: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *".... & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës

1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 ú me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Kontrata është lidhur mes palëve dhe konkretisht, znj. O. M., Ministër i MSHMS, në rolin e punëdhënësit dhe z. A. M. Administrator i *"...."* ShPK, në rolin e përfaqësuesit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë. Supervizimi i punimeve është kryer nga BOE *"R... & A..."*, për të cilin kontrata e konsulencës si më sipër, ka pasur të parashikuar edhe këtë lloj shërbimi. Sipas Urdhrit të Ministrit me nr. 3629/13 prot., datë 02.10.2019 është bërë caktimi i inxhinierëve të Kontratës *'Për punime civile për rehabilitimin e Spitalit Pediatrik (QSUT)'* znj. V. H. dhe z. A. H.. Deri në përfundim të punës audituese në terren u konstatuar se nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë dorëzuar në total 4 pagesa pjesore (IPC) si më poshtë:

Tabela nr. 37

Nr. IPC	Data e realizimit nga ana e kontraktorit	Data e miratimit nga ana e konsulentit	Shuma (lekë me TVSH)
1	20.08.2020	08.09.2020	172,989,928.32
2	23.10.2020	10.11.2020	128,342,844.72
3	27.11.2020	24.12.2020	179,277,501.00
4	15.03.2021	14.06.2021	256,538,541.42
Shuma Progresive			**733,789,828.26**

Pra në total rezulton e situacionuar vlera prej 733,789,828.26 lekë me TVSH, ose 66.8 % e vlerës totale të kontratës. Punimet e situacionuara lidhen me ato që i takojnë ndërtimit të shtesës anësore pasi punimet për rikonstruksionin e godinës ekzistuese nuk kanë filluar akoma për shkak të ndryshimeve të nevojshme që kanë lindur për projektin prej tërmetit të vitit 2019. Nga analiza e preventivit të punimeve si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve (BOE) rezultojnë disa problematika në lidhje me zërat e përfshirë:

1. Me situacionin pjesor nr. 1 është likuiduar tek kategoria *Shtesë anësore e godinës*, nën/kategoria *Prishje dhe gërmime*, zërat:

- *Ngritje, mobilim dhe kompletim me pajisje, mirëmbajtje, furnizim me tërë komponentët e nevojshëm dhe çmontim e zyrave te menaxhimit te kantierit. Këto zyra duhet të kenë ambiente të mjaftueshme pune për kontraktorin, supervizorin dhe investitorin. Në këto ambiente përfshihet edhe një hapësirë e mjaftueshme për ruajtjen në kushte të përshtatshme të mostrave dhe kampioneve që do të merren për provë apo testim gjatë kryerjes së punimeve* – 1 x 500,000 lekë = 500,000 lekë;
- *F.V. Të dy tabelave informuese për projektin+ bazamentin përkatës +çmontim në përfundim të punimeve. Gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve kontratave kontraktori obligohet që të marrë të gjitha masat për rregullimin e komunikacionit, sigurisë në kantier dhe sigurisë së mjeteve dhe këmbësorëve* – 1 x 250,000 lekë = 250,000 lekë;
- *F.V. Rrethim i përkohshëm me llamarinë të valëzuar + aksesoret. Rrethimi do bëhet me zona sipas plan organizimit të punimeve. Në çmim përfshihet, furnizimi dhe vendosja e llamarinës, menaxhimi i hyrje daljeve në kantier, sigurimi i lëvizjes së këmbësorëve gjatë ndërtimit, heqja e rrethimit, pastrimi i zonës në përfundim të punimeve. Çdo dëmtim i rrethimit nga banorët apo mjetet do të zëvendësohet nga kontraktori pa kosto shtesë* – 700 x 1,500 lekë = 1,050,000 lekë;

Në total rezulton se janë likuiduar për këto tre zëra shuma prej 1,800,000

lekë pa TVSH. Në fakt, referuar metodologjisë së ndjekur nga ana e hartuesve të Projekt ï preventivit e cila i është referuar strukturës së kostos me nën-zërat *Punëtori*, *Transport*, *Makineri* dhe *Materiale*, kontratës së lidhur mes MSHMS dhe Projektuesit, nenit 12 citon se ligji udhëheqës i kontratës do të jetë ai shqiptar. Për rrjedhoje shuma e mësipërme përbën përdorim pa efektivitet eficniencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit pasi punimet për zërat e mësipërm janë të përfshira në realizimin e punimeve të ndërtimit (shpenzimet plotësuese) dhe si të tilla nuk mund të likuidohen si zëra më vete.

Kriteri: Udhëzimi nr. 2 datë 08.05.2002 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme*, përcaktohet se:

"Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen:

3. Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidodë, ndihmë e shpejtë etj;

4. Shpenzimet e ndryshme për marketing, udhëtime e dieta, kancelari, ndriçim, telefoni, postë, autovetura, mjetet e furnizimit, të parkimit e magazinimit etj., si dhe interesat, siguracionet, taksat etj.;

5. Shpenzimet periodike për punimet gjeotopografike gjatë ndërtimit, për provat e materialeve, prodhimeve e konstruksioneve, si dhe gjatë marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të punimeve etj.;

6. Shpenzimet për marrjen me qira të ndërtesave të ndryshme dhe për ndërtime të përkohshme për zyra, magazina, nyje llaç-betoni e hekur-betoni etj., rrugët e vinç-kullave, ndriçimi i territorit, linjat e furnizimit me energji elektrike, telefoni, ujësjellës, kanalizime, si dhe sheshe e rrugë, brenda e jashtë sheshit të ndërtimit etj.;

7. Shpenzimet e paparashikuara në zërat e punës dhe në shpenzimet e drejtpërdrejta: zgjedhja e kampioneve, të rifiniturave, lagia, mirëmbajtja dhe mbrojtja e punimeve nga shiu e ngricat pas kohës normale të punës, pastrimi dhe sistemimi i objektit e sheshit të ndërtimit, para dhe gjatë marrjes në dorëzim etj.;

Kontrata e Zbatimit të Punimeve Specifikimet Teknike, pika 1.3 *ELEMENTËT E PËRFSHIRË TEK ÇMIMET*, paragrafi i katërt citohet se: *Të gjitha kostot e inspektimeve dhe testeve do të mbulohen nga kontraktori.*

Ndikimi: Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomiciteti i fondeve të Projektit në shumën **1,800,000 lekë pa TVSH.**

Shkaku Mungesa e njohurive të stafit të BOE, konsulentit dhe grupit të monitorimit të kontratës.

Rëndësia: E lartë.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë, angazhimin dhe nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai rastit në shumën **1,800,000 lekë pa TVSH** nga *".... & U. I. T. S. T. L. S."* në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me objekt

'Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)' të lidhur sipas aktit me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017.

3. Titulli i gjetjes: Përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomiciteti i fondeve si jedhojë e mos respektimit të strukturës së kostos për punimet e montimit.

Situata: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *".... & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 ú me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Kontrata është lidhur mes palëve dhe konkretisht, znj. O. M., Ministër i MSHMS, në rolin e punëdhënësit dhe z. A. M. Administrator i *"...."* ShPK, në rolin e përfaqësuesit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

Nga auditimi rezultoi se për 26 zëra punimesh analizat e kostove për këto zëra janë hartuar si të ishin punime të mirëfillta ndërtimi, kur në fakt këto janë punime të nënkategorisë *Punime të Teknologjisë dhe të Montimit*, nënkategoria *Punime Montimi.* Konkretisht, konstatohet se metodologjia e analizës së kostos nuk është kryer në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator përkatëse pasi:

a. Furnizimi dhe vendosja në vepër e pajisjeve është punim ndërtimi i kategorisë Punime Teknologjike dhe të Montimit, nënkategoria *Punime montimi* dhe si të tilla nuk mund ti nënshtrohen kësaj mënyrë të përllogaritjes së kostos si punime ndërtimi të zakonshme;
b. Vlera e blerjes së pajisjeve nuk mund të përfshihet as tek shpenzimet e drejtpërdrejta dhe as tek shpenzimet e përgjithshme dhe si të tilla, vlerës së furnizimit nuk mund ti shtohet vlera prej 8 % si shpenzim i përgjithshëm dhe as ajo prej 10 % si fitim për sipërmarrësin (që në rastin e kontraktorit është ofruar me 5 %);
c. Referuar udhëzimit të përmendur tek *Kriteri*, në Kreun I, germa A, paragrafi Shpenzimet Për Makineri citon se:

"Shpenzimet për makineri janë shpenzimet për makineritë që përdoren për punimet e ndërtim-montimit kohën e punës, vlerësuar me çmimet orare përkatëse, pa TVSH". Pra me ómakineriô përfshihen ato të cilat përdoren për punët e ndërtim ï montimit dhe jo ato që trupëzohen në vepër.

d. Referuar të njëjtit udhëzim të përmendur më sipër, në Kreun II, germa A, paragrafi pas pikës 7 citon se:

"Vlerësohen punime ndërtimi punimet e mëposhtme, të parashikuara në projektet ndërtimore (përfshire edhe rikonstruksionet, zgjerimet e përshtatjet).....Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat."; *(për më tepër, shiko dy shembujt e dhënë nga Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003)*. Duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se shuma prej 4,018,027 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit.

Kriteri: - Kontrata e shërbimit me objekt *""Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin Pediatrik ekzistues" dhe me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016*, konkretisht Aneksi A Termat e Referencës dhe Qëllimi i

Shërbimeve, pika 3 *Objektivat Specifikë* , nënpika 4, pika 3 *Detyrat e Shërbimit*, nënpika 4 si dhe pika 6, Faza III;

- Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 1, neni 2 dhe neni 3;
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u>

neni 7: *"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"*;

- *VKM nr. 514, date 15.8.2007 "Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar*, pika 10 <u>ku përcaktohet se:</u> *"Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, date 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave"*;

Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, germa A, paragrafi pas pikës 7 <u>ku përcaktohet se</u>:

"Vlerësohen punime ndërtimi punimet e mëposhtme, të parashikuara në projektet ndërtimore (përfshire edhe rikonstruksionet, zgjerimet e përshtatjet).....Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat.";

- Kreu II, *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi*, <u>ku përcaktohet se</u>:

"Janë shpenzimet që nuk mund të llogariten e të vlerësohen me zëra pune, sepse ndryshojnë sipas llojit të ndërtimit, konstruksionit, rifmiturave, kohëzgjatjes së punimeve dhe strukturës organizative të sipërmarrësit etj., por llogariten me përqindje.

Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, që përfshihen në çmimet njësore të zërave të punës, për punimet e ndërtimit dhe punimet teknologjike llogariten me përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta, ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit."

Kreu II *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Fitimi i Sipërmarrësit*, <u>ku përcaktohet se</u>:

"Fitimi për punimet e ndërtim-montimit, që ndryshon sipas llojit, madhësisë dhe kohëzgjatjes së objektit etj., llogaritet ne përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta dhe plotësuese."

(për më tepër, shiko dy shembujt e dhënë nga Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003)

Germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme*, parashikon se:

"Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen:

3. Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidodë, ndihmë e shpejtë etj;

4. Shpenzimet e ndryshme për marketing, udhëtime e dieta, kancelari, ndriçim, telefoni, postë, autovetura, mjetet e furnizimit, të parkimit e magazinimit etj., si dhe interesat, siguracionet, taksat etj.;
5. Shpenzimet periodike për punimet gjeotopografike gjatë ndërtimit, për provat e materialeve, prodhimeve e konstruksioneve, si dhe gjatë marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të punimeve etj.;
6. Shpenzimet për marrjen me qira të ndërtesave të ndryshme dhe për ndërtime të përkohshme për zyra, magazina, nyje llaç-betoni e hekur-betoni etj., rrugët e vinç-kullave, ndriçimi i territorit, linjat e furnizimit me energji elektrike, telefoni, ujësjellës, kanalizime, si dhe sheshe e rrugë, brenda e jashtë sheshit të ndërtimit etj.;
7. Shpenzimet e paparashikuara në zërat e punës dhe në shpenzimet e drejtpërdrejta: zgjedhja e kampioneve, të rifiniturave, lagia, mirëmbajtja dhe mbrojtja e punimeve nga shiu e ngricat pas kohës normale të punës, pastrimi dhe sistemimi i objektit e sheshit të ndërtimit, para dhe gjatë marrjes në dorëzim etj.;

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>*ku përcaktohet se*</u>:

"3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.
3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit";

- Urdhri nr. 670, me nr. 3629/13 prot., datë 02.10.2019 sipas të cilit janë emëruar inxhinier të kontratës së punimeve;

Ndikimi: Përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomiciteti i fondeve në shumën **4,018,027 lekë pa TVSH.**

Shkaku Mungesa e njohurive të stafit të BOE, konsulentit dhe grupit të monitorimit të kontratës.

Rëndësia: E lartë.

3.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë, angazhimin dhe nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai

rastit në shumën **4,018,027 lekë pa TVSH** nga *"…. & U. I. T. S. T. L. S."* në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me objekt *'Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)'* të lidhur sipas aktit me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017.

4. Titulli i gjetjes: Çmime të ofertuara me një analizë kostoje në kundërshtim me kuadrin rregullator përkatës.

Situata: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *"…. & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 ú me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Kontrata është lidhur mes palëve dhe konkretisht, znj. O. M., Ministër i MSHMS, në rolin e punëdhënësit dhe z. A. M. Administrator i *"…."* ShPK, në rolin e përfaqësuesit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë. Punimet për rikonstruksionin e godinës nuk kanë filluar akoma për shkak të ndryshimeve të nevojshme që kanë lindur për projektin prej tërmetit të vitit 2019. Në mënyrë të ngjashme me konstatimin e përshkruar si më sipër, i njëjti gabim në strukturën e kostos është kryer edhe për zërat e ofertuar për punimet e godinës ekzistuese, sikurse edhe për ato të godinës shtesë. Konkretisht, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e BOE, edhe për punimet e rikonstruksionit të godinës ekzistuese, për ato raste që është paraqitur analiza teknike e çmimeve, problematika e metodologjisë së hartimit të strukturës së kostos dhe ato për punimet për ngritjen e kantierit, tabelën informuese dhe rrethimin e përkohshëm janë të njëjta me ato të përshkruara si më sipër për punimet e ndërtimit të shtesës anësore.

Duke bërë llogaritjet, rezulton se janë kontraktuar punime në shumën 1,200,000 lekë pa TVSH për punimet e ngritjes së kantierit, vendosjes së tabelës dhe punimeve të rrethimit si dhe shuma prej 14,634,264 lekë pa TVSH për punime të ndryshme, vlera totale e të cilave është në masën **15,834,264 lekë pa TVSH**, shumë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit si rrjedhojë e mos respektimit të strukturës së kostos për disa prej zërave të preventivit.

Kriteri: - Kontrata e shërbimit me objekt *""Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin Pediatrik ekzistues" dhe me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016*, konkretisht Aneksi A Termat e Referencës dhe Qëllimi i Shërbimeve, pika 3 *Objektivat Specifikë* , nënpika 4, pika 3 *Detyrat e Shërbimit*, nënpika 4 si dhe pika 6, Faza III;

- Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 1, neni 2 dhe neni 3;

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u>

neni 7: *"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"*;

- *VKM nr. 514, date 15.8.2007 "Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar*, pika 10 *ku përcaktohet se: "Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, date 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave"*;

Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, germa A, paragrafi pas pikës 7 *ku përcaktohet se*:

"Vlerësohen punime ndërtimi punimet e mëposhtme, të parashikuara në projektet ndërtimore (përfshire edhe rikonstruksionet, zgjerimet e përshtatjet).....Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat.";

- Kreu II, *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi*, *ku përcaktohet se*:

"Janë shpenzimet që nuk mund të llogariten e të vlerësohen me zëra pune, sepse ndryshojnë sipas llojit të ndërtimit, konstruksionit, rifmiturave, kohëzgjatjes së punimeve dhe strukturës organizative të sipërmarrësit etj., por llogariten me përqindje.

Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, që përfshihen në çmimet njësore të zërave të punës, për punimet e ndërtimit dhe punimet teknologjike llogariten me përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta, ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit."

Kreu II *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Fitimi i Sipërmarrësit*, *ku përcaktohet se*:

"Fitimi për punimet e ndërtim-montimit, që ndryshon sipas llojit, madhësisë dhe kohëzgjatjes së objektit etj., llogaritet ne përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta dhe plotësuese."

(për më tepër, shiko dy shembujt e dhënë nga Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003)

Germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme*, parashikon se:

"Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen:

3. Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidodë, ndihmë e shpejtë etj;

4. Shpenzimet e ndryshme për marketing, udhëtime e dieta, kancelari, ndriçim, telefoni, postë, autovetura, mjetet e furnizimit, të parkimit e magazinimit etj., si dhe interesat, siguracionet, taksat etj.;

5. Shpenzimet periodike për punimet gjeotopografike gjatë ndërtimit, për provat e materialeve, prodhimeve e konstruksioneve, si dhe gjatë marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të punimeve etj.;

6. Shpenzimet për marrjen me qira të ndërtesave të ndryshme dhe për ndërtime të përkohshme për zyra, magazina, nyje llaç-betoni e hekur-betoni etj., rrugët e vinç-kullave, ndriçimi i territorit, linjat e furnizimit me energji elektrike, telefoni, ujësjellës, kanalizime, si dhe sheshe e rrugë,

brenda e jashtë sheshit të ndërtimit etj.;
7. Shpenzimet e paparashikuara në zërat e punës dhe në shpenzimet e drejtpërdrejta: zgjedhja e kampioneve, të rifiniturave, lagia, mirëmbajtja dhe mbrojtja e punimeve nga shiu e ngricat pas kohës normale të punës, pastrimi dhe sistemimi i objektit e sheshit të ndërtimit, para dhe gjatë marrjes në dorëzim etj.;
- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 *ku përcaktohet se*:
"3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.
3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit";
- Urdhri nr. 670, me nr. 3629/13 prot., datë 02.10.2019 sipas të cilit janë emëruar inxhinier të kontratës së punimeve;

Ndikimi: Përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomicitet i fondeve të Projektit në shumën **15,834,264 lekë pa TVSH**.

Shkaku Mungesa e njohurive të stafit të BOE, konsulentit dhe grupit të monitorimit të kontratës.

Rëndësia: E lartë.

4.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë, angazhimin dhe nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai rastit në shumën **15,834,264 lekë pa TVSH** nga *".... & U. I. T. S. T. L. S."* në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me objekt *'Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)'* të lidhur sipas aktit me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017.

Grupi i auditimit merr në konsideratë pjesërisht observacionin nr. 3892 prot., datë 12.11.2021, administruar në KLSH me nr. 579/33 prot., datë 12.11.2021 në lidhje me argumentet e dhëna duke bërë edhe ndryshimet përkatëse përgjatë materialit.
Grupi i auditimit merr në konsideratë observacionin nr. 475 prot., datë 16.11.2021, administruar në KLSH me nr. 579/36 prot., datë 16.11.2021 në lidhje me argumentet e dhëna

për specifikimet teknike të zërave me nr. 4.4.162 dhe 4.4.164 pas saktësimit të dhënë nga ana e furnitorit të produkteve.

2.5.3 Mbi zbatimin e kontratës *"Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"*

5. Titulli i gjetjes: Miratim i ndryshimit të stafit teknik është kryer pasi ky staf ka operuar në kantier gjatë zbatimit të punimeve.

Situata: Projekti për objektin *"Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"*, është hartuar nga ana e OE *A...*, në zbatim të kontratës për shërbime konsulence me objekt *"Vlerësim teknik, hartim projektesh civile, specifikime teknike, përllogaritje kostoje për Rikonstruksionin e një prej ndërtesave ekzistuese në Spitalin Pediatrik (objekti ekzistues Nr.2) në QSUT, Godinës së Kardiokirurgjisë (Angiologji) në QSUT – Tiranë dhe Spitalit Krujë dhe Spitalit Laç"* sipas aktit me nr. 236/3 prot., datë 16.01.2020. dhe me nr. reference HSIP/CS/SSS/07-2019. Për supervizimin e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit sipas aktit me nr. 140/5 prot., datë 28.01.2021 me nr. reference HSIP/CS//CQ/02-2020 mes MSHMS dhe A... me vlerë të kontratës 45,000 Euro me TVSH. Aktualisht në lidhje me kontratën e konsulencës nuk është paraqitur asnjë kërkesë për pagesë. Në përfundim të procedurës së prokurimit të punimeve është shpallur fitues BOE *'C... N... C... P... L... "C. M."* me të cilin është lidhur kontrata me nr. 25/6 prot., datë 29.01.2021 me vlerë të kontratës 349,210,674 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të kontratës 4 muaj nga data e fillimit të punimeve. Aktualisht, deri në momentin e hartimit të këtij akt konstatimi nuk është paraqitur për miratim të palëve asnjë situacion pjesor. Sipas shkresës me nr. 140/8 prot., datë 01.06.2021 të përfaqësuesit të MSHMS z. B. M. drejtuar Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit znj. E. H., është kërkuar aprovimi i ndryshimit të stafit teknik dhe shtyrje afati të përfundimit të punimeve. Sipas shkresës me nr. 140/9 prot., datë 01.06.2021 të Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit znj. E. H., është autorizuar zëvendësimi i stafit teknik për shtyrjen e afatit të përfundimit të kontratës duke ngarkuar kështu zyrën e Njësinë e Koordinimit të Projektit të kryejë procedurat për amendimin e Kontratës. Në vijim sipas shkresës me nr. 25/27 prot., datë 08.06.2021 është amenduar kontrata *"Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"* në lidhje me dy çështje:

1. Zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve nga 4 muaj në 5.5 muaj;
2. Ndryshimin e personelit të kontraktorit si më poshtë:

J. B. (Menaxher Projekti)
I. B. (Menaxher Terreni);
A. L. (Inxhinier Ndërtimi në Terren;
A. M. (Inxhinier Mekanik Terreni);
M. K. (Topograf Terreni);
K. M. (Koordinator Sigurie Terreni);
E. K. (Menaxher i Përgjithshëm);
A. L. (Menaxher i Përgjithshëm);
L. N. (Menaxher i Përgjithshëm);

Nga sa më sipër rezulton se në asnjë rast të vetëm nuk dokumentohet të kenë qenë prezent në terren stafi teknik kryesor i sipërmarrësit me ata punonjës për të cilët ai është shpallur. Konkretisht nuk dokumentohet

prezenca në kantier e z. S. P. me pozicion Menaxher Projekti, z. P. Z. me pozicion Menaxher terreni dhe z. R. T. me pozicion Inxhinier Ndërtimi Terreni. Në kushte të tilla stafi teknik ka punuar pa marrë ende miratimin nga ana e konsulentit, menaxherit të kontratës të emëruar nga ana e MSHMS dhe vet Autoritetit Kontraktor MSHMS. Sipas amendamentit të kontratës punimet duhet të kishin përfunduar me datë 20.07.2021 kur në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, stafit të Zyrës së Koordinimit të Projektit dhe supervizorit të punimeve rezultoi se punimet ishin ende në fazat fillestare të saj. Konkretisht rezultoi se ishin në proces punimet për konstruksionin metalik dhe rezultuan të përfunduara punimet fillestare të saj vlera e të cilave është jo më shumë se 85,332,690 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përbën më pak se 30 % të vlerës se punimeve (pa TVSH dhe pa fond rezervë). Aktualisht rezulton se kontrata është në procedurat e miratimit të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve.

Kriteri: Kontrata e sipërmarrjes së punimeve e lidhur me BOE *'C... N... C... P... L... "C. M* me nr. 25/6 prot., datë 29.01.202, pika 9.9.1 e kushteve të përgjithshme ku *<u>përcaktohet se</u>*: *'Kontraktori duhet të punësojë stafin kryesor dhe të përdor pajisjet e identifikuara në ofertën e tij dhe çdo personel apo pajisje të aprovuar nga projekt menaxheri, për të realizuar punimet. Menaxheri i Projektit duhet të aprovojë çdo zëvendësim të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet dhe karakteristikat e tyre janë në thelb të njëjta apo më të mira se ato të propozuara në ofertë'*.

Ndikimi: Mungesa e stafit teknik të sipërmarrësit të punimeve për të cilës ai është shpallur fitues dhe zëvendësimi i tyre me personel të pa miratuar paraprakisht nuk siguron mirë përdorimin e fondeve të projektit. Gjithashtu, zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve rrit kostot e projektit.

Shkaku Veprimet dhe mosveprimet e konsulentit.

Rëndësia: E mesme.

5.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS dhe strukturave të ngritura për monitorimin e kontratave të merren masa për miratimet në kohë të ndryshime të kontratave me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve të Projekteve me financime dhe huaja.

5.2 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për identifikimin e saktë të nevojave për realizimin e kohës të investimeve, duke marrë në konsideratë edhe situatat e veçanta siç ishte rasti i pandemisë së COVID 19, kjo me qëllim shmangien e afateve të shkurtra kohore të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në kriteret e vendosura në procedurat e prokurimit për këto investime.

2.5.4. Zbatimi i kontratës *"F.V. Rezonanca magnetike (MRI) për spitalin e Elbasanit"*

Kontrata me nr. Ref. HSIP / ICB / 01-2016 - Loti 5 ñF.V. Rezonanca magnetike (MRI)ò, është nënshkruar më datë 30.01.2018 midis MSHMS dhe P. M. S. N. B. për furnizimin dhe instalimin e një rezonance magnetike (MRI). Njoftimi fituesit është publikuar në faqen e MSHMS dhe në UNDB Online. Amendamentet e mëposhtme janë realizuar gjatë periudhës së zbatimit: Amendamenti nr. 1 datë 08.06.2018 u nënshkrua në mënyrë që të përfshijë regjistrimin e pajisjeve mjekësore si kusht për lëshimin e Letrës së Pranimit (sipas urdhrit nr. 360 datë 22.08.2016 ñMbi procedurat dhe rregullat për regjistrimin e pajisjeve mjekësore, ndryshimet dhe anulimin e regjistrimit te tyre, dokumentacionin e nevojshëm dhe kostot

përkatëseò të Ministrit të MSHMS). Amendamenti nr. 2 datë 30.08.2018 u nënshkrua në mënyrë që të pasqyrojë ndryshimin e vendit të origjinës së Rezonancës Magnetike nga Kina në Holandë.
Amendamenti nr. 3 datë 18.09.2018 u nënshkrua në mënyrë që të zgjaste periudhën e dorëzimit të mallrave dhe zgjatjen e datës së përfundimit të kontratës në 20.12.2018; (ku u përcaktua data e dorëzimit është 44 javë ose data 20.12.2018). Amendamenti nr. 4 datë 19.11.2018 është nënshkruar me qëllim që të lejojë kompaninë të regjistrojë pajisjet mjekësore në Shqipëri përmes një përfaqësuesi lokal pasi ligji shqiptar nuk lejon që Furnizuesit e huaj të regjistrojnë pajisjet mjekësore direkt.
*Detyrat e ekipit te menaxhimit t*ë *kontratës.*
Me urdhrin nr. 806 datë 20.11.2018 është ngritur ekipi i menaxhimit të kontratës i përbërë nga: znj. F. B., z. O. A., znj. L. P., znj. V. Xh. dhe z. F. S., Ekipi i menaxhimit të kontratës do të:

a. Menaxhojë, monitorojë dhe koordinojë zbatimin e kontratës;
b. Bashkëpunojë me furnizuesin për të kryer procedurat e zhdoganimit të pajisjeve;
c. Kryejë procedurat zyrtare të marrjes në dorëzim të pajisjeve, duke konfirmuar markën, parametrat teknik dhe sasitë, referuar kontratës, nëpërmjet lëshimit të ñAktit të marrjes në dorëzim të pajisjeveò;
d. Jetë prezent në testimin e pajisjeve dhe të konfirmoj në mënyrë zyrtare instalimin dhe funksionimin normal të pajisjeve sipas parametrave dhe specifikimeve teknike pjese të kontratës;
e. Autorizojë ekzekutimin e pagesave përkatëse sipas kontratës, kundrejt dorëzimit të ñletrës së testimit dhe pranimit të pajisjeveò, shoqëruar këto me pamje/foto të pajisjeve në vendin ku janë instaluar.

Pagesat e realizuar për MRI
Me fletë Hyrje nr. 13/1 datë 19.11.2018 është bërë hyrje në magazinën e SRE, rezonanca Philips Multiva 1.5T, me vlerë totale 77,212,920 lekë. Kompania ñP... M... S... N... B...ò ka dorëzuar Faturën e shitjes më datë 06.11.2018, me nr. 7203144054 në shumën totale 515,000 euro. Pajisja MRI Multiva 1.5T, klasa e pajisjes IIa është regjistruar dhe ka marrë certifikatë regjistrimi me nr. 4454 pranë AKBPM, më datë 03.06.2019 nëpërmjet subjektit ñH... & L...ò shpk. Pagesa e parë për ñP... M... S... N... B.Vò është bërë me letër Kredi LC në shumën 412,000 euro, më datë 12.12.2018, shumë e cila përfaqëson 80 % të vlerës së kontratës. Me USH nr. 69 datë 09.10.2019 është bërë pagesa e mbetur 20 % e kontratës në shumën 103,000 euro.
Garancia e MRI:
MRI Multiva 1.5T mbulohej me një garanci për 24 muaj sipas përcaktimeve të klauzolës GCC 28.1 të kushteve të veçanta të kontratës.

2.5.5. Mbi zbatimi i kontratës *"Furnizimi dhe instalimi i softit të sistemit të menaxhimit financiar në 420 qendra të kujdesit parësor"*
Kontrata nr. 2580/10 datë 23.10.2017 ñFurnizimi dhe instalimi i softit të sistemit të menaxhimit financiar në 420 qendra të kujdesit parësorò është nënshkruar midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Joint Venture ñI... & B... ò
Pagesat e kontratës janë të ndara si më poshtë:

1-	Furnizim dhe Instalim	-	30,400,000	Lekë
2-	Kosto mirëmbajtje (për 4 vite)	-	7,600,000	Lekë
TOTAL:			38,000,000	Lekë (pa TVSH)

Nëpërmjet Amendamentit nr. 2 me nr. 1268 prot. datë 16.02.2018 është caktuar ekipi i menaxhimit të kontratës ñFV i softit të SMF në 420 QSHò i përbërë nga: Z. E. C., znj. L. H. dhe E. Q..

Nëpërmjet amendamentit nr. 3 (nr. 1268/1 prot. date 23.05.2018) për modifikimin e urdhrit për caktimin e Ekipit të Menaxhimit të kontratës ñ Furnizimi dhe instalimi i Softit të Sistemit të menaxhimit financiar në 420 Qendra të Kujdesit Parësorò nr. 238/3, date 16.10.2017, të Amendamentit nr. 1., datë 12.11.2017, të Urdhrit nr.238/3 datë 16.10.2017 dhe Amendamentit nr.2 datë 16.02.2018 është bërë ndryshim në ekipin e menaxhimit të kontratës ñFV i softit të SMF në 420 QSHò me përbërjen e mëposhtme: Z. I. Th., znj. E. Q. dhe z. E. H.

Ekipi i menaxhimit të kontratës ka për detyre:

-Koordinimin e zbatimit të kontratës

-Pranimin e produkteve bazuar në raportet e konsulentit të supervizimit të kontratës z. A. M.

-Të bashkëpunojnë me furnizuesin për të realizuar të gjitha aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve si trajnime etj., të cilat janë parashikuar në kontratë.

-Të kryej procedurat zyrtare në lidhje me përfundimin e kontratës e cila certifikohet nëpërmjet raportit final të konsulentit A. M., i cili do të firmosë certifikatën e instalimit si dhe vënies në punë të sistemit sipas kërkesave specifike të kontratës dhe termave të referencës të hartuara prej tij.

Plan Projekti i datës 30.05.2018 nga I...

Me shkresën nr. 179/12 datë 30.05.2018 përfaqësuesi i I..., ka dorëzuar në MSHMS ñPlan Projektin-30.05.2018ò sipas përcaktimeve të kontratës nr.2580/10 datë 23.10.2017.

Qëllimi: Sistemi i menaxhimit financiar do të shërbej për menaxhimin e procesit të planifikimit, miratimin dhe ekzekutimit të buxhetit financiar të alokuara nga FDSKSH për Drejtorit Rajonale të Fondit dhe Qendrave Shëndetësore.

Objektivat kryesor: Efektiviteti, Digjitalizimi, strukturimi i të dhënave, administrimi, reduktim i kostove menaxheriale, etj.

Mundësitë që ofron Sistemi i menaxhimit financiar

Planifikimi i Buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre

Miratimi i buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre

Detajimi i buxhetit vetjak nga QSH dhe miratimi i tij nga Drejtoria Rajonale.

Shpërndarja e buxhetit nga ana e QSH

Ekzekutimi i buxhetit ne nivel Qendre Shëndetësore

Regjistrimi i transaksioneve kontabël ne çdo QSH

Raportimi ne nivel Fondi, DRF dhe QSH. Raportet janë për çdo modul, ne nivel përmbledhës dhe analitik.

Trajnimi i përdoruesve të sistemit

Bazuar në plan veprimin e datës 30.05.2018 të I... pika 8.6 faza 5-trajnimi i përdoruesve, parashikohet, e citoj:

Të gjithë përdoruesit që do të punojnë me sistemin do të trajnohen rreth funksionaliteteve të sistemit dhe si të punojnë me të. Materialet e trajnimit do të përdoren për të trajnuar të gjithë përdoruesit e sistemit. Materialet e trajnimit do të përfshijnë një përshkrim të detajuar të çdo procesi që do të zhvillohet në sistem. Këto materiale do të përshkruajnë funksionet e sistemit dhe sesi sistemi do të implementohet. Materialet do të përmbajnë figura për të ilustruar më mire ambientin e punës.

Me tej, në plan veprimin janë parashikuar fazat dhe metodologjia e realizimit të trajnimeve, të përshkruara më poshtë:

Para kushtet; Dokumentimi i trajnimit të aktorit kryesor; Metodologjia e trajnimit

Trajnimi në grup - Trajnimi në grup do të zhvillohet pas fazës së testimeve. Trajnimi konsiston në regjistrimin e të dhënave reale në sistem. Trajnimi do të zhvillohet në grupe, të ndara sipas rajoneve. Organizimi i trajnimit do të zhvillohet mbi bazën e funksioneve që do të kenë përdoruesit në sistem. Çdo trajnim do të organizohet mbi bazën e një plani të paracaktuar. Prezenca e pjesëmarrësve duhet të sigurohet, në varësi të skedulit përkatës.

Trajnimi individual - Trajnimi individual do të zhvillohet pas trajnimit në grup. Trajnimi konsiston në regjistrimin e të dhënave reale në sistem. Çdo pjesëmarrës do të trajnohet për pozicionin dhe rolin e tij në sistem. Trajnimi do të zhvillohet në vendin e punës së pjesëmarrësve, ndërsa suporti ose ndihma do të sigurohet me anë të programit online Team Viewer.
Metoda e trajnimit do të jetë "mësimi gjatë punës", ku përdoruesit do të njihen me proceset që do të regjistrojnë në sistem dhe do të njihen me situata të ndryshme.
Përdoruesi do të pajiset me materialet e trajnimit, sipas pozicionit dhe rolit që kanë në sistem.
Kërkesa dhe kushte (parakushte)
Aplikacioni i instaluar duhet të aksesohet në të gjithë ambientet që do të kryhen trajnimet. Trajnimi do të organizohet: **Trajnim individual dhe trajnim në grup**.
Për trajnimin në grup është e rëndësishme prezenca e gjithë punonjësve të qendrave shëndetësore, të cilët do të punojnë me sistemin.
Miratimi i planit të zbatimit të projektit
Në zbatim në klauzolës 19 të kontratës me nr. 2580/10 prot., datë 23.10.2017, ekipi i menaxhimit të kontratës (E. Q., E. H. dhe I. Th.) ka miratuar planin e zbatimit të projektit me shkresën nr. 3646 prot. datë 05.06.2018 me objekt ñProces Verbal mbi pranimin e Planit të zbatimit të Projektit-Furnizimi dhe instalimi i Softit të SMF në 420 Qendra të Kujdesit Shëndetësorò. Gjithashtu është përcaktuar që monitorimi dhe menaxhimi i kontratës do të mbështetet në supervizimin e realizimit të projektit nga konsulenti supervizues z. A. M., supervizimi i tij do të behet mbi bazën e planit të miratuar të datës 29.05.2018
Plani i verifikimit dhe Vlerësimit te sistemit te menaxhimit financiar.
Në vazhdim të procedurës dhe kushteve të kontratës, konsulenti A.M. nëpërmjet shkresës nr.250/9 datë 14.06.2018, i ka përcjell ekipit të menaxhimit të kontratës ñPlanin e verifikimit dhe vlerësimit për Software të sistemit të menaxhimit financiar në 420 QSHò, i cili përmban një plan të verifikimit dhe miratimit për kontratën ñFV të programit të menaxhimit financiar në 420 QSHò.
Plani i verifikimit dhe vlerësimit të SMF përshkruan:
Aktivitetin, personelin, orarin, standardet dhe metodologjinë për kryerjen e verifikimeve dhe vlerësimeve të pavarura të zbatimit të sistemit sipas specifikimeve teknike të përcaktuar në kontratë, dhe vlerësimin e plotë të sistemit pas instalimit dhe testimit, lëshimit zyrtar të ñCertifikimit te instalimitò dhe ñcertifikimit të pranimitò, sipas standardeve të përgatitura nga MSHMS.
Miratimi nga koordinatori i kontratës
Raporti i përgatitur nga supervizori i kontratës z. A. M. është miratuar nga koordinatori i kontratës z. E. C. me shkresën nr.179/39 prot date 19.10.2018 me objekt ñProces verbal mbi pranimin e raportit për fazën e trajnimit të stafit dhe sistemit roll outò
- Përfaqësuesi ligjor i I... njofton ekipin e menaxhimit të kontrate nëpërmjet shkresës nr.179/38 prot. datë 16.10.2018 për nisjen e fazës Go live & Operational Acceptance duke informuar që kjo faze do të përfundoj më datë 22.10.2018.
-Me shkresën nr. 250/28 datë 17.10.2018 konsulenti z. A. M. ka miratuar raportin e trajnimeve të përdoruesve të sistemit nga ana e I... të datës 15.10.2018. Raporti i trajnimeve dhe materialeve të tjera shoqëruese si: Listat e pjesëmarrësve, testimet e pjesëmarrësve, fotografit gjatë seancave të trajnimit pranë DRF.
Me shkresën 250/36 prot. datë 30.10.2018 koordinatori i kontratës z. E. C. ka miratuar raportin përfundimtar të projektit të dorëzuar nga konsulenti.
Miratimi i raportit përfundimtar
Nëpërmjet Proces verbalit nr.3646/12 datë 30.10.2018, ekipi i menaxhimit të kontratës (I. Th., E. Q. dhe E. H.) në referim:

1. Të kontratës HSIP/NCB/01-2017, nr. 2580/10 prot., datë 23.10.2017 me objekt ñFurnizimi dhe instalimi i Softit të menaxhimit financiar në 420 QSHò
2. Të Urdhrit të ministrit nr. 238/3 date 16.10.2017, amenduar me urdhrin nr. 238/4 datë 02.01.2017, nr.164 date 16.02.2018, nr.411 date 23.05.2017 për caktimin e grupit të menaxhimit të kontratës.
3. Të raporteve të datës 22/10/2018 mbi progres raportin mujor për muajin Tetor, dhe atij të ñMonthly Log of Service Calls ñ dhe të ñInspection and Quality Assuranceò hartuar nga I...
4. Të raportit të datës 22.10.2018, për përfundimin e projektit dhe fazës ñGo Liveò hartuar nga I...
5. Të raportit të datës 22.10.2018, për ñOperacional Acceptance Testingò hartuar nga I...
6. Të raportit të datës 24.10.2018, për monitorimin mujor të hartuar nga konsulenti supervizues.
7. Të certifikatës së verifikimit dhe validimit datë 24.10.2018, hartuar nga konsulenti supervizues.
8. Të raportit të datës 24.10.2018 për verifikimin dhe validimin e raportrit për përfundimin e projektit dhe fazës ñGo Liveò te hartuar nga konsulenti supervizues.
9. Të raportit të datës 24.10.2018 për verifikimin dhe validimin të raportit për Operational Acceptance testing, të hartuar nga konsulenti supervizues z. A. M..
Për sa më lart, ekipi i menaxhimit të kontratës në PV e sipërcituar ka konfirmuar dhe miratuar raportin përfundimtar të projektit dhe fazës Go live si dhe raportin për Operacional Acceptance testing, duke konfirmuar se janë në përputhje me specifikimet, kërkesat teknike dhe kontratën.

Instalimi i sistemit të menaxhimit financiar në 420 QSH në serverin e FSDKSH.
Me shkresën nr. 179/15 date 11.06.2018 ñNjoftimò I... njofton për përfundimin e fazës së instalimit të sistemit më datë 11.06.2018 në zyrat qendrore të FSDKSH. Po në këtë datë është mbajtur PV mbi përfundimin e fazës së instalimit të sistemit.
Softi është dorëzuar dhe është marrë në dorëzim nga FSDKSH me F.H. nr. 353 datë 31.12.2018
Pagesa e sistemit të menaxhimit financiar
Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr.60/1 datë 02.08.2018 ñPagesë kundrejt dorëzimit dhe instalimit të softitò është bërë pagesa për I... në shumën 21,267,840 lekë.
Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit, në praktikën e pagesës gjendet:
-Fatura tatimore me nr. serie: 223916790; Fatura nr. 0839 date 22.06.2018 me përshkrimin:
... Phase 1-Deliver and istallation of financial system ne vlerën totale (me TVSH) 21,267,840 lekë. I... më datë 22.06.2018, në referim te klauzolës GCC 12&22.5 I... ka paraqitur ñKërkesa për pageseò, drejtuar MSHMS, B. D. dhe E. C..
Akt Inspektimi nr. 179/20 Prot. Datë 28.06.2018 nga Koordinatori i kontratës E. C.,
Urdhër Shpenzimi nr. 108 date 31.12.2018 ñPagesë finale faza e IIò në shumën 15,212,160 lekë

Pagesa për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit financiar:
Data e fillimit të mirëmbajtjes dhe rrjedhimisht të pagesës së saj, fillon në datën e lëshimit të Operational Acceptance Certificate, sipas kushteve Specifike të Kontratës GCC, klauzola 29.4, parashikohet se: Periudha e mirëmbajtjes 4 vjeçare fillon nga data e lëshimit te Operational Acceptance Certificate. Grupi i menaxhimit ka lëshuar Operational Acceptance Certificate me nr. 3646/13 më datë 30.10.2018.

Njësia e Koordinimit të Projektit, me USH. Nr.37 date 29.06.2020 me objekt ñPagesë për garanci 11 muaj nëntor 2018 - shtator 2019, ka bërë pagesën për I... për shërbimin e mirëmbajtjes në shumen 2,089,995 lekë.
Nga dokumentacioni i vendosur ne dispozicion nga PCU, nuk rezulton të jetë paraqitur kërkesë për pagesën e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit te menaxhimit financiar nga ana e përfaqësuesit të I... për periudhën pas muajit shtator 2019 e deri më datë 10.08.2021

Funksionaliteti i Sistemit

Për realizimin e pagesës së mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit financiar në 420 QSH, bashkëlidhur Urdhër Shpenzimi nr. 37 datë 29.06.2020 me objekt ñPagesë për garanci 11 muaj Nëntor 2018-Shtator 2019ò në shumën 2,089,995.60 lekë, është dhe shkresa nr. 3371/1 date 22.05.2020, mbi konfirmimin e funksionalitetit të sistemit nga ish Drejtoresha e FDSKSH. (shiko aneksin nr.5 foto nr. 5)
Pra sipas ish Drejtoreshës së FDSKSH, sistemi i menaxhimit financiar në 420 QSH, i cili duhet të shërbej për menaxhimin e procesit të planifikimit, miratimin dhe ekzekutimit të buxhetit financiar të alokuara nga FDSKSH për Drejtorit Rajonale të Fondit dhe Qendrave Shëndetësore, për të realizuar:

1. Planifikimin e Buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre
2. Miratimin e buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre
3. Detajimin e buxhetit vetjak nga QSH dhe miratimi i tij nga Drejtoria Rajonale.
4. Shpërndarjen e buxhetit nga ana e QSH
5. Ekzekutimin e buxhetit ne nivel Qendre Shëndetësore
6. Regjistrimin e transaksioneve kontabël në çdo QSH
7. Raportimin në nivel Fondi, DRF dhe QSH.
8. Raportimin për çdo modul, në nivel përmbledhës dhe analitik.

Pra nga sa ka konfirmuar ish zv. Drejtoresha e FSDKSH, nënkupton që këto objektiva janë realizuar nga sistemi i menaxhimit financiar për të 420 QSH.

Verifikimi i funksionalitetit të sistemit të menaxhimit financiar në 420 QSH.

Në lidhje me zbatimin me sukses të kontratës për sistemin e menaxhimit financiar për 420 QSH, grupi i auditimit bëri verifikime në FSDKSH; DRF Tiranë, QSH nr. 5, 8; DRF Shkodër, QSH nr. 4, QSH nr. 2; DRF Kukës dhe DRF Elbasan. Krahas verifikimit mbi funksionalitetin e sistemit të menaxhimit financiar në QSH dhe DRF e sipërcituara, Grupi i auditimit në zbatim të Autorizimit nr. 579/3 Prot., datë 09.08.2021, të Kryetarit të KLSH për verifikim në serverin e FSDKSH të sistemit të menaxhimit financiar, kryeu verifikim më datë 09.08.2021, në serverin e Fondit, ku është instaluar aplikacioni dhe data baza e tij. Në këtë verifikim pranë FSDKSH, grupi u shoqërua nga specialisti IT i Fondit, z. E. B.. Në akt verifikimin e mbajtur më datë 09.08.2021, u konstatua se:
Aksesimi në Server Mananger administrohet nga kompania I... si për aplikacionin ashtu dhe për databazën. Për shkak se administrimi i serverit bëhet nga I..., grupi i auditimit dhe specialisti i IT i Fondit, nuk mundën të logoheshin për të marrë log-inet e gjeneruara për sistemin e menaxhimit financiar në 420 Qendrat Shëndetësore. Gjithashtu specialisti i IT të FSDKSH, nuk u aksesua dot edhe në nivel user, çka tregon që sistemi i menaxhimit financiar në 420 QSH, **nuk funksionon dhe nuk është i aksesueshëm për përdoruesit e sistemit të kujdesit shëndetësor parësor**.

6.Titulli i gjetjes: Sistemi i Menaxhimit Financiar në 420 Qendrat Shëndetësore nuk funksionon.

Situata: - Sistemi i Menaxhimit Financiar nuk aksesohet.
-Të 420 njësitë e shërbimit parësor nuk përdorin sistemin e menaxhimit financiar, por vazhdojnë të përdorin programin Excel për aktivitetin

ekonomiko financiar.
-Janë shfaqur problematika të ndryshme në lidhje me funksionalitetin e sistemit, kryesisht me ruajtjen e të dhënave dhe kategoritë e buxhetimit të cilat nuk ishin të lidhura me llogaritë respektive, etj.
-Trajnimi i zhvilluar për përdorimin e sistemit të menaxhimit financiar në QSH është i pa mjaftueshëm
-Nga verifikimi i funksionalitetit të sistemit të menaxhimit financiar në FSDKSH, DRF dhe Qendra Shëndetësore rezulton që:
Sistemi i menaxhimit financiar nuk përdoret, nuk aksesohet dhe nuk funksionon për qëllimin që është kontraktuar, si më poshtë:

1. Planifikimin e Buxhetit në nivel Drejtorie dhe Qendre
2. Miratimin e buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre
3. Detajimin e buxhetit vetjak nga QSH dhe miratimi i tij nga Drejtoria Rajonale.
4. Shpërndarja e buxhetit nga ana e QSH.
5. Ekzekutimin e buxhetit në nivel Qendre Shëndetësore
6. Regjistrimin i transaksioneve kontabël në çdo QSH
7. Raportimin në nivel Fondi, DRF dhe QSH, etj.

<u>Nga Auditimi rezulton se:</u>
Aktiviteti ekonomiko financiar në DRF dhe QSH, vazhdon të realizohet si më parë nëpërmjet përdorimit të programit Excel
- Në takimin e grupit të auditimit me Drejtoreshën e DRF Tiranë, më datë 15.07.2021, ekonomistja që ishte caktuar për të punuar me Sistemin e Menaxhimit Financiar konfirmoi që, sistemi nuk punon dhe të gjitha transaksionet financiare i realizonte si më parë, me anë të shkresave dhe programit Excel.
- Po ashtu dhe në takimin më datë 15.07.2021 në QSH nr. 5 dhe nr. 8, specialistet e financës pohuan se Sistemi i Menaxhimit Financiar nuk punon dhe nuk aksesohet. Në të dyja QSH nr. 5 dhe 8 në Tiranë, specialistet e financës vendosen në dispozicion prt.scr që sistemi nuk aksesohej.
-Gjithashtu më datë 15.07.2021, grupi i auditimit, pati dhe një takim me Drejtoreshën ekonomike të FSDKSH, Drejtoreshën e IT dhe një specialist IT, për të marrë informacion mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar në 420 QSH. Të cilët konfirmuan që sistemi i menaxhimit financiar për 420 QSH nuk funksionon prej kohësh.
-Specialisti IT i FSDKSH informoj për arkitekturën e këtij sistemi që është e tipit Client Server dhe i aksesueshëm nëpërmjet
URL: https//:ww.eqsh.fsdksh.com.al.
-Hyrja në Sistemi i Menaxhimit Financiar bëhet duke u loguar me kredencialet (user name; Password) që specialistet e financës së QSH apo të DRF kanë marrë nga administratorët e sistemit të I...
-Sistemi i menaxhimit financiar është hostuar në serverin e FSDKSH me komponentin Web të aplikacionit të instaluar në njërin server dhe bazën e të dhënave të këtij aplikacioni të instaluar në një server tjetër. Për tu thelluar edhe më shumë në verifikimin e funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit Financiar, grupi i auditimit të KLSH verifikoi funksionalitetin edhe në DRF Shkodër dhe 2 QSH të kësaj DRF-je. Nga takimet që patëm me Drejtorin e DRF-së dhe specialistët e financës së qendrave shëndetësore, të gjithë pohuan se trajnimi ka qenë jo efektiv dhe është

zhvilluar vetëm një ditë në ambientet e Tele medicines pranë Spitalit Rajonal Shkodër dhe është zhvilluar on line. Grupi i auditimit morri evidencë dokumentare për problematikat që ishin shfaqur për këtë sistem. Më poshtë pasqyrohet një pjesë e tyre:

1. Me e-mail të datës 06.07.2020 znj. D. L. specialiste finance në QSH nr. 2. Shkodër i është drejtuar support.alfaWeb, e citoj:

..dua të logohem në sistem për të punuar por ka që të shtunën datë 04.07.2020 që nuk hapet sistemi dhe del error siç dhe tregohet bashkëngjitur këtij e mail. Prnt scr i e-mail paraqitur ne aneksin nr. 5.4, foto nr. 2.

2. Me e-mail e datës 25.11.2019 Znj. H. T. me detyrë përgjegjëse e sektorit Financë-administratë në DRF Shkodër drejtuar T. M. për dijeni L. H. duke informuar mbi problematikat në hedhjen e të dhënave në Sistemin e Menaxhimit Financiar., citoj:

...duke u nisur nga kontrolli i Drejtorisë rezulton se asnjëra nga Qendrat Shëndetësore te DRFSDKSH Shkodër nuk ka hedhur akoma të dhëna në sistem. Problematikat e QSH pothuajse janë të njëjta ku kategoritë e buxhetimit nuk janë të lidhura me llogari ose nuk ruhen te dhënat. Ne mënyrë qe te funksionoj sistemi I menaxhimit financiar (Sistemi i Menaxhimit Financiar) te qendrave shëndetësore, kërkojmë nga ana juaj te na mundësohet trajnim online për drejtorinë (financën) dhe QSH (ekonomistët).

Jemi në pritje të një përgjigjeje, pasi kemi problematika me sistemin me të gjitha QSH e DRFSDKSH Shkodër. Prnt scr pasqyrohet në aneksin nr. 5.4 foto nr. 3. Në të gjitha QSH apo DRF respektive që grupi i auditimit bëri verifikim fizik për funksionalitetin e sistemit të menaxhimit financiar në Tiranë, Elbasan, Shkodër dhe Kukës u konstatua se këto njësi nuk aksesoheshin në sistemin e menaxhimit financiar, pasqyruar në prt.scr në Aneksin nr. 5.4 foto nr. 4. Gjatë verifikimit për funksionalitetin e sistemit financiar Drejtori i DRF Kukës na konfirmoi që sistemi nuk funksionon dhe QSH vazhdojnë të operojnë me programin Excel. Gjithashtu dhe në DRF Elbasan dhe QSH të saj rezulton e njëjta situatë. Transaksionet financiare të cilat ishin parashikuar që të realizoheshin me Sistemin e Menaxhimit Financiar në QSH nr. 8 Tiranë, mbahen dhe përpunohen në Excel ñfile në Excelò.

(shiko prnt scr në Aneksin nr. 5.4 foto nr. 5).

*Për sa më lart, shpenzimi prej **45,600,000 lekë** do të konsiderohet si një shpenzim jo eficent dhe efektiv, pasi sistemi nuk funksionon dhe nuk plotëson kërkesat e kërkuar sipas specifikimeve teknike dhe qëllimit të tij për të shërbyer për menaxhimin e procesit të planifikimit, miratimin dhe ekzekutimit të buxhetit financiar të alokuara nga FDSKSH për Drejtorit Rajonale të Fondit dhe Qendrave Shëndetësore duke mos realizuar edhe objektivat kryesor siç janë Efektiviteti, Digjitalizimi, strukturimi i të dhënave, administrimi, reduktim i kostove menaxheriale, etj.*

Ndërsa shuma prej **2,089,995.60 lekë** e shpenzuar si pagesë për mirëmbajtjen e sistemit do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, pasi sistemi i menaxhimit financiar në 420 QSH, nuk aksesohet, nuk funksionon dhe si i tillë nuk përdoret për qëllimin dhe objektivat për të cilat është prokuruar.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. A. M. në cilësinë e supervizorit të kontratës, i cili nuk ka garantuar funksionalitetin e sistemit sipas specifikime teknike të kërkuara në termat e referencës, pasi nga verifikimi i sistemit rezulton që nuk ka përputhje të kategorive me llogarite respektive të tyre dhe gjithashtu sistemi ka shfaqur problematik në lidhje me ruajtjen e të dhënave.
2. E. C. në cilësinë e koordinatorit te kontratës, nuk ka garantuar realizimin me sukses të kontratës në lidhje me funksionalitetin e programit pasi nga verifikimi i sistemit rezulton që nuk ka përputhje të kategorive me llogarite respektive të tyre dhe gjithashtu sistemi ka shfaqur problematik në lidhje me ruajtjen e të dhënave.
3. R. D. në cilësinë e ish Drejtoreshës së FSDKSH, nuk ka përcjellë asnjë problematikë tek MSHMS, Banka Botërore dhe Njësia e koordinimit të projektit të projektit HSIP, për mos funksionimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar, i cili është hostuar në serverët e fondit më datë 11.06.2018 nga I..., sipas shkresës nr. 179/15 datë 11.06.2018 ñNjoftimò. Nëpërmjet kësaj shkrese I... njofton mbi përfundimin e fazës së instalimit të sistemit më datë 11.06.2018 në zyrat qendrore të FSDKSH. Mbi bazën edhe të konfirmimit të mungesës së problematikave për sistemin e menaxhimit financiar në 420 QSH, i shprehur në shkresën 3371, 3371/1 datë 22.05.2020 dhe në zbatim të klauzolave të Kontratës, zyra e financës së PCU-së ka bërë pagesën e mirëmbajtjes për periudhën nëntor 2018 ï shtator 2019 për kompaninë I...
4. Gjithashtu për mos sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar për 420 QSH dhe mos aksesimin dhe funksionimin e tij. Njëkohësisht dhe përfitimin e shumës së shërbimit të mirëmbajtjes për një sistem që nuk funksionon dhe nuk aksesohet, duke përfituar në mënyrë të padrejtë dhe të pa merituar dhe në mospërputhje me kushtet e kontratës, shumën prej 2,089,995.60 lekë, ngarkon me përgjegjësi përfaqësuesin e bashkimit të operatoreve ñI... & B...ò z. S. E..

Kriteri: Kontrata nr. 2580/10 datë 23.10.2017.

Ndikimi: Ka ndikuar në mos realizimin e qëllimit dhe objektivave të vendosura.

Shkaku Mos funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar në 420 QSH.

Rëndësia: E lartë.

6.1 Rekomandimi: MSHMS në bashkëpunim me FSDKSH të marrin masa për vendosjen në funksion të sistemit të menaxhimit financiar në 420 qendrat shëndetësore.

6.2 Rekomandimi: MSHMS në bashkëpunim me FDSKSH të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **2,089,995.60 lekë** nga z. S. E., në cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit të operatoreve ñI... & B...ò për mos sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar për 420 QSH dhe mos aksesimin dhe funksionimin e tij, duke përfituar këtë shumë në mënyrë të padrejtë dhe të pa merituar dhe në mospërputhje me kushtet e kontratës për mirëmbajtjen e sistemit.

6.3 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me FDSKSH të hartojnë planin e punës për trajnimin e specialistëve të financës së Qendrave Shëndetësore dhe Drejtorive Rajonale të Fondit, që do jenë përdorues të sistemit të menaxhimit financiar.

6.4 Rekomandimi: MSHMS të analizojë problematikën në lidhje me sistemin e menaxhimit financiar në 420 qendrat shëndetësore, pasi mosfunksionimi dhe mospërdorimi i tij, nga sistemi i kujdesit shëndetësor parësor, e ka bërë jo efektiv shpenzimin prej 45,600,000 lekë, duke mos realizuar qëllimin dhe

objektivat për të cilat është prokuruar.

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e grupit të KLSH, nëpërmjet MSHMS është informuar edhe kompania I..., e cila ka paraqitur observacion nëpërmjet shkresës nr. 579/34 datë 15.11.2021, duke pretenduar se sistemi është funksional dhe për më tepër e citoj paragrafin në faqen 3 ku thuhet: ... *Për më tepër, ashtu siç është përmendur edhe në raportin tuaj të auditimit, funksionaliteti i shërbimit është konfirmuar edhe nga ish Drejtoresha e FSDKSH me shkresën nr.3371/1 datë 22.05.2020 dhe I... nuk është kontaktuar apo informuar lidhur me problematika të tjera përvec kërkesave për support, të cilat janë zgjidhur nga IMB* *Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:* Grupi i KLSH e vlerëson seriozitetin dhe komunikimin me KLSH, për marrjen e angazhimeve për zgjidhjen e problematikave të shfaqura nga sistemi i menaxhimit financiar në 420 QSH. Grupi i auditimit të KLSH sqaron se në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna, bashkëpunimi dhe realizimi i tyre nga I... duhet realizohet me MSHMS. Prandaj komentet tuaja nuk do të merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit

2.5.6. Zbatimi i kontratës *"Mbështetje e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar- zbatimi i strategjisë së re për menaxhimin e QSUT"*

Kontrata (Lump-Sum) nr.6975 prot. datë 12.12.2018 me vlerën 1,144,632 euro (me TVSH) e lidhur midis MSHMS dhe konsulentit C. S. është dakordësuar nga BB në datën 27.12.2018.

Periudha e zbatimit të kontratës 12.12.2018-12.12.2020

Data e nënshkrimit te kontratës: 12.12.2018

Kontrata është bërë efektive më date 06.01.2019.

Kontrata e shërbimit të konsulencës HSIP/CS/QCBS/01-2017 ka të përcaktuar qëllimin dhe objektivat që duhen të arrihen, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve për zbatimin me sukses të produkteve të kërkuara nga MSHMS dhe të dorëzuara nga konsulenti ndërkombëtar

Shtyrja e afateve te kontratës

Me shkresën nr. 1919/4 prot. date 29.12.2020 drejtuar njësisë se koordinimit të projektit për projektin HSIP, në bazë të kërkesës së kompanisë C. S. France, që në kushtet e pandemisë Covid 19 dhe gjykimit të ekipit menaxhimit të kontratës të përbërë nga: M. K., R. D., F. P., F. B. dhe S. N., Koordinatorja e Përgjithshme e Projektit znj. E. H. ka miratuar zgjatjen e afatit të zbatimit të kontratës nr. 6975 prot., date 12/12/2018 deri 06.06.2021 pa u shoqëruar me efekte financiare.

MSHMS ka pranuar të zgjasë kohën për zbatimin e kontratës me konsulentin fitues midis saj dhe C. S.-France, duke i bashkëlidhur shtrojsën nr.1., nr. 1919/5 prot., date 06.01.2021

Për sa më lart, palët ranë dakord si më poshtë:

Neni 14.1 i kontratës ndryshohet duke përcaktuar afatin e ri te përfundimit: ñPërfundimi i kontratës: periudha kohore do të jetë 29 muaj pas datës së fillimit të shërbimit, ose deri më 06 qershor 2021.

Shënim: Periudha e zbatimit të kontratës mund të zgjatet nëse këto nevoja konsiderohen të rëndësishme për përfundimin e detyrës. Çdo ndryshim do të nënshkruhet me marrëveshje të ndërsjellë nga të dy palët

Të gjithë artikujt që i referohen datës së përfundimit do ti referohen datës 06.06.2021

Programi i rishikuar i punës për aktivitetet e mbetura dhe produktet e dorëzuara gjenden në aneksin 1 të kësaj shtojce.

Të gjitha pjesët e tjera të kontratës mbeten të pandryshuara

Aneksi nr.1. Programi i punës për aktivitetet e mbetura dhe produktet e dorëzuara

Tabela nr.38

Faza 3 Faza 4 Faza 4

	D15 (HMIS installation)	D16 (Evaluation)	D17 (Final)
Deliverable submission datës (2021)			
Raporti i dorëzuar klientit	March 14, 2021	April 25, 2021	May 9, 2021

Zëvendësimi i ekspertëve

Konsulentit ndërkombëtar C. S., pas periudhës së lidhjes së kontratës me MSHMS për hartimin e një strategjie të re për menaxhimin e QSUT, ka kërkuar dhe ka ndryshuar herë pas here ñEkspertët kryesorò të ekipit të vet.

Në mënyrë kronologjike, zëvendësimet apo mbulimi i detyrave të eksperteve nga ekspert të tjerë të ekipit të konsulentit ndërkombëtar C. S., paraqiten sa më poshtë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se:

Kompania C. S. Francë, në paraqitjen e propozimit teknik dhe financiar për pozicionet KE1 dhe KE4 (27.03.2017) ka paraqitur ekspertët e mëposhtëm:

KE1: T. M. (Team Leader)

KE 4: I. S. (Computer Scientist, Expertin HMIS & Software Programmer)

Gjatë procesit të negocimi, konsulenti ndërkombëtar C. S., më datë 18.09.2018, ka kërkuar me e-mail zëvendësimin e ekspertëve KE1 dhe KE4.

Për KE1: Konsulenti ka propozuar dy ekspertë nga të cilët MSHMS mund të zgjedhë një prej tyre dhe për KE4: J. S..

Ndryshimi i ekspertëve është realizuar gjatë procesit të negocimit të kontratës (reflektuar në minuta negocimi (faqe 3-4 ñPropozimi i dorëzuarò dhe Paragrafi 4.5 ñDiskutime për ekipin e ekspertëveò, faqe 15-17 ñLista e ekspertëveò.

Me shkresën nr. 5286/1 prot., datë 19.10.2018 të Ministres së Shëndetësisë është miratuar minutazhi i takimit, ku konsulenti ka njoftuar se znj. T. S. me pozicion ñTeam leaderò KE1 nuk do të jetë pjesë e ekipit të ekspertëve ndërkombëtar, për shkaqe personale. Për këtë fakt konsulenti ka propozuar dy ekspertë ekzistues Z. E. dhe Z. J. për të zëvendësuar punën e znj. T. S., e cila kishte pozicionin e Team Leader në ekipin ndërkombëtar të konsulentit C. S. për hartimin e strategjisë së re të menaxhimit të QSUT. Ekipi i menaxhimit të kontratës e ka pranuar kërkesën e konsulentit dhe ka pranuar që z. L. E. të emërohet në pozicionin KE1 si Team Leader. Në proces verbalin e minutave të takimit të datës 15.06.2020, Ekipi i menaxhimit të kontratës i përberë nga znj. M. C., znj. F. B., znj. M. K., znj. F. P., znj. S. N. kanë miratuar ndryshimin e propozuar nga konsulenti C. S. për zëvendësimin z. J. S. me z. J. M.. Përbërja e ekipit të ekspertëve është paraqitur në tabelën nr. 5.2.1 të Aneksit nr. 5.2.

7. Titulli i gjetjes: Ndryshime të shpeshta të ekspertëve kryesor.

Situata: Në proces verbalin e mbajtur të minutave të takimit të datës 19.02.2019, për arsye objektive sipas kompanisë fituese, një nga ekspertet z. M. F. (Key Expert 5) me detyrë ekspert i përmirësimit të cilësisë ñQuality Improvement Expertò me pagesë të parashikuar prej 70,125 euro, kërkohet që të zëvendësohet me dy ekspertë ekzistues konkretisht, nga z. M. W. dhe z. M. M.. Theksojmë qe z. M. W. ka një angazhim në dy pozicione eksperti KE2 (Hospital Manager) dhe KE9 (Chief Nurse Manager) referuar ñFin - 3 Breakdoën of Remunerationò - shiko tab. nr.1 aneksi nr.5

Ekipi i menaxhimit të kontratës. ka miratuar kërkesën e konsulentit duke pranuar që punën e ngarkuar për ekspertin (KE5) të mbulohet dhe të realizohet nga dy ekspertë të tjerë ekzistues të ekipit z. M. W. dhe z. M. M., të cilët kanë detyra specifike dhe profesion jo të

ngjashëm me z. M. F. (Quality Improvement Expert), si dhe CV jo të përshtatshme me kërkesat për pozicionin e ekspertit KE5. Gjithashtu këta dy ekspert kanë një angazhim të lartë kohorë, gjë që e bënë të pamundur edhe sikur të kishin ekspertizën, kualifikimin dhe përvojën ekuivalente me pozicionin e KE5, ata nuk mund të realizonin me sukses detyrën për shkak të ngarkesës që kanë në pozicionet e tyre fillestare, kryesisht z. M. W.

Për më tepër që në asnjë pikë të kontratës nuk është parashikuar shpërndarja e detyrave brenda ekipit për ekspertët që largohen, por është parashikuar me të drejtë zëvendësimi i tyre me një person me kualifikim e përvojë ekuivalente ose më të mirë, dhe masë shpërblimi të njëjtë, sipas parashikimit të nenit 19.1.1 pika f dhe nenit 30 të kontratës, si më poshtë e cituar:

Zëvendësimi i ekspertit kryesor:

Përveç rastit kur klienti me shkrim deklaron ndryshe, eksperti kryesor nuk mund të zëvendësohet.

Pavarësisht paragrafit më lart, gjatë ekzekutimit të kontratës, bazuar vetëm në kërkesën me shkrim të konsulentit, mund të bëhet edhe zëvendësimi i ekspertit kryesor.

Ky zëvendësim i ekspertit kryesor do te behet për arsye shëndetësore apo rast vdekje, të paparashikuara më parë nga konsulenti.

Në një rast të tillë, konsulenti menjëherë do të gjejë zëvendësues, person me kualifikim e përvojë ekuivalente ose më të mirë, dhe masë shpërblimi të njëjtë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi*:*

E. H., M. H., F. P., F. B., S. N., në cilësinë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të kontratës [4], kanë vepruar në mospërputhje me parashikimet e nenit 19.1.1 pika f dhe nenit 30 të kontratës, pasi ekipi i menaxhimit të kontratës nuk duhej të miratonte kërkesën e konsulentit për të ndarë punën e ekspertit kryesor KE5 me dy ekspertë ekzistues, por në një rast të tillë eksperti kryesor (KE5) të zëvendësohej me një ekspert tjetër të ri me të njëjtin kualifikim dhe përvojë pune ekuivalente apo më të mirë dhe me të njëjtën masë shpërblimi me të.

Kriteri: Kontrata nr.6975 prot. datë 12.12.2018

Ndikimi/Efekti: Mbulimi i detyrave të një eksperti kryesor nga dy ekspert brenda ekipit të ekspertëve, përveç angazhimit të lartë kohorë, dhe mungesës së ekspertizës, kualifikimit dhe përvojës ekuivalente me pozicionin e KE5, ka ndikim në cilësinë e realizimit të detyrave të marra, dhe si rrjedhim edhe në arritjen e objektivave të vendosura për strategjinë e re të menaxhimit të QSUT.

Shkaku: Zëvendësimi i ekspertit kryesor KE 5 me dy ekspert brenda ekipit të ekspertëve.

Rëndësia: E lartë.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rast të kerkesave të konsulenteve për zëvendësim të eksperteve kryesor të tyre, të

[4] Urdhri nr.672 date 26.09.2018

miratoi vetëm zevendesimet me ekspert të tjerë, që kanë kualifikim të njëjtë ose më të lartë se ata që zevendesojnë dhe mos të miratoi kërkesa për shpërndarje të detyrave tek ekspertët ekzitues të kontratës.

Pagesa e konsulentit

Bazuar ne kushtet e kontratës 41.2 është përcaktuar që pagesa e parë të bëhet në masën 10% të totalit të kontratës Lump Sum.

Me Urdhër Shpenzimi nr.24 datë 11.04.2019, është bërë pagesa për konsulentin në shumën 114,463.20 Euro, që përfaqëson 10% parapagim të vlerës së kontratës.

Me shkresën nr. 3420/2 prot. datë 19.09.2019, koordinatorja e projektit ka autorizuar njësinë e koordinimit të projektit HSIP, të kryej pagesën e fazës së parë në masën 25% të vlerës së kontratës.

Me Urdhër shpenzimi nr.62 datë 24.09.2019 në shumën 286,158 euro, është bërë pagesa për përfundimin e fazës së parë nga konsulenti.

-Me shkresën nr.3420/1 prot. datë 09.09.2019 ñLetër pranimi për fazën e parëò grupi i punës për menaxhimin e kontratës i përbërë nga: M. K., M. H., F. B., S. N., F. P. të cilët në zbatim të Urdhrit nr.672 date 26.09.2018, Urdhrit nr. 3241 datë 14.06.2019 si dhe të klauzolës 9.1 të kontratës.

Konsulentin C. S., ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar dhe të parashikuar në kontratë sipas fazave të përcaktuara. Konkretisht: Raportin 2a, 2b, 2c,2d, D3, D4,D5. Bazuar në kontratën neni 9.1 i kushteve specifike dhe aneksit A ñTermat e referencës dhe qëllimi i shërbimitò, pika 4 ñDetyrimet e raportimit të konsulentitò. Ekipi i menaxhimit të kontratës i ka konsideruar dhe i ka konfirmuar në përputhshmëri të plote me ToR dhe kushtet e kontratës për dokumentacionin e paraqitur për fazën e parë.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 672, datë 26.09.2018 dhe nr. 3241 datë 14.06.2019 si dhe klauzolës 9.1 të kontratës HSIP/QCBS/01-2017 të lidhur me 12.12.2018 në kuadër të projektit të përmirësimit të sistemit të shëndetësisë, financuar nga IBRD nr.8466-AL ndërmjet MSHMS dhe kompanisë C. S. për kryerjen e shërbimit të konsulencës ñMbështetje për QSUT nga një ekip ndërkombëtar menaxhimi ï Zbatimi i strategjisë së re të menaxhimit për QSUTò ekipi menaxhimit të kontratës i përbërë nga: M. K., M. C., F. B., S. N., F. P., nëpërmjet letrës së pranimit për fazën e dytë, nr.1919/1 prot. date 26.05.2020, ka informuar koordinatoren e projektit, se konsulenti ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar dhe të përcaktuar në kontratë për fazën e dytë, sipas parashikimeve të nenit 9.1 të kushteve specifike të kontratës dhe aneksit A-Termat e referencës dhe qëllimi i shërbimit, pikës 4 ï detyrimet e raportimit të konsulentit. Për sa me sipër, koordinatorja e projektit, nëpërmjet shkresës nr. 1919/1 prot., datë 26.05.2020 ka autorizuar PCU të kryej pagesën për konsulentin në masën 25% të vlerës së kontratës për fazën e dytë. Pagesa është realizuar më date 14.07.2020 me pagese të drejtpërdrejt, nëpërmjet IBRD në shumën 286,158 euro.

Komiteti drejtues dhe Ekipi për menaxhimin e kontratës

Krahas ekipit të menaxhimit të kontratës, MSHMS[5] ka ngritur, komitetin drejtues të kontratës ñMbështetje për QSUT nga një ekip ndërkombëtar menaxhimi-zbatimi i strategjisë së re të menaxhimit për QSUTò, me këta anëtarë: M. R., G. P., R. D., M. H., E. J., A. Ç., A. Nj..

Komiteti Drejtues i kontratës ka për detyre të marrë vendime strategjike për ecurinë e kontratës dhe të garantojë që ecuria e kontratës të vijoj sipas prioriteteve të MSHMS.

Pas ndryshimit të urdhrit nr. 672 datë 26.09.2018 mbi përbërjen e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të kontratës, nëpërmjet urdhrit nr.3241 date 14.06.2019, anëtarë të ekipit të menaxhimit të kontratës janë: M. K., M. H., F. B., S. N., F. P. Ekipi ka për detyrë të:

a. Menaxhojë, monitorojë dhe koordinojë zbatimin e kontratës

[5] Urdhër nr.482 date 27.06.2019

b. Të kontrollojë, komentojë, sugjerojë përmirësime për draft raportet e prodhuara nga konsulenti, në përputhje me kërkesat e ToRs dhe kushteve të kontratës
c. Të kryejë procedurat zyrtare të marrjes në dorëzim të raporteve të prodhuara nga konsulenti duke konfirmuar përputhshmërinë e tyre me plotësimin e kërkesave të ToR dhe kushteve të kontratës
d. Prezantimin zyrtar të raporteve/produkteve të klientit të shoqëruara me faturat përkatëse tek njësia e koordinimit të projektit.
e. Të autorizojë NJKP për ekzekutimin e pagesave sipas kontratës, kundrejt dorëzimit të ñLetrës së pranimit të raporteveò
f. Konfirmimin zyrtar në lidhje me përfundimin e kontratës

Dorëzimi i raporteve të konsulentit

Në zbatim të kushteve të kontratës klauzolës 9.1 të kontratës, konsulentin C. S., duhej të dorëzonte brenda afateve kohore të përcaktuara në kontratë dhe të pasqyruara në tabelën nr.5.2.2 aneksi nr. 5.2. Pas dorëzimit të raporteve respektive sipas fazave dhe kërkesave të përcaktuara në TOR dhe të pasqyruara në kontratë, konsulenti duhet ti dorëzonte pranë ekipit të menaxhimit të kontratës në formatin hard copy dhe elektronik me e-mail raportet dhe dokumentacionin e kërkuar.

Ekipi i menaxhimit në zbatim të klauzolës (kushtet specifike) neni 41.2 afati i komenteve, duhet që brenda 21 ditë nga dita e dorëzimit të raporteve të bëj komentet. Të dhëna analitike mbi dorëzimin e raporteve respektive sipas fazave dhe datave gjendet në aneksin nr. 5.2 tabela nr. 5.2.2

8. Titulli i gjetjes:	Mos realizimi i kontratës për ñMbështetjen e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë se re për menaxhimin e QSUTò
Situata:	1.Në njësinë e koordinimit të projektit HSIP, janë dorëzuar raportet në format ñhard copyò dhe ñLetra e pranimit të raporteveò nga ekipi i menaxhimit të kontratës vetëm për fazën e parë dhe të dytë të kontratës. 2.Megjithëse afati i fundit për dorëzimin e produkteve/raporteve nga konsulenti është data 09.05.2021, konstatohet se në zyrat e PCU nuk është depozituar dokumentacioni i kërkuar dhe i parashikuar ne kontratë për fazën 3 dhe fazën 4 (e fundit). 3.Gjithashtu konstatohet se nga ana e ekipit të menaxhimit të kontratës nuk është bërë konfirmimi zyrtar i përfundimit të kontratës, veprim në mospërputhje me pikën ñfò të urdhrit 672 datë 26.09.2018. f. Konfirmimin zyrtar ne lidhje me përfundimin e kontratës. 4.Konsulenti ndërkombëtar C. S. nuk ka respektuar afatin kohor të përcaktuar në kontratë për dorëzimin e raporteve respektiv të parashikuara sipas kërkesave të ToR-s. Siç shihet tabelën nr. 5.2.2 aneksi nr. 5.2., dallohet lehtësisht që data e dorëzimit apo përcjelljes së raporteve nga ana e konsulentit në format elektronik me e-mail, drejt ekipit të menaxhimit të kontratës në te gjitha rastet nuk është respektuar duke tejkaluar afatet kohore dhe duke vepruar në mospërputhje me klauzolën 26. Detyrimet e Raportimit (Reporting Obligation) pika 26.1 ku parashikohet se: *Konsulenti do t'i paraqesë Klientit raportet dhe dokumentet e specifikuara në Shtojcën A, në formë, në sasi dhe brenda periudhave kohore të përcaktuara.* 5.Pranë zyrave të njësisë së koordinimit të projektit HSIP, nuk janë dorëzuar nga ekipi i menaxhimit të kontratës raportet respektive për fazën e tretë dhe të katërt, si dhe letra e pranimit për këto faza.

6.Koordinatorja e përgjithshme e projektit nuk ka informuar Ministren e Shëndetësisë, për mos dorëzimin e produkteve/raporteve të konsulentit brenda datës 09.05.2021. Gjithashtu koordinatorja e përgjithshme e projektit, nuk ka informuar zyrtarisht ministren e shëndetësisë në lidhje me mos respektimin e urdhrit të ministrit për konfirmimin zyrtar të mbylljes së kontratës, veprime këto në kundërshtim me piken f të urdhrit 672 datë 26.09.2018.
7. Megjithëse konsulenti ka si detyrim paraqitjen dhe dorëzimin e produkteve nëpërmjet raporteve respektive, konsulenti nuk e ka zbatuar afatin në asnjë prej fazave te pasqyruara në tabelën nr.5.2.2 aneksi nr.5.2
Nga ana e ekipit të menaxhimit të kontratës apo koordinatores së përgjithshme të projektit nuk ka gjurmë auditi, për të evidentuar këtë fakt.
Gjithashtu konsulenti nuk ka plotësuar kushtet e kontratës edhe në lidhje me dorëzimin e produkteve brenda afateve kohore të përcaktuar në kontratë klauzola 26. ñReporting Obligationsò dhe nga ana e përfaqësuesve te klientit (MSHMS) nëpërmjet përfaqësuesve të saj, Koordinatores së përgjithshme të projektit dhe ekipit të menaxhimit të kontratës nuk janë marrë masa penalizuese ndaj konsulentit për shkelje të kushteve të kontratës në lidhje me afatet e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar.
8. Konsulenti nuk ka dorëzuar asnjë raport mujor të ecurisë dhe të trajtimit të çështjeve të rëndësishme që lidhen me procesin e zbatimit të kontratës, pranë njësisë së koordinimit të projektit, koordinatorit të përgjithshëm të projektit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT.

<u>Dorëzimi i raporteve të konsulentit pranë QSUT</u>
Mbi auditimin e ushtruar në Qendrën Spitalore Universitare, ñNënë Terezaò, në bazë të programit të auditimit nr.579/1 prot., datë 04.06.2021 i ndryshuar dhe autorizimit për kryerjen e auditimit tematik me nr. 579/31 prot., datë 15.09.2021, i mbajtur me datë 17.09.2021
<u>Objekti i këtij akt verifikimi është:</u>
Dorëzimi i raporteve të konsulentit ndërkombëtar ñC. S.ò pranë QSUT mbi strategjinë e re të menaxhimit të QSUT.
Hapat e ndjekura nga QSUT mbi implementimin e strategjisë së re të menaxhimit të QSUT, sipas përcaktimeve të Kontratës nr.6975 prot. datë 12.12.2018, me objekt ñMbështetje e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë së re për menaxhimin e QSUTò.
Grupi i auditimit, paraqiti pyetësorin me nr. 2369/1 datë 16.09.2021, pranë QSUT. Kërkesave dhe pyetjeve të parashtruar në këtë pyetësor, Drejtori i përgjithshëm i QSUT, iu përgjigj nëpërmjet shkresës nr. 2369/2 prot. datë 16.09.2021.
Në lidhje me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH-së, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të protokolluar në QSUT, në lidhje me realizimin e kontratës me objekt ñMbështetje e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë së re për menaxhimin e QSUTò

a. Punonjësja e protokollit të QSUT, *Znj. E. B.*, vuri në dispozicion vetëm dokumentacionin e mëposhtëm të sigluar me vulën e institucionit:

1.Urdhër nr.386, datë 07.09.2021 (administruar nga QSUT me nr. 2309 prot. datë 08.09.2021) ñPër hartimin e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë së re të menaxhimit të Qendrës Spitalore Universitare ñNene Terezañ

2. Urdhër i Brendshëm nr.266 date 06.09.2019, për ñNgritjen e grupit teknik te punës ne QSUT ne zbatim te Projektit ñHealth System Improvement (HSIP)ò

3. Urdhër nr. 672 datë 26.09.2018 (administruar nga QSUT me nr.5412 prot., datë 26.12.2018) për emërimin e ekipit të menaxhimit të kontratës për ñMbështetjen e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-Zbatimi i Strategjisë se re për menaxhimin e QSUT-sëò

<u>Nga auditimi tematik në QSUT, rezulton se</u>

Në protokollin e QSUT, nuk është depozituar asnjë produkt/raport, i konsulentit ndërkombëtar për strategjinë e re të menaxhimit të QSUT, apo produkt/raport i konsulentit ndërkombëtar nëpërmjet MSHMS.

Gjithashtu Drejtori i Përgjithshëm i QSUT, nuk disponon zyrtarisht kontratën e lidhur midis MSHMS dhe konsulentit C. S. me objekt *"Mbështetje e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë se re për menaxhimin e QSUT"*

Për sa më lart, kontrata me konsulentin ndërkombëtar për një strategji të re të menaxhimit të QSUT, do të konsiderohet e pasuksesshme në drejtim të dorëzimit të produkteve/raporteve sipas fazave dhe respektimit të afatit kohorë të përfundimit të kësaj kontrate, brenda datës 06.06.2021.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Koordinatorja e Përgjithshme e Projektit E. H. dhe anëtarët e ekipit të menaxhimit të kontratës M. K., M. H., F. B., S. N., F. P..

Nga auditimi i kësaj praktike rezultoi gjithashtu se kontrata e lidhur mes palëve nuk ka të përfshirë penalitete për dorëzimin me vonesë të produkteve kontratës.

Kriteri: Kontrata për ñMbështetjen e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë se re për menaxhimin e QSUTò.

Ndikimi/Efekti: Në mos realizimin e objektivave të vendosur për rritjen dhe përmirësimin e efektivitetit dhe llogaridhënies së QSUT, si rezultat i përmirësimit me eficencë të përdorimit të niveleve të ndryshme të rrjetit të kujdesit shëndetësor si një vazhdimësi e shërbimeve.

Shkaku: Mungesa e dorëzimit të raporteve të konsulentit ndërkombëtar për strategjinë e re të menaxhimit të QSUT

Rëndësia: E lartë.

8.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për përfundimin e kontratës ñMbështetja e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë së re për menaxhimin e QSUTò dhe në bashkëpunim me QSUT, të hartojë planin e veprimeve për fillimin e implementimit të saj.

8.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për përfshirjen në kontratat e ardhshme të klauzolave në lidhje me

aplikimin e penaliteteve për dorëzimin me vonesë të produkteve këtyre kontratave.

Zbatimi i kontratave të lidhura për projektin ñPajisje mjekësore për spitalet, Loti 2 dhe 6ò

Për këtë kontratë u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dokumentacioni i arkivuar nga Zyra e Koordinimit të Projektit në lidhje me zbatimin e kontratave me objekt "Pajisje mjekësore për spitalet, Loti 2 dhe 6"*;
2) *Udhëzuesi i procedurave të Prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-konsulente për kredi dhe grante nga IBRD dhe IDA për huamarrësit ndaj Bankës Botërore (i vitit 2014);*
3) *Korrespodenca të ndryshme;*
4) *Etj.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Si përfituese dhe implementuese direkt e Huas së Bankës Botërore AL ï 8466, e ratifikuar në Parlament me anë të ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"* Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të këtij Projekti, ka parashikuar edhe pajisjen e spitaleve rajonale me pajisje mjekësore.

- *Kontrata për pajisjet mjekësore të spitaleve rajonale, Loti 2*

Kontrata e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (HSIP) dhe I... S... Itali, mban numrin e prot. 2492 dhe është lidhur më datë 28.05.2018.

Sipas kontratës spitalet që do të pajisen me pajisjet mjekësore nga Furnizuesi janë spitalet rajonale të Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Kukësit, Lezhës, Shkodrës dhe Vlorës. Spitali Rajonal i Beratit nuk është përfshirë në këtë kontratë. Kontrata ka një jetëgjatësi prej dy vjetësh për çdo pajisje që nga dita e njoftimit për fitoren e tenderit. Periudha e mirëmbajtjes së pajisjeve është 7 vjet. Nëpërmjet shkresës nr. 3958 prot., datë 22.06.2018 i është kërkuar MSHMS miratimi i korrigjimit të propozuar nga furnitori I... S... respektivisht, Loti 2: Ultrasonografi dhe Endoskopi në Klauzolën 46C të Letër Kredisë (LC) për aktivitetin Pajisje Mjekësore për spitalet rajonaleò, financimi i Projektit të Bankës Botërore ñPërmirësimi i Sistemit Shëndetësorò. Korrigjimi ka të bëjë me vendin e origjinës së pajisjeve, pasi I... S..., e cila ka referuar si prodhues firmën gjermane por që pajisjet janë me origjinë nga Koreja e Jugut dhe Kina. Për këtë është kërkuar nga Drejtorja e Kabinetit në MSHMS, znj. E. H., nëpërmjet shkresës 3958/1, datë 22.06.2018 marrja e no-objection nga Banka Botërore për këto korrigjime.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 774/1 prot., datë 15.05.2018 Grupi i Menaxhimit të Kontratës i përbërë nga z. P. M. Koordinator, znj. L. P., znj. V. Xh., znj. F.S. dhe z. O. A. anëtarë i kanë kërkuar Drejtores së Kabinetit në MSHMS në lidhje me lotet 2 dhe 6 ndryshime në Klauzolën GCC 19.2 të këtyre tre kontratave të lidhura me furnitorët e huaj. Propozohet ndryshimi i kushteve speciale të kontratës, ku kushti i efektivitetit të kontratave të mos jetë funksion i regjistrimit të pajisjeve pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Arsyeja e këtij rishikimi lidhet me zgjidhjen e pagesës 80 % në dërgesë. Duke marrë në konsideratë disa shqetësime të ngritura nga ana e kompanive mbi vështirësitë e lëvrimit në kohë të të gjitha pajisjeve dhe disa problematika të vërejtura në spitalet rajonale në lidhje me përgatitjen e ambienteve ku do të instalohen pajisjet kërkohet shtyrje e afatit të lëvrimit të pajisjeve, kohë kjo që do të reflektohet në amendamentet përkatëse të kontratave. Ky ndryshim është miratuar nga Drejtorja e Kabinetit znj. E. H. e cila ka autorizuar Njësinë e Koordinimit të Projektit HSIP, të kryejë procedurat për marrjen zyrtarisht të no-objection nga Banka Botërore, nëpërmjet shkresës nr. 774/2, datë 18.05.2018. Për këtë është marrë nëpërmjet e-mailit të datës 27.06.2018 nga ana e përfaqësueses së Bankës, znj. L. K., no-

objection nga Banka Botërore. Ndryshimi i kontratës është bërë me nr. 3492 prot., datë 10.07.2018.
- Kontratës i është bërë një ndryshim i dytë pas marrjes no-objection nga Banka Botërore më datë 26.06.2018. Ndryshimi ka të bëjë me zgjatjen e afatit të dorëzimit të pajisjeve si dhe me vendosjen e datës së mbylljes së kontratës, më datë 15.10.2018. Ndryshimi i kontratës ka nr. 3492/2 prot., dhe datë 03.08.2018.
- Ndryshimi i fundit i kontratës për Lotin 2 është bërë më datë 21.11.2018 me nr. 3492/13 prot. Në këtë ndryshim janë përfshirë 2 nene dhe zgjatja e saj nga data 15.10.2018 që u bë në ndryshimin e dytë në datë 15.12.2018. Ndryshimi është bërë në vijim të marrjes së no-objection nga Banka, nëpërmjet e-mailit të datës 15.11.2018.

- *Kontrata për pajisjet mjekësore të spitaleve rajonale, Loti 6*

Kontrata ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (HSIP) dhe firmës Sh... Kroaci, mban numrin e prot. 4284 dhe është lidhur më datë 09.07.2018. Sipas kontratës spitali rajonal që do të pajiset me aparaturën angiografi është ai i Fierit. Kontrata ka një jetëgjatësi prej dy vjetësh për çdo pajisje që nga dita e njoftimit për fitoren e tenderit. Periudha e mirëmbajtjes së pajisjeve është 7 vjet.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 774/1 prot., datë 15.05.2018 Grupi i Menaxhimit të Kontratës i përbërë nga z. P. M. Koordinator, znj. L. P., znj. V. Xh., znj. F.S. dhe z. O. A. anëtarë, i kanë kërkuar Drejtores së Kabinetit në MSHMS në lidhje me lotet 2 dhe 6 ndryshime në Klauzolën GCC 19.2 të këtyre tre kontratave të lidhura me furnitorët e huaj. Në vijim, siç është përshkruar dhe në paragrafin e mësipërm ñKontrata për pajisjet mjekësore të spitaleve rajonale, :Loti 2ò.
- Ndryshimi i parë i kontratës mban nr. prot. 4284/1 dhe është bërë më datë 17.08.2018. ndryshimi ka të bëjë me ndryshimet e sipërpërmendura në Klauzolën GCC 19.2.
- Ndryshimi i dytë i kontratës mban numrin 4284/2 prot., dhe është bërë më datë 18.09.2018, pas marrjes së no-objection nga Banka nëpërmjet e-mailit të datës 11.09.2018. Nëpërmjet këtij ndryshimi është zgjatur afati i përfundimit të kontratës për në datën 08.11.2018 si dhe periudha e dorëzimit të aparaturës nga ñ12 javë pas nënshkrimit të kontratësò në ñ16 javë pas nënshkrimit të kontratësò.
- Ndryshimi i tretë dhe i fundit i kontratës është bërë më datë 02.11.2018 me nr. 4284/6 prot., pas marrjes së miratimit nga Banka më datë 22.10.2018. Ky ndryshim lidhet me ndryshimet e sipër përmendura në Klauzolën GCC 19.2 si dhe me shtyrjen e përfundimit të kontratës nga data 08.11.2018 në datën 30.11.2018.

- *Në lidhje me zbatimin e kontratës për Lotin 2*

Me shkresën nr. 5153 prot., datë 03.09.2018 Sekretari i përgjithshëm z. A. K., ka autorizuar z. S. C. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financave të kryejë procedurat e nevojshme për zhdoganimin e pajisjeve mjekësore të blera nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me referencë HSIP/ICB/01-2016-Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale ï Lot 2: Ultrasonografi dhe Endoskopi, nr. prot. 3492, datë 28.05.2018.

- *Në lidhje me zbatimin e kontratës për Lotin 6*

Me shkresën nr. 5153 prot., datë 16.10.2018 Sekretari i përgjithshëm z. A. K., ka autorizuar z. S. C. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financave të kryejë procedurat e nevojshme për zhdoganimin e pajisjeve mjekësore të blera nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me referencë HSIP/ICB/01-2016-Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale ï Lot 6: Angiografi, nr. prot. 4284, datë 09.07.2018.

- Zbatimi i kontratës së lidhur për projektin ñRishikimi i Master Planit ekzistues spitalor në Shqipëri (Plani i racionalizimit të lehtësimit shëndetësor për Shqipërinë)ò

Për këtë kontratë u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dokumentacioni i arkivuar nga Zyra e Koordinimit të Projektit në lidhje me procedurën e prokurimit për kontratën me objekt "Rishikimi i Master Planit ekzistues spitalor (Plani i racionalizimit të lehtësimit shëndetësor për Shqipërinë)"*;
2) *Udhëzuesi i Bankës Botërore "Për përzgjedhjen e punësimin e konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" (e vitit 2014);*
3) *Korrespodenca të ndryshme;*
4) *Etj.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:
Si përfituese dhe implementuese direkt e Huas së Bankës Botërore AL ï 8466, e ratifikuar në Parlament me anë të ligjit nr. 572015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"* Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të këtij Projekti, ka parashikuar rishikimin e Master Planit ekzistues spitalor.

- *Kontrata për pajisjet mjekësore të spitaleve rajonale, Loti 2*

Nëpërmjet shkresës me nr. 3964 prot., datë 01.08.2019, Ministrja e MSHMS ka nxjerrë Urdhrin nr. 591, datë 01.08.2019 ñPër caktimin e ekipit të menaxhimit të kontratës ñRishikimi i Master Planit ekzistues spitalor në Shqipëriò, i cili përbëhet nga M. H., Drejtore, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; R. D., Drejtore, Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe M. K., Këshilltare e Ministrit.
Ekipi i menaxhimit të Kontratës ka patur detyrën të kryejë:

- Koordinim i aktiviteteve të kontratës;
- Pranimin dhe miratimin e raporteve dhe çdo lloj produkti tjetër të kërkuar nga klienti;
- Marrjen dhe miratimin e faturave për pagesë dhe/ose, listë prezencave të dorëzuara nga konsulenti, kundrejt lëshimit të letrës së pranimit.
- Prezantimi zyrtar i raporteve / produkteve të klientit të shoqëruar me faturat dhe miratimet përkatëse tek Njësia e Koordinimit të projektit për ekzekutim pagese.
- Konfirmimin zyrtar në lidhje me përfundimin e kontratës.

Sipas kontratës që mban numrin 3964 prot., datë 21.08.2018, Raportet për tu përgatitur për MSHMS dhe për Bankën Botërore janë si më poshtë:

- Raporti fillestar;
- Raportet paraprake;
- Raportin përfundimtar të përfundimit të shërbimit (pas 9 muajsh nga fillimi i kontratës), i cili në brendësi ndër të tjera përmban dhe
    - Draftin e Master Planit për Spitalin,
    - Policat e propozuara për të ndihmuar në implementimin e këtij të fundit,
    - Planin e Implementimi të Master Planit, Strategjinë e Komunikimit, etj.

- *Në lidhje me zbatimin e kontratës për rishikimin e Master Planit*

Në zbatim të kontratës së nënshkruar janë hartuar dokumentet dhe raportet e cituara në të, ku përmendim:

- Raport gjithëpërfshirës: Plani i investimeve për infrastrukturë dhe pajisje teknike me plane të përshtatshme biznesi për implementim.
- Raport i Hollësishëm duke përfshirë:
  -(i) Principet e përgjithshme të sistemit: përkufizimet, fushëveprimi dhe përmbajtja e shërbimeve për institucionet shëndetësore në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor;
  -(ii) Kushtet për zonat e referencës dhe mundësia e arritjes.
- Politikat për Mbështetjen dhe Nxitjen e Zbatimit të Master Planit të Spitalit: Raporti Gjithëpërfshirës
  -(i) Propozimi për mekanizmin e monitorimit dhe vlerësimit brenda MSHMS;

-(ii) Plani i zbatimit (Udhërrëfyesi) për Master Planin e Spitalit.

- Raport
  -(i)Përshkrimi i metodologjisë;
  -(ii) Analiza e përgjithshme e situatës dhe statistikat.
- Politikat për Mbështetjen dhe Nxitjen e Zbatimit të Master Planit të Spitalit: Raporti mbi planin për kornizën rregullatore duke përfshirë
  -(i) Planin e zhvillimit të burimeve njerëzore (afatgjatë);
  -(ii) Planin për parandalimin dhe zbutjen e pasojave të zbatimit të Master Planit të Spitalit.
- Raporti periodik mbi rezultatet e arritura duke përfshirë propozim për racionalizimin e shërbimeve shëndetësore
- Raporti periodik
  -(i) Vlerësimi dhe analiza e sistemit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore;
  -(ii) Përmbledhje ekzekutive ñRishikimi i Master Planit Ekzistues të Spitalit (Plani i Racionalizimit të Objekteve Shëndetësor) në Shqipëriò.
- Politikat për Mbështetjen dhe Nxitjen e Zbatimit të Master Planit të Spitalit: Raporti periodik mbi rezultatet e arritura duke përfshirë strategjinë e komunikimit
- Kuadri konceptual, parimet dhe parametrat e matshëm.
- Raporti Final ñPasqyrë e shkurtër e studimeve, raporteve dhe planeve përkatëse të mëparshme në sistemin Spitalor të Republikës së Shqipërisë dhe harta e kontekstit shëndetësor të Republikës së Shqipërisëò.
- Raport gjithëpërfshirës: Politikat për mbështetjen dhe nxitjen e zbatimit të Master Planit të spitalit; Përshkrimi i metodologjisë dhe Analiza e përgjithshme e situatës e statistikat
- Raport mbi planin për kornizën rregullatore duke përfshirë: Rregullorja përfundimtare mbi kërkesat e hollësishme për kryerjen e veprimtarive spitalore.

- Me shkresën nr. 3794/prot. datë 17.11.2020 Ekipi i menaxhimit të kontratës ka informuar nëpërmjet Letrës së Pranimit për produktet e fazës së tretë të kontratës, znj. E. H. Koordinatore e MSHMS për Projektin HSIP dhe znj. B. D., Menaxhere e Projektit HSIP, se bashkimi i kompanive ka paraqitur të gjitha raportet finale sipas kontratës. Me këtë letër pranimi është miratuar dhe pagesa që i takonte fazës së tretë të kontratës.

Në përfundim, Rishikimi i Master Planit, edhe pse është mbyllur si kontratë, akoma nuk ka përfunduar si proces nga ana e MSHMS, duke qenë se nuk ka një dokument që të mbajë në mënyrë specifike dhe të qartë këtë emër (p.sh. ñMaster Plani Spitalorò). Nuk është e qartë si do të veprojë MSHMS për këtë dokument, në kuptimin, nëse një përmbledhje e të gjithë raporteve të hartuara do të përbëjnë apo jo Master Planin Spitalor.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të projektit ñPër përmirësimin e sistemit të shëndetësisëò është nënshkruar kontrata HSIP/G/SH/02-2015 nr. 578/4 prot., datë 23.02.2016 me OE I..., për blerjen dhe instalimin e programit financiar A.. P.. për njësinë e koordinimit të projektit (PCU) në shumën 576,000 lekë (me TVSh) ose 4,608 euro. Fondi i parashikuar për këtë program është 5,000 euro. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe raporteve tremujore u konstatua se programi financiar A.. P.., i kontraktuar dhe i blerë nga kompania I..., ka shfaqur problematika në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe gjenerimit të raporteve të ndryshme.

Referuar informacionit përmbledhës së datës 07.06.2021, të specialistes së financës së projektit HSIP, në lidhje me problematikat e shfaqura të programit A.. P.., ndër të tjera informon se: ñé *Në shkurt të 2020, gjatë përpjekjes për gjenerimin e raportit 3 mujor, është konstatuar se sistemi ka pasur një problematik në gjenerimin e një raporti për të cilin vlera nuk dilte e saktë. Që nga ky moment sistemi A.. P.. nuk gjeneron raportime me të dhëna të sakta (të cilat i realizojmë në Excel) ....jemi në kushtet kur çështja e gjenerimit të raporteve mbetet e pazgjidhur dhe raportet po gjenerohen me Excel ndërkohë që sistemi vijon të mos gjenerojë raporte të sakta sipas kërkesës së bankës Botërore*.ò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 25-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>1.1 Rekomandimi</u>: MSHMS të marrë masa që programi financiar A.. P.. të vihet në funksion të plotë sipas kërkesave të prokuruara dhe të ofertuara. Në rast se kompania I... nuk e vendos në funksion programin A.. P.., vlera prej 460,800 lekë do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat rezultoi se në MSHMS janë dorëzuar të gjitha materialet sipas kontratës por nuk ka dokument të plotë të realizuar dhe me shtyrjen e vazhduar në fund mund të mos mbetet kohë edhe për periudhën e nevojshme të implementimit të tij. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit HSIP fillestar (viti 2015) dhe Manuali Operacional i Projektit HSIP i rishikuar (viti 2019).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 36-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>2.1 Rekomandimi</u>: MSHMS të botojë versionin final të Master Planit të përbërë nga materialet e hartuara si dhe të ngrejë ekipin që do të vërë në jetë implementimin e tij duke përfshirë dhe kryerjen e trajnimeve për stafet e spitaleve.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat rezultoi se këto të fundit janë ndryshuar vazhdimisht dhe nuk janë realizuar plotësisht. Projekti për përmirësimin e sistemit shëndetësor ka pasur që nga fillimi shumë vonesa në realizimin e objektivave duke ndryshuar vazhdimisht objektivat dhe afatet e duke vënë kësisoj në pikëpyetje realizimin e tyre, gjë kjo e cila përbën risk për mos përmbushje/realizim të Projektit brenda afateve të parashikuara dhe rritjen e kostove të tij me pasojë përdorim pa efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit HSIP fillestar (viti 2015) dhe Manuali Operacional i Projektit HSIP i rishikuar (viti 2019).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 36-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>3.1 Rekomandimi</u>: Nga ana e Zyrës së Koordinimit të Projektit në bashkëpunim me Grupet Teknike për secilin komponent dhe me dakordësinë e Bankës Botërore, të bëhet një analizë e plotë në lidhje me arsyet dhe përgjegjësitë konkrete të mosrealizimit të objektivave që kanë mbetur të parealizuara që nga fillimi i projektit dhe të hartohet një plan me objektiva konkrete e të matshme, me afate reale dhe të arritshme si dhe me persona përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'* rezultoi se nga ana e Grupit Teknik të Punës të ngritur për përcaktimin e specifikimeve teknike, janë vendosur si kritere për aplikantët dhe ofertuesit mbi ato të nevojshme për kryerjen e këtij investimi. Konkretisht këto kritere rezultuan në lidhje me kategoritë e licencave të kërkuara jo

në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së aplikantëve ne këtë fazë si dhe në lidhje me xhiron minimale vjetore e cila është kërkuar 1,010,521,744 lekë më tepër (sa dyfishi i vlerës së nevojshme 2,038,000,000 lekë ï 1,027,478,256 lekë) se ai i përcaktuar sipas rregullave të parashikuara nga Banka Botërore. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 *Specifikimet Teknike* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *'Rehabilitim i Spitalit Pediatrik (QSUT)'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se në raportin e vlerësimit nga ana e Komisionit përkatës është cituar se: *'... çmimet janë plotësisht në përputhje me Manualin e Ndërtimit (sipas ligjit shqiptar) dhe në përputhje me BoQ të Projektit në lekë...'*. Gjithashtu, në faqen 13 të këtij materiali, paragrafi *Analizat e Çmimeve*, është cituar se *"Komisioni i Vlerësimit ka rishikuar me kujdes analizat e çmimeve nga të dy ofertuesit dhe arriti dhe gjithashtu bëri një krahasim me çmimet e përgatitura nga ana e shoqërisë e cila përgatiti hartimin e projektit'*. Në fakt, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e BOE të shpallur fitues S. T. L. S. & .... ShPK nuk disponohen në dosje të gjitha analizat e çmimeve të preventivit pasi janë paraqitur të tilla vetëm një material me 108 faqe e cila përmban 496 analiza çmimesh nga 1865 të tilla që duhet të ishin paraqitur. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, konkretisht pikën 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit'*, rezultoi se në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës janë paraqitur për ofertuesit e mundshëm disa kërkesa të cilat nuk janë në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së aplikantëve ne këtë fazë. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 Specifikimet Teknike si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për*

Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë", Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se nuk konfirmohet kërkesat për Inxhinierin Elektrik të Terrenit si dhe për Inxhinierin Supervizor të Terrenit. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, konkretisht pikën 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale, Loti 3 Radiologjia'*, rezultoi se në lidhje me kriteret e caktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës të dorëzuara Njësisë së Koordinimit të Projektit konstatohet se këto specifikime nuk i janë referuar në asnjë rast standardeve të kërkuara për pajisjet objekt prokurimi. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se specifikimet teknike të vendosura nga ana e grupit teknik të punës nuk janë konform kërkesave të Manualit Operacional të Projektit pasi nuk përmbushin në mënyrën e duhur detyrimet e pikës 3.5.4 *Specifikime Teknike*. Me përjashtim të një rasti të vetëm ku është përmendura standardi EN 60601 ï 1 ï 1 ï 3, në asnjë rast tjetër, këto specifikime nuk i janë referuar standardeve dhe nuk janë japin një deklaratë të qartë pasi në të gjitha rastet janë vendosur kufij minimal, maksimal apo kërkesa për parametra brenda një diapazoni të caktuar. Nga ana e Grupit Teknik nuk janë marrë masa për përdorimin e Standardeve ndërkombëtare apo shqiptare në hartimin e specifikimeve teknike. Sipas paragrafit 3.5.4 është kërkuar që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të merren në konsideratë:

- Konfirmimi me standardet;
- Përcaktim i qartë i natyrës së kërkesës;

Këto kritere, të cituara në mënyrë të tillë, përveç se nuk përmbushin kërkesat për të qenë të qarta dhe që ti referohen standardeve, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura për paracaktimin e operatorit ekonomik fitues. Sa më sipër është në kundërshtim me Manuali Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.5.4 *Specifikimet Teknike*, si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale., Loti 3 Radiologjia'*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se BOE S. M. ShPK dhe H. L. ShPK nuk përmbushin kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii), nuk disponojnë në certifikatën e konformitetit sipas Normës ISO 9001:2008, tek *Qëllimi*, Importim të pajisjeve teknologjike, nuk kanë specifikuar datën e saktë të fillimit dhe përfundimit të kontratave kryesore të furnizimit si dhe nuk përmbush kriterin në lidhje me referencën pasi kontrata për të cilësinë që ky subjekt ka paraqitur referencën përkatëse ka si objekt *"Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për vitin 2016"*. Kjo kontratë, nuk është kontratë furnizimi në radhë të parë por është kontratë mirëmbajtjeje dhe së dyti nuk cilëson zërat (pajisjet e mirëmbajtura). Edhe referenca për kontratën me objekt *"Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësorë për vitin 2015"* është me të njëjtën problematikë si më sipër.
Marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur me datë 15.03.2017 midis subjekteve H. L. ShPK dhe S. M. ShPK rezulton se ka parashikuar në Draft përshkrimin e kontratës edhe kontributin mes palëve i cili do të jetë në raportet 85 % subjekti S. M. ShPK dhe 15 % subjekti H. L. ShPK, në fakt referuar preventivit të kontratës dhe autorizimeve për të cilat këta subjekteve kanë marrë miratimin në lidhje me tregtimin e produkteve rezulton se ky raport është në masën 81 % S. M. ShPK dhe 19 % H. L. ShPK. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, konkretisht pika 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Për procedurën me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale., Loti 3 Radiologjia'*, në vijim të konkluzionit të arritur në lidhje me specifikimet teknike të cilat rezultuan se nuk janë zbatuar në përputhje me kërkesat e paragrafit 3.5.4 ku është kërkuar që këto specifikime ti referohen Standardeve dhe të jenë të tilla që të përfaqësojnë një deklaratë të qartë, grupi i auditimit krahasoi këto specifikime me ato të pajisjeve të JV S. M. ShPK & H. L. ShPK të shpallur fitues (më hollësisht tabela e paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pika 2.4, gjetja nr. 7). Nga krahasimi si më sipër rezulton se këto parametra përveçse nuk janë të tilla që të kenë referencë standardet përkatëse apo të jenë një deklaratë e qartë e asaj çka kërkohet, por njëkohësisht ato janë të tilla që përputhen saktësisht me parametrat e ofruar nga ana e bashkimit të subjekteve të shpallur fitues duke mbështetur kështu konkluzionin e arritur në paragrafin e mësipërm sipas të cilit, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura me qëllim kualifikimin dhe shpalljen fitues të subjekteve S. M. ShPK & H. L. ShPK. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 *Specifikimet Teknike* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas*

ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"", Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>10.1 Rekomandimi</u>: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale,* Loti 1 *"Kujdesi Intensiv"*; Loti 4 *"Oftalmoskopi"*; Loti 6 *"Angiografi"*, rezultoi se specifikimet teknike të përcaktuara nga ana e Grupit Teknik të Punës të dorëzuara Njësisë së Koordinimit të Projektit, nuk i janë referuar standardeve të kërkuara për pajisjet objekt prokurimi. Për të gjitha pajisjet dhe pjesët shoqëruese të tyre për Lotin 1, Lotin 4 dhe Lotin 6 rezulton se janë kërkuar parametra konkretë dhe/ose diapazone të tyre por në asnjë rast nuk janë cituar standarde referuese. Kjo situatë është konstatuar në të gjitha Lotet për pajisje si:
Loti 1: Defibrilator; Inkubator; Transportues inkubatori; Pompë infuzioni;
Pompë shiringash; Elktro-kirurgji; Nebulizator; Monitor; Makineri anestezie; Ventilatorë; EEG;
Loti 4: Auto refraktometër; Set lentesh; Kornizë lentesh; Etj;
Loti 6: Krahu ï C; Imazhet digjitale dhe post ï procesimi; Etj;
Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se specifikimet teknike të vendosura nga ana e grupit teknik të punës nuk janë konform kërkesave të Manualit Operacional të Projektit pasi nuk përmbushin në mënyrën e duhur detyrimet e pikës 3.5.4 *Specifikime Teknike*. Këto specifikime nuk i janë referuar standardeve dhe nuk janë japin një deklaratë të qartë pasi pothuajse në të gjitha rastet janë vendosur kufij minimal, maksimal apo kërkesa për parametra brenda një diapazoni të caktuar. Nga ana e Grupit Teknik nuk janë marrë masa për përdorimin e Standardeve ndërkombëtare apo shqiptare në hartimin e specifikimeve teknike. Sipas paragrafit 3.5.4 është kërkuar që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të merren në konsideratë:

- Konfirmimi me standardet;
- Përcaktim i qartë i natyrës së kërkesës;

Këto kritere, të cituara në mënyrë të tillë, përveç se nuk përmbushin kërkesat për të qenë të qarta dhe që ti referohen standardeve, në gjykim të grupit të auditimit, lënë vend për të krijuar një dyshim të arsyeshëm e të argumentuar për sa i takon përzgjedhjes së tyre si kritere të vendosura. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit, konkretisht pikën 3.5.4 *Specifikimet Teknike* si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë"*", Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>11.1 Rekomandimi</u>: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit me objekt *'Pajisje Mjekësore për Spitalet Rajonale,* Loti 1 *"Kujdesi Intensiv"*; Loti 4 *"Oftalmoskopi"*; Loti 6 *"Angiografi"*, në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se:
Loti 1: OE M... SHPK nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii), nuk ka specifikuar datën e saktë të fillimit dhe përfundimit të kontratave kryesore të furnizimi;
Loti 4: OE F... SHPK nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii);
Loti 6: OE SH... d.... nuk përmbush kriterin sipas pikës 3.1, paragrafi (ii), në dokumentin e paraqitur me titull *Artikull i regjistrimit* nuk është në gjuhën angleze por në gjuhën kroate, veprim ky në kundërshtim me pikën G.C.C 5.1, nuk disponon certifikatën e konformitetit sipas Normës ISO 9001:2008, e cila është kërkuar të jetë për ofertuesin pasi certifikata e paraqitur ka si të përshkuar tek *Qëllimi*, *Shitje dhe shërbim të sistemeve mjekësore dhe pajisje analitike dhe pajisje mjekësore; shitje e produkteve medicinale* duke mos përmbushur kështu kriterin sipas të cilit është përcaktuar se: *"Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 për* ***import****, tregtim, instalim, mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore"*, nuk ka përcaktuar monedhën në të cilën janë shprehur çmimet e ofruar për pjesët në rast nevoje për periudhën 7 vjeçare pas periudhës së garancisë. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit, konkretisht pika 3.4 *Komisioni i Vlerësimit*, nënpika 3.4.1 *Përbërja dhe përgjegjësitë*, paragrafi i katërt si dhe me Marrëveshjen e Financimit të ratifikuar sipas ligjit nr. 57/2015 *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Për Përmirësimin e Sistemit të Shëndetësisë""*, Pjesa 2, *Zbatimi i Projektit*, pika B *Masat e Zbatimit*, paragrafi i.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 44-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>12.1 Rekomandimi</u>: Nga ana e MSHMS të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Projekti për objektin *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"*, është hartuar nga ana e BOE *R... & A...*, me të cilin sipas aktit me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, me datë 30.11.2016, është lidhur kontrata për shërbime konsulence mes këtij BOE dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Në zbatim të kontratës së shërbimit si më sipër nga ana e konsulentit është hartuar Projekti i ndërtimit të godinës së re dhe rikonstruksionit të godinës ekzistuese me një vlerë totale të parashikuar investimi 1,114,813,908 lekë me TVSH ose 7,987,879 euro me TVSH. Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *".... & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 ú me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se preventivi i hartuar nga ana e konsulentit përmban gabime në metodologjinë e përdorur në hartimin e analizave të kostos për zërat e përfshirë në preventiv. Si përfundim, rezulton se nga ana e konsulentit janë preventivuar tepër shuma prej 31,396,973 lekë pa TVSH. (Aneksi 5.1, Tabelat 5.1.1, 5.1.2, 5.1.3 dhe 5.1.4). Sa më sipër është në kundërshtim:

- Me kontratën e shërbimit me objekt *"Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin pediatrik ekzistues"* me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016, konkretisht detyra 2 *Studimi dhe hartimi i projektit inxhinierik, Specifikimet Teknike dhe Preventivi*, sipas të cilës Projektuesi duhet të përgatisë edhe koston e investimit;
- Me VKM me nr. 629 datë 15.07.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"*, Pika 1;
- Me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave *"Për informatizimin e llogaritjes*

së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", i ndryshuar: Pika 2; Pika 9 dhe Pika 11;
- Me Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*:
Kreu I, germa A, paragrafi i fundit, Kreu II, Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit, Germa B;
- Me Urdhrin nr. 410 datë 26.09.2016, administruar në MSHMS me nr. 2493/3 prot., datë 28.09.2016, pika 2 përgjegjësitë e Koordinatorit të Kontratës, paragrafi i dytë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 82-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve të personave me kualifikimet, njohuritë dhe angazhimin e nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit.

Në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Projekti për objektin *"Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"*, është hartuar nga ana e OE *A...*, në zbatim të kontratës për shërbime konsulence me objekt *"Vlerësim teknik, hartim projektesh civile, specifikime teknike, përllogaritje kostoje për Rikonstruksionin e një prej ndërtesave ekzistuese në Spitalin Pediatrik (objekti ekzistues Nr.2) në QSUT, Godinës së Kardiokirurgjisë (Angiologji) në QSUT – Tiranë dhe Spitalit Krujë dhe Spitalit Laç"* sipas aktit me nr. 236/3 prot., datë 16.01.2020. dhe me nr. reference HSIP/CS/SSS/07-2019. Për supervizimin e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit sipas aktit me nr. 140/5 prot., datë 28.01.2021 me nr. reference HSIP/CS//CQ/02-2020 mes MSHMS dhe A... me vlerë të kontratës 45,000 Euro me TVSH. Aktualisht në lidhje me kontratën e konsulencës nuk është paraqitur asnjë kërkesë për pagesë. Në përfundim të procedurës së prokurimit të punimeve është shpallur fitues BOE *"C... N... C... P... L... "C... M..."* me të cilin është lidhur kontrata me nr. 25/6 prot., datë 29.01.2021 me vlerë të kontratës 349,210,674 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të kontratës 4 muaj nga data e fillimit të punimeve. Aktualisht, deri në momentin e hartimit të këtij akt konstatimi nuk është paraqitur për miratim të palëve asnjë situacion pjesor. Sipas shkresës me nr. 140/8 prot., datë 01.06.2021 të përfaqësuesit të MSHMS drejtuar Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit, është kërkuar aprovimi i ndryshimit të stafit teknik dhe shtyrje afati të përfundimit të punimeve. Sipas shkresës me nr. 140/9 prot., datë 01.06.2021 të Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit është autorizuar zëvendësimi i stafit teknik për shtyrjen e afatit të përfundimit të kontratës duke ngarkuar kështu zyrën e Njësinë e Koordinimit të Projektit të kryejë procedurat për amendimin e Kontratës. Në vijim sipas shkresës me nr. 25/27 prot., datë 08.06.2021 është amenduar kontrata *"Punime civile për ndërtimin e Spitalit Rajonal të Laçit"* në lidhje me dy çështje:

1. Zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve nga 4 muaj në 5.5 muaj;
2. Ndryshimin e personelit të kontraktorit si më poshtë:

Nga sa më sipër rezulton se në asnjë rast të vetëm nuk dokumentohet të kenë qenë prezent në terren stafi teknik kryesor i sipërmarrësit me ata punonjës për të cilët ai është shpallur. Në kushte të tilla stafi teknik ka punuar pa marrë ende miratimin nga ana e konsulentit, menaxherit të kontratës të emëruar nga ana e MSHMS dhe vet Autoritetit Kontraktor MSHMS. Sipas amendamentit të kontratës punimet duhet të kishin përfunduar me datë 20.07.2021 kur në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, stafit të Zyrës së Koordinimit të Projektit dhe supervizorit të punimeve rezultoi se punimet ishin ende në fazat fillestare të saj. Konkretisht rezultoi se ishin në proces punimet për konstruksionin metalik dhe rezultuan të përfunduara punimet fillestare të saj vlera e të cilave është jo më shumë se 85,332,690 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përbën më pak se 30 %

të vlerës se punimeve (pa TVSH dhe pa fond rezervë). Aktualisht rezulton se kontrata është në procedurat e miratimit të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve e lidhur me BOE *'C... N... C... P... L... "C... M..."* me nr. 25/6 prot., datë 29.01.202, pikën 9.9.1 të kushteve të përgjithshme.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 95-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
14.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS dhe strukturave të ngritura për monitorimin e kontratave të merren masa për miratimet në kohë të ndryshime të kontratave me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve të Projekteve me financime dhe huaja.

Në vijimësi

14.2 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për identifikimin e saktë të nevojave për realizimin e kohës të investimeve, duke marrë në konsideratë edhe situatat e veçanta siç ishte rasti i pandemisë së COVID 19, kjo me qëllim shmangien e afateve të shkurtra kohore të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në kriteret e vendosura në procedurat e prokurimit për këto investime.

Në vijimësi

15. Gjetje nga Auditimi: Ekipi teknik i kontratës *"F.V. Rezonanca magnetike (MRI) për spitalin e Elbasanit"*, ka ndryshuar parametrat teknikë sipas specifikimeve teknike të reja të reflektuara dhe të miratuara nga BB. Edhe pse ky veprim nuk ka ndikuar në efektshmërinë e procedurës së prokurimi, kjo sepse ndryshimi i parametrave është kryer përpara paraqitjes së ofertave nga OE, nga ana e ekipit teknik është vepruar në kundërshtim me parashikimet e Manualit Operacional të Projektit HSIP, seksioni Technical Working Groups (TWG) *"Changes to ToR's and/or technical specifications including qualification criteria (including clarifications to these documents) and cost estimations are also responsibility of the TWG"*.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 97-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
15.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rastet e ndryshimit të specifikimeve teknike, krahas tyre duhet të kërkoj nga komisioni përkatës reflektimin dhe ndryshimin edhe të fondit të parashikuar për atë procedurë prokurimi.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Ekipi i menaxhimit të kontratës ka miratuar kërkesën e konsulentit duke pranuar që punën e ngarkuar për ekspertin (KE5) të mbulohet dhe të realizohet nga dy ekspertë të tjerë ekzistues të ekipit z. M. W. dhe z. M. M., të cilët kanë detyra specifike dhe profesion jo të ngjashëm me z. M. F. (Quality Improvement Expert), si dhe CV jo të përshtatshme me kërkesat për pozicionin e ekspertit KE5. Gjithashtu këta dy ekspert kanë një angazhim të lartë kohorë, gjë që e bënë të pamundur edhe sikur të kishin ekspertizën, kualifikimin dhe përvojën ekuivalente me pozicionin e KE5, ata nuk mund të realizonin me sukses detyrën për shkak të ngarkesës që kanë në pozicionet e tyre fillestare, kryesisht z. M. W.. Për më tepër që në asnjë pikë të kontratës nuk është parashikuar shpërndarja e detyrave brenda ekipit për ekspertët që largohen, por është parashikuar me të drejtë zëvendësimi i tyre me një person me kualifikim e përvojë ekuivalente ose më të mirë, dhe masë shpërblimi të njëjtë, sipas parashikimit të nenit 19.1.1 pika f dhe nenit 30 të kontratës, si më poshtë e cituar:
Zëvendësimi i ekspertit kryesor:
Përveç rastit kur klienti me shkrim deklaron ndryshe, eksperti kryesor nuk mund të zëvendësohet.
Pavarësisht paragrafit më lart, gjatë ekzekutimit të kontratës, bazuar vetëm në kërkesën me shkrim të konsulentit, mund të bëhet edhe zëvendësimi i ekspertit kryesor.
Ky zëvendësim i ekspertit kryesor do te behet për arsye shëndetësore apo rast vdekje, të paparashikuara më parë nga konsulenti.

Në një rast të tillë, konsulenti menjëherë do të gjejë zëvendësues, person me kualifikim e përvojë ekuivalente ose më të mirë, dhe masë shpërblimi të njëjtë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 106-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
16.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rast të kërkesave të konsulenteve për zëvendësim të eksperteve kryesor të tyre, të miratoi vetëm zëvendësimet me ekspert të tjerë, që kanë kualifikim të njëjtë ose më të lartë se ata që zëvendësojnë dhe mos të miratoi kërkesa për shpërndarje të detyrave tek ekspertët ekzistues të kontratës.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Sistemi i Menaxhimit Financiar për 420 QSH nuk funksionon dhe për këtë arsye, në lidhje me zbatimin e kontratës së shërbimit, grupi i auditimit bëri verifikime në FSDKSH, DRF Tiranë, QSH nr. 5, dhe nr. 8, DRF Shkodër, QSH nr. 2 dhe nr. 4, DRF Kukës si dhe DRF Elbasan. Gjithashtu, mbi funksionimin e këtij sistemi, u krye një tjetër verifikim në prani të specialistit të IT të FSDKSH mbi funksionalitetin e sistemit në serverat e Fondit ku është instaluar aplikacioni dhe databaza e tij. Gjatë verifikimit, u konstatua se aksesimi në Server Mananger administrohet nga I... si për aplikacionin ashtu dhe për data bazën. Për shkak të administrimit të serverit nga I..., grupi i auditimit dhe specialisti i IT të Fondit, nuk mundën të logoheshin për të marrë log-in. Gjithashtu edhe specialistit i IT të FSDKSH nuk u aksesua dot as në nivel user. Nga auditimi rezulton se aktiviteti ekonomiko financiar në Drejtoritë Rajonale të Fondit dhe në Qendrat Shëndetësore, vazhdon të realizohet njësojë, si përpara kryerjes së këtij investimit përmes programit Excel. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe konstatimeve të bëra nga vetë përdoruesit final të këtij programi, trajnimet e zhvilluara për përdorimin e sistemit të menaxhimit financiar në QSH nga I... kanë qenë të pa mjaftueshëm.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 98-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
17.1 Rekomandimi: MSHMS në bashkëpunim me FSDKSH të marrin masa për vendosjen në funksion të sistemit të menaxhimit financiar në 420 qendrat shëndetësore.

Menjëherë

17.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me FDSKSH të hartojnë planin e punës për trajnimin e specialistëve të financës së Qendrave Shëndetësore dhe Drejtorive Rajonale të Fondit, që do jenë përdorues të sistemit të menaxhimit financiar.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, kontrata për *"Mbështetjen e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë se re për menaxhimin e QSUT"* nuk është realizuar me sukses. Në zbatim të kushteve të kontratës klauzolës 9.1, konsulenti C. S., duhej të dorëzonte brenda afateve kohore të përcaktuara në kontratë dhe të pasqyruara në tabelën nr. 2 aneksi nr. 5. Pas dorëzimit të raporteve respektive sipas fazave dhe kërkesave të përcaktuara në Termat e Referencës (TOR) dhe të pasqyruara në kontratë, konsulenti duhet ti dorëzonte pranë ekipit të menaxhimit të kontratës në formatin hard copy dhe elektronik me e-mail raportet dhe dokumentacionin e kërkuar. Ekipi i menaxhimit në zbatim të klauzolës (kushtet specifike) neni 41.2 afati i komenteve, duhet që brenda 21 ditëve nga dita e dorëzimit të raporteve të bej komentet. Të dhënat analitike mbi dorëzimin e raporteve respektive sipas fazave dhe datave gjenden në aneksin nr. 5 tabela nr. 2. Për sa më lart, kontrata me konsulentin ndërkombëtar për një strategji të re të menaxhimit të QSUT, do të konsiderohet e pasuksesshme në drejtim të dorëzimit të produkteve/raporteve sipas fazave dhe respektimit të afatit kohorë të përfundimit të kësaj kontrate, brenda datës

06.06.2021. Nga auditimi i kësaj praktike rezultoi gjithashtu se kontrata e lidhur mes palëve nuk ka të përfshirë penalitete për dorëzimin me vonesë të produkteve kontratës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 106-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për përfundimin e kontratës ñMbështetja e QSUT nga një ekip menaxhimi ndërkombëtar-zbatimi i strategjisë se re për menaxhimin e QSUTò dhe në bashkëpunim me QSUT, të hartojë planin e veprimeve për fillimin e implementimit të saj.

Menjëherë

18.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për përfshirjen në kontratat e ardhshme të klauzolave në lidhje me aplikimin e penaliteteve për dorëzimin me vonesë të produkteve këtyre kontratave.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se emërimi i Drejtores së Kabinetit znj. E. H., me Urdhër nr. 96, datë 11.03.2016 të Ministrit të MSHMS në pozicionin e Koordinatorit të Përgjithshëm të Projektit është kryer në kundërshtim me kërkesat e parashtruara nga Manuali Operacional i Projektit të vitit 2015 si dhe atyre të Manualit Operacional të ndryshuar në vitin 2019, sipas të cilit është shprehur se në këtë pozicion duhet të emërohet Zv. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Njëkohësish duhet theksuar fakti se ky emërim është kryer në kundërshtim edhe me Rregulloren e Brendshme të MSHMS, pasi funksionaret e Kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional i Projektit, varianti i parë i vitit 2015 si dhe ai i ndryshuar në vitin 2019, pika 2.1 Angazhimet Institucionale dhe Zbatuese, paragrafi i parë si dhe me Rregulloren e Brendshme *"Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale"*, neni 3, pika 2, germa c.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1 Rekomandimi: Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për zëvendësimin e Koordinatorit të Përgjithshëm aktual të Projektit dhe emërimin në këtë pozicion të funksionarëve sipas kërkesave të parashtruara nga Manuali Operacional i Projektit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Pagesa e mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit financiar në 420 QSH për garanci 11 muaj Nëntor 2018-Shtator 2019ò në shumën **2,089,995.60 lekë**, është bërë nga zyra e financës së projektit HSIP mbi bazën e shkresës nr. 3371/1 datë 22.05.2020, të ish Drejtoreshës së FDSKSH mbi konfirmimin e funksionalitetit të sistemit nga ish Drejtoresha e FDSKSH. (shiko aneksin nr. 5 foto nr. 5). Pra sipas ish Drejtoreshës së FDSKSH, sistemi i menaxhimit financiar në 420 QSH, duhet të shërbente për menaxhimin e procesit të planifikimit, miratimin dhe ekzekutimit të buxhetit financiar të alokuara nga FDSKSH për Drejtorit Rajonale të Fondit dhe Qendrave Shëndetësore, për të realizuar më konkretisht:

1. Planifikimin e Buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre;
2. Miratimin e buxhetit në nivel Drejtorie dhe qendre;
3. Detajimin e buxhetit vetjak nga QSH dhe miratimi i tij nga Drejtoria Rajonale;
4. Shpërndarjen e buxhetit nga ana e QSH;
5. Ekzekutimin e buxhetit në nivel Qendre Shëndetësore;
6. Regjistrimin e transaksioneve kontabël në çdo QSH;
7. Raportimin në nivel Fondi, DRF dhe QSH;

8. Raportimin për çdo modul, në nivel përmbledhës dhe analitik.

Pra, nga sa ka konfirmuar ish Drejtoresha e FSDKSH, nënkupton që këto objektiva janë realizuar nga sistemi i menaxhimit financiar për të 420 QSH. Në lidhje me zbatimin e kontratës, grupi i auditimit bëri verifikime në FSDKSH, DRF Tiranë, QSH nr. 5, dhe nr. 8, DRF Shkodër, QSH nr. 2 dhe nr. 4, DRF Kukës si dhe DRF Elbasan për sistemin e menaxhimit financiar. Krahas verifikimit mbi funksionalitetin e sistemit të menaxhimit financiar në QSH dhe DRF e sipërcituara, Grupi i Auditimit të KLSH kreu një verifikim në serverin e FSDKSH të sistemit të menaxhimit financiar, ku edhe është instaluar aplikacioni dhe data baza e tij. Në këtë verifikim pranë FSDKSH, grupi u shoqërua nga specialisti IT i Fondit. Nga verifikimi rezultoi se aksesimi në Server Mananger administrohet nga kompania I... si për aplikacionin ashtu dhe për databazën. Për shkak se administrimi i serverit bëhet nga I..., grupi i auditimit dhe specialisti i IT i Fondit, nuk mundën të logoheshin për të marrë log-inet e gjeneruara për sistemin e menaxhimit financiar në 420 Qendrat Shëndetësore. Gjithashtu specialisti i IT të FSDKSH, nuk u aksesua dot as në nivel user, çka tregon që sistemi i menaxhimit financiar në 420 QSH, **nuk funksionon dhe nuk është i aksesueshëm për përdoruesit e sistemit të kujdesit shëndetësor parësor**. Pra, shuma prej **2,089,995.60 leke** e shpenzuar si pagesë për garancinë e sistemit konsiderohet dëm ekonomik, pasi sistemi nuk aksesohet dhe nuk funksionon dhe nuk ka realizuar qëllimin dhe objektivat për të cilat është prokuruar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 98-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: MSHMS në bashkëpunim me FDSKSH të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **2,089,995.60 lekë** nga ana e bashkimit të operatoreve ñI... & B...ò për mos sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar për 420 QSH dhe mos aksesimin dhe funksionimin e tij, duke përfituar këtë shumë në mënyrë të padrejtë dhe të pa merituar dhe në mospërputhje me kushtet e kontratës për mirëmbajtjen e sistemit.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *".... & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 ú me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Supervizimi i punimeve është kryer nga BOE *"R... & A..."*, për të cilin kontrata e konsulencës si më sipër, ka pasur të parashikuar edhe këtë lloj shërbimi. Deri në përfundim të punës audituese në terren u konstatua se nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë dorëzuar në total 4 pagesa pjesore (IPC) me vlerë totale progresive 733,789,828.26 lekë me TVSH, ose 66.8 % e vlerës totale të kontratës. Punimet e situacionuara lidhen me ato që i takojnë ndërtimit të shtesës anësore pasi punimet për rikonstruksionin e godinës ekzistuese nuk kanë filluar akoma për shkak të ndryshimeve të nevojshme që kanë lindur për projektin prej tërmetit të vitit 2019. Nga analiza e preventivit të punimeve si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve (BOE) rezultojnë disa problematika në lidhje me zërat

- *Ngritje, mobilim dhe kompletim me pajisje, mirëmbajtje, furnizim me tërë komponentët e nevojshëm dhe çmontim e zyrave te menaxhimit te kantierit. Këto zyra duhet të kenë ambiente të mjaftueshme pune për kontraktorin, supervizorin dhe investitorin. Në këto*

ambiente përfshihet edhe një hapësirë e mjaftueshme për ruajtjen në kushte të përshtatshme të mostrave dhe kampioneve që do të merren për provë apo testim gjatë kryerjes së punimeve;

- *F.V. Të dy tabelave informuese për projektin+ bazamentin përkatës +çmontim në përfundim të punimeve. Gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve kontratave kontraktori obligohet që të marrë të gjitha masat për rregullimin e komunikacionit, sigurisë në kantier dhe sigurisë së mjeteve dhe këmbësorëve;*
- *F.V. Rrethim i përkohshëm me llamarinë të valëzuar + aksesoret. Rrethimi do bëhet me zona sipas plan organizimit të punimeve. Në çmim përfshihet, furnizimi dhe vendosja e llamarinës, menaxhimi i hyrje daljeve në kantier, sigurimi i lëvizjes së këmbësorëve gjatë ndërtimit, heqja e rrethimit, pastrimi i zonës në përfundim të punimeve. Çdo dëmtim i rrethimit nga banorët apo mjetet do të zëvendësohet nga kontraktori pa kosto shtesë;*

Në total rezulton se janë likuiduar për këto tre zëra shuma prej 1,800,000 lekë pa TVSH. Në fakt, referuar metodologjisë së ndjekur nga ana e hartuesve të Projekt ï preventivit e cila i është referuar strukturës së kostos me nën-zërat *Punëtori*, *Transport*, *Makineri* dhe *Materiale*, kontratës së lidhur mes MSHMS dhe Projektuesit, neni 12 citon se ligji udhëheqës i kontratës do të jetë ai shqiptar. Për rrjedhojë shuma e mësipërme përbën përdorim pa efektivitet eficniencë dhe ekonomicitet të fondeve të Projektit pasi punimet për zërat e mësipërm janë të përfshira në realizimin e punimeve të ndërtimit (shpenzimet plotësuese) dhe si të tilla nuk mund të parashikohen si zëra më vete. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 08.05.2002 ñPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*"*, Kreu II, germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme* si dhe me kontratën e Zbatimit të Punimeve Specifikimet Teknike, pika 1.3 *ELEMENTËT E PËRFSHIRË TEK ÇMIMET*, paragrafi i katërt.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 87-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>1.1 Rekomandimi</u>: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë dhe angazhimin e nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai rastit në shumën **1,800,000 lekë pa TVSH.**

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *".... & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 ú me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Nga auditimi rezultoi se për 26 zëra punimesh analizat e kostove për këto zëra janë hartuar si të ishin punime të mirëfillta ndërtimi, kur në fakt këto janë punime të nënkategorisë *Punime të Teknologjisë dhe të Montimit*, nënkategoria *Punime Montimi.* Duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se shuma prej 4,018,027 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomicitet i fondeve të Projektit. Sa më sipër është në kundërshtim:

- Me kontratën e shërbimit me objekt *""Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin Pediatrik ekzistues" dhe me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016*, konkretisht Aneksi A Termat e Referencës dhe Qëllimi i Shërbimeve, pika 3 *Objektivat Specifikë* , nënpika 4, pika 3 *Detyrat e Shërbimit*, nënpika 4 si dhe pika 6, Faza III;
- Me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, neni 1, neni 2 dhe neni 3;

- Me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7;
- Me VKM nr. 514, date 15.8.2007 *"Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar*, pika 10;
- Me Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, germa A, paragrafi pas pikës 7;
- Kreu II, *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi*, Kreu II *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Fitimi i Sipërmarrësit*, Germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme*;
- Me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3;
- Me Urdhrin nr. 670, me nr. 3629/13 prot., datë 02.10.2019 sipas të cilit janë emëruar inxhinier të kontratës së punimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 87-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë dhe angazhimin e nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai rastit në shumën **4,018,027 lekë pa TVSH.**

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me investimin me objekt *"Rehabilitimi i Spitalit Pediatrik (QSUT)"* nga auditimi rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *".... & U. I. T. S. T. L. S."* me të cilët është lidhur kontrata me nr. HSIP/CW/ICB/02-2017 me vlerë të kontratës 1,098,019,044 lekë me TVSh ose 8,929,162 ú me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 15 muaj. Punimet për rikonstruksionin e godinës nuk kanë filluar akoma për shkak të ndryshimeve të nevojshme që kanë lindur për projektin prej tërmetit të vitit 2019. Në mënyrë të ngjashme me konstatimin e përshkruar si më sipër, i njëjti gabim në strukturën e kostos është kryer edhe për zërat e ofertuar për punimet e godinës ekzistuese, sikurse edhe për ato të godinës shtesë. Konkretisht, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e BOE, edhe për punimet e rikonstruksionit të godinës ekzistuese, për ato raste që është paraqitur analiza teknike e çmimeve, problematika e metodologjisë së hartimit të strukturës së kostos dhe ato për punimet për ngritjen e kantierit, tabelën informuese dhe rrethimin e përkohshëm janë të njëjta me ato të përshkruara si më sipër për punimet e ndërtimit të shtesës anësore. Duke bërë llogaritjet, rezulton se janë kontraktuar punime në shumën 1,200,000 lekë pa TVSH për punimet e ngritjes së kantierit, vendosjes së tabelës dhe punimeve të rrethimit si dhe shuma prej 14,634,264 lekë pa TVSH për punime të ndryshme, vlera totale e të cilave është në masën **15,834,264 lekë pa TVSH**, shumë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet, eficinencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit si rrjedhojë e mos respektimit të strukturës së kostos për disa prej zërave të preventivit. Sa më sipër është në kundërshtim:

- Me kontratën e shërbimit me objekt *""Vlerësim teknik, projektim arkitekturor, specifikime, vlerësim i kostove dhe supervizim i punimeve civile, instalim i setit të pajisjeve mjekësore dhe aparaturave për spitalin Pediatrik ekzistues" dhe me referencë HSIP/CS/CQ/04-2015, datë 30.11.2016*, konkretisht Aneksi A Termat e Referencës dhe Qëllimi i Shërbimeve, pika 3 *Objektivat Specifikë* , nënpika 4, pika 3 *Detyrat e Shërbimit*, nënpika 4 si dhe pika 6, Faza III;
- Me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*,

neni 1, neni 2 dhe neni 3;
- Me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7;
-Me VKM nr. 514, date 15.8.2007 *"Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar*, pika 10;
- Me Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 *"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu II, germa A, paragrafi pas pikës 7;
- Kreu II, *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi*, Kreu II *Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit*, paragrafi B *Fitimi i Sipërmarrësit*, Germa B *SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE FITIMI*, paragrafi, *Shpenzime të Përgjithshme*;
- Me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3;
- Me Urdhrin nr. 670, me nr. 3629/13 prot., datë 02.10.2019 sipas të cilit janë emëruar inxhinier të kontratës së punimeve.
Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 87-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS të merren masa për vendosjen në grupet e marrjes në dorëzim të projekteve, në grupet e ngritura për vlerësimet e ofertave si dhe në grupet e ngritura për monitorimin e kontratave të personave me kualifikimet, njohuritë dhe angazhimin e nevojshëm me qëllim mirë përdorimin e fondeve të Projektit si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projektit siç është ai rastit në shumën **15,834,264 lekë pa TVSH.**

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 377 datë 08.09.2015 është përcaktuar që adresa e Njësisë së Koordinimit të Projektit HSIP të jetë Ministria e Shëndetësisë: Bulevardi ñBarjam Curiò nr. 1. Ndërkohë Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU) ushtron aktivitetin në një apartament të marrë me qira me adresë: Rruga ñShyqyri Bërxolliò Ap. 24A, Tiranë. MSHMS me pretendimin e mungesës së ambienteve për njësinë e koordinimit të projektit HSIP, fillimisht e ka akomoduar në godinën e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (akomoduar përkohësisht) dhe më pas nëpërmjet Koordinatores së Përgjithshme të Projektit HSIP, znj. E. H. drejtuar njësisë së koordinimit të projektit HSIP me shkresën nr. 2553 prot. datë 29.05.2020 me objekt ñMbi nevojën e përdorimit nga zëri i kostove operative të projektit HSIPò duke propozuar përdorimin e zërit të kostove operative të projektit të një shume, për kosto qiraje për zyra dhe kosto të tjera operative të lidhura me to (si shpenzime energji elektrike, uji, internet, transportim materialesh dhe dokumentacioni etj.) me qellim garantimin e vijimësisë së punës së PCU. Koordinatorja e Përgjithshme e Projektit HSIP, ka autorizuar Njësinë e Koordinimit të Projektit që të ndjek procedurat e miratimit pranë Bankës Botërore, për përdorimin e këtij zëri për kostot operative. **Vlera 672,993 lekë** [(1,390,567-(1,390,567*0.51603)] e përllogaritur si diferencë e shumës totale të shpenzuar të realizuara nga Njësia e Koordinimit të Projektit HSIP dhe shumes potenciale të shpenzimeve që duhet të bëhej nga njësia e koordinimit të projektit HSIP për shpenzimet e qirasë së ambientit në përputhje me parashikimet e VKM 469 date 03.06.2015 *"Për përcaktimin e vlerës minimale te çmimit te referencave te qirave te ndërtesave për qëllime tatimore"* do të konsiderohet si shpenzim jo efektiv, i cili ka rritur artificialisht kostot e shpenzimeve të projektit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 30-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa që njësia e koordinimit të projektit HSIP, të akomodohet në ambientet e saj, në rast të pamundësisë së ambienteve, të nisë një procedurë të re ligjore për lidhjen e kontratës së qerasë për një ambient

